



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr.11, datë 16.06.2020

PËR

**“MBI PËRFUNDIMET E ARRITURA PAS KËSHILLIMIT PUBLIK TË
DOKUMENTIT: “ANALIZË TREGU E TELEFONISË CELULARE PËR TREGJET ME
SHUMICË TË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETET CELULARE,
PËRFSHIRË TERMINIMIN E THIRRJEVE HYRËSE NDËRKOMBËTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi	Frashëri	Kryetar
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtar
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 16.06.2020, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”.*

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr.9918/2008**);

2. Rregullore Nr. 9, “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, datë 17.07.2009, e ndryshuar (**Rregullore nr.9/2009**);
3. Udhëzues për Procedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare – Dokument Përfundimtar*”;
- Relacioni shoqërues i projekt-aktit miratues (Relacioni);
- Projekt-aktit miratues të dokumentit (projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në cilësinë e organit të vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9918/2008, duke synuar promovimin e konkurrencës efektive/efiçente me qëllim sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike.
2. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me Nr. 9, datë 17.07.2009 “*Për Analizën e tregut*”. Ky treg ka qenë gjithashtu pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014. Që prej vitit 2015, për sa i përket terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, Komisioni Evropian ka vënë theksin mbi domosdoshmërinë e një analizë të hollësishme, sipas kushteve specifike dhe dinamike të tregjeve kombëtare dhe zonave ekonomike, përkundrejt një rregullimi sistematik dhe skematik.
3. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin Nr.10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, periudha e këshillimit publik 18.04.2019 – 20.06.2019.
4. Në përfundim të këshillimit publik, në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:
 - Autoriteti i Konkurrencës me vendimin Nr. 634, Datë 04.07.2019 “*Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me*

dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”

- Telekom Albania sh.a me shkresën Nr. 3044, datë 13.06.2019 (*Referenca e AKEP nr. 1112/1, datë 18.06.2019) dhe me shkresën 1112/5 prot. të datës 27.2.2020*);
 - Albtelecom sh.a me shkresën Nr. 4560, datë 20.06.2019, (*Referenca e AKEP nr. 1112/2, datë 20.06.2019*);
 - Vodafone Albania sh.a me shkresën Nr. CEO/006/KQ, datë 18.06.2019 (*Referenca e AKEP nr. 1112/3, datë 21.06.2019*);
 - Neofone sh.p.k me shkresën Nr. 346, datë 19.06.2019 (*Referenca e AKEP nr. 1113/5, datë 20.06.2019*).
5. Pas marrjes së opinionit të palëve të interesuara, AKEP zhvilloi konsultime të herëpashershme me organizmat ndërkombëtar. Ndonëse u rekomandua që për thirrjet hyrëse kombëtare të vijohej sipas metodës së *benchmark*-ut rajonal (vendet e BE), u vërejt se analiza e tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse nuk do të mund të ishte plotësisht efiçente, për aq kohë sa nuk do të përftohej një model kostosh, i cili në fakt është duke u përpunuar aktualisht në AKEP, bazuar në praktikatat më të fundit BE/BEREC.
 6. Pas marrjes së opinionit të ekspertëve të BE-së, AKEP zhvilloi takime me të tre operatorët e rrjeteve celulare për të diskutuar përfundimet e këshillimit mbi dokumentin e analizës së tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse, duke konkluduar gjerësisht, së pari, për terminimin e thirrjeve hyrëse kombëtare dhe së dyti, për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
 7. Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregullatore përkatëse. Nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 9918/2008 dhe në rregulloren për analizën e tregut. Nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të kreut VI të ligjit 9918, dhe rregullores, duke pasur parasysh përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT. Dokumenti ka marrë gjithashtu në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikatat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet e tregut celular në momentin e përpunimit të analizës.
 8. Operatorët me Fuqi të Ndjeshme dhe masat rregullatore në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare janë në fuqi me aktet e Këshillit Drejtues të AKEP:
 - a) Vendim Nr. 12, datë 22.02.2018 për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT*”;

- b) Vendim Nr.13, datë 22.02.2018 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”;
- c) Vendim Nr.14, datë 22.02.2018 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese për FNT”.
9. Rregullimi i tarifave të terminimit në rrjetet celulare është përcaktuar me:
- a) Vendimin Nr.71, datë 01.10.2018 për “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a.me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania”;
- b) Vendimin Nr.72, datë 01.10.2018 për “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Telekom Albania sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekom Albania”;
- c) Vendimin Nr.73, datë 01.10.2018 për “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom sh.a”.
10. Të njëjtat përfundime arrihen edhe në dokumentin “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, pas këshillimit publik (18.04.2019 – 20.06.2019) dhe për sa i përket terminimit kombëtar konkludohet se shpallja e të tre operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës (FNT) mbetet në fuqi, sikundër mbeten të pandryshuara masat rregullatore dhe tarifa aktuale 1.11 lek/minutë, deri kur tregu të mund të analizohet sërish nisur nga një model përfundimtar kostosh, i cili do të orientojë më qartë përshkallëzimin e njësisimit tarifor (*glide path*).
11. Përftimi i modelit të kostove dhe për rrjedhojë i një mekanizmi eficient njësimi tarifor (*glide path*) do të mundësojë në momentin më të përshtatshëm një analizë të plotë rregullatore për sa i takon terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare. KD është i vetëdijshëm për rëndësinë e zgjatjes së intervaleve kohore mes dy analizave, nga 3 në 5 vjet, rishtazi të rekomanduara nga Komisioni Evropian, për t’i dhënë kohën e mjaftueshme tregjeve për të strukturuar një fizionomi të qëndrueshme dhe për t’i lejuar rregullatorit të vrojtojë dhe të shqyrtojë kushtet e posaçme dhe dinamikat e tyre reale, duke shmangur çdo analizë skematike. Duke marrë parasysh sa më sipër, AKEP nuk do të ngurojë, sapo të disponojë një model kostosh tërësisht operacional, të shqyrtojë mundësinë e një analize të re të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke pasur parasysh faktorët ekonomikë specifikë, dinamikat e tregut shqiptar, eventualisht rekomandimet dhe direktivat e reja që mund të përpunohen nga Komisioni Evropian dhe impaktin mbi përdoruesit fundorë.

PËR KËT O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e përfundimit të analizave cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

1. T'i konsiderojë tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a, Telekom Albania sh.a dhe Vodafone Albania sh.a si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: *tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare*, duke lënë në fuqi:
 - a. Masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 12, 13, 14, datë 22.2.2018.
 - b. Tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 01.10.2018.
2. Të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.
3. Ky vendim dhe dokumenti “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare – Dokument Përfundimtar*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Edlira Dvorani

Ketrin Topçiu

Xhoana Lilaj

**“Analizë tregu e telefonisë celulare për
tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve
në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e
thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”**

Dokumenti Përfundimtar

Miratuar me VKD nr.11, datë 16.06.2020

Përmbajtja e Dokumentit

1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Hyrje	8
<i>Parashikimet ligjore dhe rregullatore të Analizës së tregut</i>	8
<i>Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve</i>	9
<i>Praktika e Komisionit Evropian</i>	10
<i>Procedura e Analizës së Tregut</i>	12
<i>Procedura e këshillimit publik</i>	14
<i>Analizat e mëparshme në tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare</i> .	15
2. Praktika e BEREC për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare (Benchmark)	19
2.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator	19
2.2 Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike.....	20
2.3 Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC	21
2.4 Tarifat mesatare të terminimit celular (MTR) në vendet e BE/BEREC	21
2.5 Tarifa mesatare MTR e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër	24
2.5 Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark).....	27
3. Panoramë e përgjithshme e tregut të shërbimeve celulare	31
3.1 Ofruesit e shërbimeve celulare në Shqipëri	31
3.2 Analiza e zhvillimeve të shërbimeve celulare	33
<i>Struktura e përdoruesve të shërbimeve mobile</i>	33
<i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i>	35
<i>Të ardhurat totale nga komunikimet elektronike mobile</i>	36
<i>Të ardhurat sipas shërbimeve me shumicë dhe pakicë</i>	37
<i>Investimet</i>	38
<i>Fitimet neto të operatorëve mobile</i>	39
<i>Treguesit e ARPU dhe ARPM</i>	40
<i>Pjesët e tregut</i>	41

<i>Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2011 – 2018 së bashku me indeksin HHI të përqëndrimit janë dhënë në tabelën e mëposhteme.</i>	<i>41</i>
<i>Tarifat për shërbimet e aksesit broadband celular</i>	<i>43</i>
<i>Pesha e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare</i>	<i>44</i>
<i>Tarifat standarte për njësi komunikimi (pay as you go)</i>	<i>46</i>
<i>Ndërhyrjet e AKEP në transparencën dhe rregullim e kohëzgjatjes së ofertave</i>	<i>47</i>
3.3 Masat rregullatore on-net/off-net	47
4. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare	51
4.1 Përcaktimi i tregut përkatës për terminimin e thirrjeve celulare.....	52
4.2 Rregullimi i MTR kombëtare.....	53
4.2.1. Metoda e rregullimit të MTR	54
Asimetria/Simetria e aplikimit të MTR të ri	55
4.4 Rregullimi/de-rregullimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.....	60
<i>Impakti i terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare</i>	<i>62</i>
<i>Konkluzione mbi trafikun nga thirrjeve ndërkombëtare</i>	<i>69</i>
<i>Aneks 1- Trafiku i terminuar sipas operatoreve (konfidenciale)</i>	<i>69</i>
<i>Aneks 2: Procesi i roaming rajonal (Western Balkan Roaming).....</i>	<i>70</i>
<i>Aneks 3- Komentet e këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP</i>	<i>70</i>

Përmbajtja e Figurave

Figura 1: Tarifat MTR sipas vendeve te BEREC (Korrik 2016).....	21
Figura 2: Tarifat MTR sipas vendeve te BEREC (Korrik 2017)	22
Figura 3: Tarifat MTR sipas vendeve te BEREC (KORRIK 2018).....	23
Figura 4: Ecuria e tarifave të MTR për Shqipërinë 2010 -2018.....	27
Figura 5: Asmateria e MTR në vendet evropiane 2009 - 2018.....	30
Figura 6: Numri i përdoruesve celularë aktivë ,karta SIM dhe broadband 2014-2018	34
Figura 7: Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale nga komunikimet elektronike mobile	36
Figura 8: Të ardhurat nga Shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjeteve celulare 2010-2018	37
Figura 9: Ecuria e Investimeve të sipërmarrësve në rrjete celulare (2010-2018).....	38
Figura 10: Fitimet neto të operatorëve mobile 2011 - 2018.....	39
Figura 11: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit (2003-2018).....	47
Figura 12: Struktura e thirrjeve celulare (Janar 2014-Dhjetor 2018).....	49
Figura 13: Ecuria e trafikut dhe të ardhurave neto midis tre operatorëve celulare 2014-18 (konfidenciale).....	56
Figura 15: Terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare 2014-2018	63
Figura 16: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve kombëtare 2014-2017	64
Figura 17: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare 2014-2018	64

Përmbajtja e Tabelave

Tabela 1: MTR dhe aplikimi i LRIC I PASTËR BEREC 2016-2019.....	24
Tabela 2: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (benchmark korrik 2016-janar 2019)	27
Tabela 3: Vendet me tarifa terminimi asimetrike Janar 2019	29
Tabela 4: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2014-2018	33
Tabela 5: Struktura e përdoruesve celularë kontratë/parapagim (2017-2018)	35
Tabela 6: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2018	36
Tabela 7: Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2018.....	40
Tabela 8: Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2011-2018	41
Tabela 9: Peshat e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celulare 2014-2018.....	44
Tabela 10: Peshat e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave nga terminimi 2014-2018.....	44
Tabela 11: MTR mesatar ndërkombëtar 2014-2018	45
Tabela 12: Të ardhura mesatare për minute nga terminimi kombëtar dhe ndërkombëtar 2014-2018.....	45
Tabela 13: Asimetria e tarifave të terminimit të Albtelcom dhe Plus	55
Tabela 14: Pagesat neto për terminimin e thirrjeve midis 3 MNO-ve 2014 - 2018 (ne lek).....	56
Tabela 15: MTR-Benchmarku BEREC (Pure LRIC).....	58
Tabela 16: Tarifat maksimale për MTR (deri në një vendimmarrje tjetër të AKEP për këtë treg).....	59
Tabela 17: Mënyra e aplikuar për rregullimin e MTR nga vendet e BEREC 2018	60
Tabela 18: Trafiku i terminuar ne rrejtin TA, i tranzituar nga operatorët lokale 2018.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 19: Trafiku ndërkombëtar drejt numrave Port-Out 2018.....	Error! Bookmark not defined.
Tabela 20: Volumi dhe tarifat për terminimin/tranzitimin e thirrjeve në operatorët kombëtar në rrjetin Vodafone	Error! Bookmark not defined.
Tabela 21: Tranzitimi dhe terminimin në rrjetin Vodafone i trafikut ndërkombëtar hyrës nga carrier ndërkombëtarë	Error! Bookmark not defined.

Tabela 22: Tarifat mesatare e terminimit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare në Albtelecom (eur.min).....Error!
Bookmark not defined.

1. Përmbledhje ekzekutive

1. Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në rrjetet celulare së bashku me analizën për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është përgatitur në zbatim të Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe merr në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian, me synimin përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë.
2. Qëllimi i analizës së tregut, shpalljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse, marrja e masave rregullatore dhe miratimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjeteve celulare është:
 - a. *Të promovojë efikasitetin e rrjeteve celulare;*
 - b. *Të promovojë konkurrencën e qëndrueshme në tregun me pakicë të shërbimeve celulare;*
 - c. *Të mundësojë përfitimet me të mëdha të mundshme të abonentëve nga shërbimet e komunikimeve elektronike(celulare);*
3. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme është pjesë e rregullores për “*Analizën e Tregut*” miratuar me VKD NR. 9, datë 17.07.2009, e ndryshuar(Rregullorja), sipas së cilës AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse (në të cilën përfshihet edhe ky treg) si tregje të mundshme për ndërhyrje ex-ante në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike.
4. Me ligjin Nr. 107/2018, datë 20.12.2018, Kuvendi vendosi që në ligjin datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa:
 - a. Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime”.
5. AKEP me vendimin Nr.70 datë 01.10.2018 vendosi për “*Miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - dokumenti përfundimtar*” dhe me vendimet 71, 72 dhe 73 vendosi për “*Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm*” respektivisht për Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.
6. AKEP me vendimin Nr. 89 datë 15.11.2018 vendosi për “*Shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, dhe shfuqizimin e vendimeve të Këshillit Drejtues përkatësisht nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018. Sipas pikës 6 të këtij vendimi AKEP vendosi për “nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse referuar sa më lart, si dhe të tregjeve të tjera në*

përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri të plotë të legjislacionit të Bashkimit Evropian”.

7. Për këto arsye, AKEP ka ri-analizuar në dokumente të ndara tregjet përkatëse:
 - a. Analizën e tregjeve me shumicë të akses – origjinimit në rrjetet celulare;
 - b. Analizën e tregjeve me shumicë të terminimit në rrjete celulare përfshirë terminimin ndërkombëtar.
8. AKEP me VKD nr.10, datë 17.04.2019 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”. Dokumenti u publikua ne faqen e Internetit te AKEP dhe këshillimi publik u krye gjatë periudhës 18.04.2019 – 20.06.2019 gjatë së cilës janë administruar qëndrimet e palëve të interesit dhe diskutimet me shërbimet e Komisionit Evropian dhe Autoritetin e Konkurrencës të cilat paraqiten të plota në aneksin e dokumentit.
9. Lidhur me përmbajtjen e dokumentit përfundimtar, në kapitullin 2 paraqiten proceset e analizës së tregjeve përkatëse sipas praktikave të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, parashikimet e legjislacionit primar dhe sekondar për rastin e Shqipërisë, procesi këshillimit dhe analizat e mëparshme të tregut. Gjithashtu, në këtë kapitull paraqitet praktika e BEREC për rregullimin e tregjeve përkatëse të terminimit, niveli mesatar i tarifave të terminimit, metodologjitë që përdoren për rregullimin dhe rastet e tarifave simetrike vs asimetrike sipas të dhënave më të fundit të mara nga BEREC dhe Cullen International. Në kreun 3 jepet një panoramë e përgjithshme e tregut dhe analiza për masat rregullatore mbi mosdiskriminimin on net vs of net. Kapitulli 4 në pjesën e parë i referohet terminimit kombëtar të thirrjeve në rrjetet celulare ndërsa në pjesën e dytë analizës së tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare. Në kapitullin 5 dhe aneksin 2 ka një informacion të shkurtër mbi ndryshimet e pritshme të tarifave të terminimit si konsekuencë e zbatimit të marrëveshjes së roamingut me vendet e rajonit ndërsa në Aneksin 3 paraqiten komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP pas përfundimit të procedurës së këshillimit publik.
10. Në konkluzionet e kreut janë analizuar vendimet në fuqi për masat rregullatore *on net vs off net* të cilat përcaktojnë të njëjtat detyrime për të tre sipërmarrësit pasi masa ishte vendosur në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve (në të cilin janë me fuqi të ndjeshme në treg) ndërkohë që analia e plotë u zhvillua në dokumentin e analizës së tregjeve me shumicë të akses-origjinimit(përfshirë shërbimet me pakicë të operatorëve të rrjeteve celulare).
11. Me vendimin Nr. 9, datë 24.04.2020 – “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “*Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare*”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi: (i) “*Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduriale të parashikuara nga ligji 9918/2008*” dhe Rregullorja 9/2009 dhe (ii) *të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësisimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores. Për këtë arsye AKEP vlerëson se kjo masë e ka dhënë efektin e saj në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe si e tillë të vazhdojë të qëndrojë deri në një analizë tjetër nga ana e AKEP për këtë masë.*

12. Në rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2009 thuhet, që pas vitit 2012, Autoritetet Rregullatore Kombëtare duhet të vendosin tarifa simetrike për terminimin e thirrjeve për ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse dhe ato mobile, duke u bazuar në modelet e kostove të një operatori eficient. Kosto këto të cilat duhet të llogariten duke përdorur metodën bottom-up 'PURE' LRIC.
13. Duke vlerësuar qëndrimet e operatorëve të rrjeteve celularë, parashikueshmërinë dhe qendrueshmërinë e vendimeve të AKEP dhe procesin aktual të marrjes së asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një modeli kostosh BU-LRIC, AKEP shpall sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare tre operatorët Vodafonë, Telekom dhe Albtelecom dhe të mbajë taifën aktuale maksimale 1.11 lek/min për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare sipas benchmarkut Pure LRIC të BEREC deri në përfundim të projektit në zbatim të asistencës teknike për Modelin e Kostove dhe analizën e rradhës së tregjeve përkatëse.
14. Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka analizuar në mënyrë të plotë argumentet pro dhe kundër për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas disa varianteve të diskutuara për këshillim publik si (i) klasifikimi si treg nën rregullim me masat e mosdiskriminimit dhe transparencës, (ii) rregullimin e tarifës së terminimit ndërkombëtar mbi bazën e reciprocitetit, (iii) rregullimi tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare për të konverguar me tarifën e terminimit të brendshëm në rrjetet celulare nëpërmjet një glide path afatshkurtër dhe (iv) lënia e tregut në derregullim sipas praktikave të shumicës së vendeve antare të BE/BEREC.
15. AKEP pas analizës së faktorëve që ndikojnë në këtë treg dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian dhe qëndrimin të Operatorëve të Rrjeteve Celulare për shkak të zonës gjeografike të rregullimit jashtë territorit të RSH dhe me efekte negative të ardhurat e operatorëve dhe buxhetit të shtetit dhe pa efekte reale të çmimit me pakicë të shërbimeve të operatorëve celularë të përdoruesit e këtyre shërbimeve.
16. AKEP duke mirëkuptuar interpretimet dhe pretendimet e palëve që jo domosdoshmërisht përputhen plotësisht me analizën, gjetjet, konkluzionet dhe masat e propozuara në dokumentin për konsultim publik, falenderon të gjithë palët e interesuara që paraqitën qëndrimet e tyre gjatë konsultimit publik të zhvilluar gjatë periudhës 18.04.2019 – 20.06.2019. Për efekt të transparencës, komentet e palëve të interesuara (përjashtuar ato që janë konfidenciale dhe/ose përmbajnë sekrete tregtare) do të publikohen nga AKEP, së bashku me dokumentin final të analizës së tregut dhe vendimet për FNT.
17. Dokumentet e analizës, opinionet e palëve të interesuara dhe qëndrimet e AKEP rreth çështjeve kryesore, në zbatim të vendimit Nr. 89 , datë 15.11.2018 të Këshillit Drejtues sipas të cilit "AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfutur ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces", janë diskutuar gjerësisht me një numër ekspertësh të Komisionit Evropian në dy *conference call* dhe në takime dypalëshe (OFcom, Komisioni Evropian) apo konferenca (BEREC etj).

2. Hyrje

18. Sipas parashikimeve të rregullores nr. 9/2009 “Mbi analizën e tregjeve”, e ndryshuar, në këtë dokument jepet përkufizimi i detajuar i tregut përkatës, dimensionit gjeografik dhe ai i produktit/shërbimit.
19. Bazuar në parashikimet e nenit 35, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, AKEP-i nxorri për këshillim publik dokumentin me grupet e interesit për përfundimet e arritura në analizën e tregut, përkatësisht sipas neneve 32 e 34 të këtij ligji.
20. Rishikimi dhe rregullimi i tregjeve të komunikimeve Elektronike është një proces mjaft teknik dhe kompleks, dhe si i tillë bazohet në implementimin e plotë të legjislationit Shqiptar, gjithashtu merr në konsideratë edhe një sërë udhëzimesh dhe rekomandimesh të Komisionit Evropian për të vënë në zbatim praktikatat sa më të mira në fushën e rregullimit të komunikimeve elektronike në vendet e Evropës dhe më gjerë, me qëllim nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike.

Parashikimet ligjore dhe rregullatore të Analizës së tregut

21. Ligji nr.9918, date 19.05.2008 ”Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (ne vijim Ligji 9918), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
22. Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, përcakton midis të tjerave se AKEP nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.
23. Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrencës, përmban përcaktimet për rregullimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike, dhe përfshin ndërmjet të tjerave detyrimin e AKEP për kryerjen e analizës së tregut për vlerësimin e konkurrencës efektive dhe përcaktimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg. Kreu VI, përmban gjithashtu kriteret e përdorura nga AKEP për vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, detyrimet/masat rregulluese në rast të gjetjes së FNT.
24. Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin për një rregullore për analizën e tregjeve dhe përcaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren për Analizën e Tregjeve (në vijim referuara si Rregullorja), dhe me Vendimin nr. 2342, date 31.07.2013, ka miratuar amendime të kësaj Rregulloreje. Rregullorja përcakton midis të tjerave një listë prej 7 tregjeve për t’u analizuar nga AKEP për FNT, si dhe detyrimin për të kryer testin e tre kriterëve për tregjet që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të rregullores ose e

Rekomandimit ne fuqi te Komisionit European per tregjet perkatese te dyshuara per nderhyrje *ex-ante* ne sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve te perfshira ne rregullore eshte sipas rekomandimit te KE te vitit 2007, ndersa rekomandimi i fundit ne fuqi i KE eshte Rekomandimi 2014/710/EC i dates 9 Tetor 2014.

25. Bazuar në rregulloren Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme si tregje të mundshme për nderhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, inter allias:

- ***Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të levizshme.***

Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve

26. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike ne RSH”, i ndryshuar, ka si objektiv nxitjen e konkurrencës efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera.

27. Analiza e tregut është një proces nëpërmjet të cilit, në baza periodike (jo më pak se një herë në dy vite), AKEP duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare përcakton tregjet përkatëse, dhe në vijim të kësaj analize përcakton nëse në këto tregje ka konkurrencë efektive. Në rastet kur AKEP evidenton se një apo më shumë sipërmarrës ka/kanë Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), atëherë ai vendos masat e nevojshme të njohura si kushtet dhe detyrimet për FNT, me qëllim adresimin e problematikave të tregut. Konceptin e FNT do ta spjegojmë më poshtë.

28. Gjatë këtij procesi, AKEP ushtron të drejtën e tij në rregullimin e këtij sektori specifik si rregullator i vetëm i pavarur në Republikën e Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. AKEP ushtron funksionet e tij në mbështetje të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918/2008) dhe akteve të tjera rregullatore, si edhe duke marrë në konsideratë Direktivat dhe Rekomandimet e Komisionit Evropian.

29. Ligji ligji 9918/2008 parashikon se kur AKEP-i gjykon se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve (analizat pararendëse), kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë AKEP-i rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse. Pavarësisht kësaj praktike, AKEP-i është i detyruar që një herë në dy vjet të rishikojë përfundimet për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, duke paraqitur përfundimet përkatëse. në fushën e komunikimeve elektronike.

30. Çdo analizë tregu normalisht kalon nëpërmjet një procesi me disa faza, përkatësisht:

- Identifikimi dhe përcaktimi i tregjeve përkatëse;
- Vlerësimi i sipërmarrësit/sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg;
- Vendosja e masave rregullatore dhe detyrimeve përkatëse.
- Rregullimi i tarifave për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse;

Praktika e Komisionit Evropian

Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE të vitit 2003 dhe 2009 dhe metodologjia e analizës së tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore, përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Evropian dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe udhëzimet e KE dhe BEREC (më parë ERG) të marra në konsideratë nga AKEP në përgatitjen e këtij dokumenti janë si më poshtë:

- 1- Udhëzimi i Komisionit (evropian) për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)¹;
- 2- Dokumenti i rishikuar i ERG² për Qëndrim të përbashkët në qasjen ndaj masave rregullatore të duhura në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike;
- 3- Rekomandimi i Komisionit, datë 7 Maj 2009 për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjete celulare dhe fikse në BE;
- 4- Rekomandimi i Komisionit, datë 9 Tetor 2014 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC);
- 5- Udhëzuesin e rishikuar të Komisionit Evropian për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT (SMP guidelines FLTEEP20180015 - May 6, 2018).

Gjithashtu, është mbajtur parasysh edhe "*Qëndrimi i Përbashkët ERG të Rishikuar për Aksesin në Mjetet e përshtatshme në kuadrin rregullator të ECNS*", hartuar nga BEREC.

Udhëzimet dhe parimet e mishëruara në dokumentin e mjeteve juridike të BEREC-it synojnë të nxisin zhvillimin e tregut të vetëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, si dhe të bëjnë të mundur një praktikë rregullatore uniforme dhe konsistente në shtetet e ndryshme anëtare.

Legjislacioni dhe baza rregullatore e aplikuar nga AKEP për përcaktimin e një operatori me FNT është e përafëruar me atë të KE. Sipas legjislacionit të KE një sipërmarrës përcaktohet me FNT nëse një ose më shumë ndërmarrje kanë fuqi ekonomike, që i/u jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

Në rekomandimin e vitit 2014, numri i tregjeve të dyshuar për ndërhyrje *ex-xante* është reduktuar në 5, nga 7 që ishte në vitin 2007.

¹ Official Journal of the European Communities C 165/7: "*Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)*"

²ERG (06) 33 "*Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework*" Final Version May 2006.

2007 markets		2014 markets	
Wholesale fixed call termination	3	Wholesale fixed call termination (unchanged)	1
Wholesale mobile call termination	7	Wholesale mobile call termination(unchanged)	2
Wholesale (physical) network infrastructure access	4	Wholesale local access at a fixed location - WLA (redefined)	3a
Wholesale broadband access	5	Wholesale central access for mass-market products - WCA (redefined)	3b
Wholesale terminating segments of leased lines	6	Wholesale high-quality access at a fixed location (redefined)	4
Retail fixed line access	1	No longer on the list	-
Wholesale fixed call origination	2	No longer on the list	- ³

KE më 7 Maj 2018 ka miratuar udhëzimin e ri për analizën e tregut dhe FNT “*Guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the EU regulatory framework for electronic communications networks and services*” (2018/C 159/01), që zëvendëson Udhëzimin e vitit 2002. Ky udhëzim është marrë në konsideratë nga AKEP në hartimin e këtij dokumenti për këshillimin publik.

31. Udhëzimi për FNT (KE) e përcakton në mënyrë të qartë që përcaktimi i tregut përkatës nuk është një proces mekanik apo abstrakt. Ai kërkon një analizë të detajuar të gjithë të dhënave të disponueshme për ecurinë dhe sjelljen në treg në të kaluarën dhe një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave dhe funksionimi të tregut në të tashmen. Për sa kohë analiza e tregut është një proces i cili synon përmirësimin e kushteve të tregut në të ardhmen (*Forward looking*), udhëzimet për FNT e përcaktojnë në mënyrë të qartë që rregullatori duhet të evidentojë nëse tregu është konkurrues ose jo, dhe në këtë mënyrë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës efektive, duke marrë në konsideratë parashikimet për zhvillimet e ardhshme të pritshme të tregut gjatë një periudhe të arsyshme, të marrë masat përkatëse për evitimin e pengesave dhe kufizimeve të konkurrencës efektive.
32. Udhëzimi për përcaktimin me FNT përshkruan se si metodologjia e legjislacionit të konkurrencës mund të përdoret nga rregullatorët e telekomunikacionit në analizat e tyre. Në veçanti, janë dy dimensione për përcaktimin e tregut përkatës: produktet përkatëse që bëjnë pjesë në të njëjtin treg dhe përcaktimi i tregut gjeografik. AKEP për përcaktimin e tregut përkatës përdor përkufizimin e dhënë në nenin 3, pika 7 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar: “*Treg përkatës- janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese*”.
33. Ky përkufizim i Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, është i ngjashëm dhe në linjë me përkufizimin e dhënë në Udhëzimin e KE, pika 44 8 , udhëzim

³ Cullen International

i përdorur nga AKEP (ERT) në të gjitha analizat e mëparshme. Për këtë arsye si dhe duke qenë se udhëzimi i KE, është pjesë e dokumentave të KE të referuara në Rregullore për analizën e tregut, AKEP në këtë Analizë përdor të njëjtën metodologji për përcaktimin e produkteve/shërbimeve që janë pjesë e të njëjtit treg përkatës, si dhe në Analizat e tjera të tregut, sic është shtjelluar dhe në paragrafet në vijim.

Procedura e Analizës së Tregut

34. Gjatë procesit të kryerjes së analizës së tregut, synimi kryesor i rregullatorit është që të evidentojë dhe ti ti përgjigjet pyetjes nëse në treg ka konkurrencë efektive? Përcaktimi i termit Fuqi e Ndjeshme në Treg është ekuivalent me konceptin e Pozitës Dominuese sipas përcaktimit që bëhet nga ligji i konkurrencës. Në thelb, kjo nënkupton që sipërmarrësi në tregun përkatës zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Praktika e Komisionit Evropian për përcaktimin e Fuqisë së Ndjeshme në Treg

Sipas udhëzuesit të rishikuar të Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg⁴ i cili mbështetet në analizën e tregjeve të komunikimeve elektronike bazuar mbi parimet e konkurrencës, Fuqia e Ndjeshme në Treg e një sipërmarrësi (single dominance) vlerësohet kur një sipërmarrës i vetëm zotëron mbi 40 % të tregut përkatës dhe prezumohet kur zotëron mbi 50 % të tregut përkatës.

Tabela nr.: Udhëzuesi i rishikuar i Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg (SMP)

Dominancë individuale (Single SMP)	Udhëzimi i vjetër për FNT	Udhëzimi i ri për përcaktimin FNT
Supozohet që nuk ka FNT	Poshtë 25%	Nuk ka udhëzime
Risku i FNT	Mbi 40% "Në praktikën vendimmarrëse të komisionit, dyshimet për dominancë individuale normalisht shfaqen në rastet kur një sipërmarrës gëzon pjesë tregu mbi 40%, megjithatë në disa raste Komisioni ngre dyshimet për ekzistencën e dominancës individuale edhe kur një sipërmarrës ka pjesë tregu më të vogël se 40% (pasi dominanca mund të ekzistojë edhe kur një sipërmarrës nuk posedon pjesë të mëdha tregu).	Mbi 40% "Bazuar në eksperiencat e kaluara Komisioni sugjeron se dominanca individuale nuk ka gjasa të ndodhë në rastet kur një sipërmarrës posedon më pak se 40% të tregut përkatës. Megjithatë, mund të ketë raste specifike me pjesë tregu nën këtë nivel ku konkurrentët nuk kanë mundësinë të konkurrojnë në mënyrë efektive sjelljen e një sipërmarrësi dominant.
Supozohet që ka FNT	Mbi 50%	Mbi 50%

Burimi: European Commission issues revised SMP guidelines 6 May 2018 dhe Cullen Interantional

Sipas parashikimeve të nenit 102 TFEU mbi abuzimin me pozitën dominuese "një ose më shumë sipërmarrës" mund të gëzojnë një pozicion dominant në treg. Edhe sipas nenit 33.1 të ligjit "Për

⁴ European Commission issues revised SMP guidelines 6 May 2018

komunikimet elektronike në RSH”, “një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë”.

Parë në këtë këndvështrim dhe hierarkinë e nenit, fillimisht analizohet nëse një sipërmarrës i vetëm, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë dhe nëse ky kusht plotësohet atëherë përjashtohet dominanca e dy ose më shumë sipërmarrësve.

Treguesit kryesor sipas udhëzuesit të rishikuar të Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg janë:

- Refuzimi i aksesit në tregjet e shumicës (terminimit);
- Mbajtja e Pjesëve ekzistuese të tregut;
- Mbajtja e çmimeve ekzistuese të shumicës/pakicës;
- Kufizimi ofertës(ose vonesat teknike dhe ekonomike për përditësimin e rrjeteve.

Përcaktimi i Fuqisë së Ndjeshme në Treg është dhënë në nenin 33 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, ku citohet:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Ky përkufizimi është pothuajse i njëjtë me përkufizimin e Direktivës Kuadër të KE 2002, neni 14⁵ (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar.

Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

- a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;
- b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;
- c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;
- d) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;

⁵ ‘an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers”

- e) në fazën e tregut përkatës;
- f) në përparësitë teknologjike;
- g) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;
- h) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;
- i) në shkallën e integritit vertikal;
- j) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;
- k) në aksesin në burimet financiare;
- l) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;
- m) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifatat, paketat e shërbimeve dhe të produktit.

Vendosja e masave rregullatore

35. Në përfundim të procesit të analizës së tregut përkatës, AKEP konkludon nëse në treg ka sipërmarrës të përcaktuar me FNT. Nëse një apo më shumë sipërmarrës është përcaktuar me FNT në tregun përkatës, atëherë AKEP sipas përcaktimeve të nenit 36 të ligjit 9918/2008, vendos, ndryshon, mban ose heq masat rregullatore të parashikuara në këtë nen.
36. **Në tregun përkatës të terminimit secili operator i rrjetit të shërbimeve celulare është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, përfshirë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare;**

Procedura e këshillimit publik

37. Në zbatim të parashikimeve të Ligjit 9918/2008 AKEP zhvillon një procedurë transparente të këshillimit publik për dokumentet e analizës në një proces dinamik duke publikuar në mënyrë të plotë informacionet dhe qëndrimet e tij rreth analizës së tregjeve përkatëse, operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe masat rregullatore të propozuara, përfshirë dhe rregullimin e tarifës së terminimit. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.10, datë 17.04.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, periudha e këshillimit publik 18.04.2019 – 20.06.2019.
38. Në përfundim të këshillimit publik në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:
- Autoriteti i Konkurrencës me vendimin Nr. 634, Datë 04.07.2019 “*Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”*”
 - Telekom Albania sh.a me shkresën Nr.3044, datë 13.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1112/1, datë 18.06.2019);
 - Albtelecom sh.a me shkresën Nr.4560, datë 20.06.2019, (Referenca e AKEP nr. 1112/2, datë 20.06.2019);

- Vodafone Albania sh.a me shkresën Nr. CEO/006/KQ, datë 18.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1112/3, datë 21.06.2019);
 - Neofone sh.p.k me shkresën Nr.346, datë 19.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1113/5, datë 20.06.2019);
39. Pas marrjes së opinionit të palëve të interesuara, AKEP zhvilloi diskutime në formë elektronike me ekspertët e Komisionit Evropian të cilët lidhur me miratimit e MTR kombëtar sugjeruan vijimin e metodës së *benchmarkut rajonal* (vendet e BE) e cila përdoret nga disa vende, deri në realizimin e projektit të asistencës teknike për modelet e kostos si një metodologji e pranuar gjerësisht edhe në praktikën e BE/BEREC.
40. Pas marrjes së opinionit të ekspertëve të BE-së, AKEP zhvilloi disa takime me të tre operatorët e rrjeteve celulare për të diskutuar konkluzionet e diskutimeve me shërbimet e Komisionit Evropian dhe vijimin e procedurës së miratimit të dokumentit të analizës së tregut përkatës. AKEP duke mirëkuptuar interpretimet dhe pretendimet e palëve që jo domosdoshmërisht përrupthen plotësisht me analizën, gjetjet, konkluzionet dhe masat e propozuara në dokumentin për këshillim publik dokument, falenderon palët që kanë paraqitur komentet e tyre brenda një periudhe dy mujore nga data e publikimit në faqen e Internetit të AKEP.
41. Për efekt të transparencës, komentet e palëve të interesuara (përfshijtur ato konfidenciale) do të publikohen nga AKEP, së bashku me dokumentin final të analizës së tregut dhe vendimet për FNT.

Analizat e mëparshme në tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare

42. Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka qene objekt rregullimi ex-ante nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010 deri në Mars 2014, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC⁶ i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare. Modeli BULRAIC në vitin 2010 tashmë referohet si LRIC+ ndërsa metoda e rekomanduar nga KE dhe e përdorur në shumicën e vendeve evropiane tashmë është Pure LRIC.
43. AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celulare (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom.
44. Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122,

⁶ *Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)*

datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communication.

45. Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom Albania, Vodafone dhe Albtelecom janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e koston 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus me vendimet e dates 4.07.2012 u vendos qe tarifa e terminimit te arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015.
46. AKEP me vendimet nr.2431-2435, date 13.03.2014, vendosi qe tarifat e terminimit te kater operatoreve te reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 per te arritur ne nivelin 1.48 lek/minute ne 1.01.2016, e cila eshte sa vlera mesatare e tarifave te terminimit ne vendet Evropiane qe kane aplikuar LRIC te paster ne vitin 2013.
47. Duke filluar nga Prill 2014 AKEP ka përdorur sërish metodën benchmark për rregullimin e tarifave MTR, si benchmark është përdorur vlera mesatare e tarifave te terminimit ne vendet Evropiane qe kane aplikuar modelin e kostove LRIC te pastër, sipas rekomandimit të vitit 2009 të KE. Edhe në proceset e këshillimit publik në Dhjetor 2016 dhe Shkurt 2018, AKEP vendosi qe MTR të rregullohen sipas kësaj metode duke propozuar glide path përkatëse.
48. Bazuar në gjetjet e analizes se tregut 2014, AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, përcaktoi që tarifa 1.48 lek/minutë të fillonte të aplikohet që prej datës 1.12.2014 për Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, ndërsa tarifa e terminimit në rrjetin Plus të qëndronte në vlerën 6.52 lek/minutë deri në një vendim tjetër të AKEP.
49. Bazuar në procesin e shqyrtimit të ankimeve administrative të katër operatoreve celularë për vendimet e datës 6.11.2014, AKEP me Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015, ndryshoi tarifen e terminimit në rrjetin Plus (të përcaktuar me vendimet e datës 6.11.2014), duke përcaktuar një glidepath (reduktim të përshkallëzuar) në mënyrë që tarifa e terminimit në rrjetin Plus të arriente nivelin 1.48 lek/minutë më datë 1.01.2016. Reduktimi u përcaktua të kryhej me dy faza të ndërmjetme që fillonin me 1.04.2015 dhe 1.07.2015.
50. AKEP në vijim të Vendimeve për monitorim të situates ne treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD nr.2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatorët për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.
51. AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit te filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR-ve për të gjithë operatorët.
52. AKEP nëpërmjet Vendimit Nr.2699, datë 01.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut ishte 7-12.2016 -7.02.2017. Në lidhje me FNT në treg, AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik propozoi që të katër sipërmarresit e rrjeteve celulare të vijojnë të përcaktohen me statusin e FNT për terminimin e thirrjeve në secilin prej rrjeteve te tyre.
53. Ne lidhje me masat rregulluese AKEP propozoi që operatorët celularë të vijojnë zbatimin e masave rregulluese të përcaktuara nga analiza e mëparshme e tregut celular, transparenca, mos-

diskriminimi, përfshirë detyrimin e mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net, detyrimi për akses dhe interkoneksion, si dhe detyrimin për kontrollin dhe rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve të katër operatoreve celulare.

54. Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të terminimit, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do të zhvillojë një proces të veçantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të përcaktuar metodën e kontrollit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në këto tregje përkatës.
55. Në përputhje me sqarimin e cituar, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2700, datë 22.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*, për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës dhe modalitetet e tjera të rregullimit të këtyre tarifave. Dokumenti u publikua ne faqen e Internetit te AKEP dhe keshillimi publik u krye ne periudhen 22.12.2016-7.02.2017.
56. Bazuar në kërkesën e Vodafone Albania, Këshilli Drejtues i AKEP në mbledhjen e datës 16.02.2017, vendosi për shtyrjen e periudhës së këshillimit publik të këtij dokumenti si dhe dokumentit *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare -Këshillim Publik”* për një afat maksimal jo më shumë se 60 ditë nga data 16.02.2017. Njoftimi për shtyrjen e afatit të këshillimit publik u publikua në faqen e Internetit të AKEP dhe i`u dërgua në rrugë shkresore palëve kryesore të interesuara.
57. AKEP me shkresën Nr.1907/9 Prot., datë 8.05.2017, kërkoi që operatorët deri më 15.05.2017 të depozitonin pozicionin final të tyre për dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016 për analizën e tregut celular. AKEP me shkresën nr.2285 prot., datë 16.12.2017 i kërkoi operatorëve celularë Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelcom që në vijim të përfundimit të procesit të konsolidimit të tregut celular (me delajen nga tregu të Plus Communication më 1.01.2018), brenda datës 15.01.2018, të depozitojnë komentet finale në lidhje me dy dokumentat e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.
58. Pas marrjes se komenteve, AKEP me vendimin Nr.11 datë 22.02.2018 miratoi dokumentin *“Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar”* dhe me Vendimet nr.12, 13 dhe 14, datë 22.02.2018 vendosi:
 - *“Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”*;
 - *“Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese”*;
 - *“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelcom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelcom dhe vendosjen e masave rregulluese”*.

59. Në lidhje me masën rregulluese të rregullimit të MTR, AKEP bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg⁷, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018, përgatiti një version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR për këshillim publik me palët e interesuara.
60. AKEP me Vendimin nr.15, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*. Periudha e konsultimit publik ishte 26.02.2018 – 29.03.2018.
61. AKEP me Vendimin nr.70 datë 1.10.2018 vendosi miratimin e Dokumentit: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”*.
62. Me vendimet Nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetete celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-te me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR në nivelin e 1.22 lek/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lekë/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuara në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC deri në 2016 dhe Korrik 2017 respektivisht.
63. Gjatë analizave të tregut të shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në vitin 2018, tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare u trajtua si treg i ndarë nga ai i terminimit të thirrjeve kombëtare. Terminimi i thirrjeve ndërkombëtare ishte pjesë e dokumentit *“Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare”*.
64. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin Nr.78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin *“Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”*, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin Nr.79, datë 1.10.2018 ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet Nr.80 dhe Nr.81 datë 01.10.2018 përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom Sh.a dhe sipërmarrësin Telekom Albania Sh.a me Fuqi te Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.
65. Të tre sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom u shpallën me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, dhe u vendosën masat përkatëse rregullatore për Detyrimin e mosdiskriminimit dhe Detyrimin e transparencës.

⁷ Dalja e Plus Communication nga tregu

66. AKEP me vendim nr.89 datë 15.11.208, miratoi shfuqizimin e Vendimit Nr.78, datë 01.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: *“Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”* dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP. Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri me legjislacionin e Komisionit Evropian. AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfituar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces.
67. Me vendimin Nr.10, datë 17.04.2019, miratoi për këshillim dokumentin *“Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”* i nxjerrë për këshillim publik gjatë periudhës 18.04.2019 – 20.06.2019, mbi bazën e këtij dokumenti dhe komenteve të palëve të interesuar është hartuar ky dokument përfundimtar për analizën e tregut të terminimit të thirrjeve kombëtare, duke përfshirë edhe thirrjet ndërkombëtare. Palët e interesuara paraqitën pranë AKEP komentet e tyre të cilat janë atashuar në këtë dokument së bashku me qëndrimin e AKEP për këto komente.

2. Praktika e BEREC për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare (Benchmark)

68. Ky kapitull përmban informacion mbi dokumentet e KE dhe BEREC që kanë lidhje me tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Në seksionin e parë përshkruhen elementet kryesore të rekomandimeve të KE për tarifat e terminimit, ndërsa seksionet e tjera përmbajnë informacion në lidhje me tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC dhe krahasime të këtyre tarifave me tarifat e terminimit në Shqipëri.
69. Tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC në dokumentin *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare– Dokument përfundimtar”*, të miratuar në Tetor 2018, janë përditësuar sipas dokumenteve më të fundit të publikuar nga BEREC, duke dhënë shënimet/sqarimet përkatëse.

2.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator

70. Komisioni Evropian, BEREC në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, ka rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Evropian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin*

rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC), ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifat duhet të jenë simetrike. Për përcaktimin e shkallës minimale të eficensës për operatorët celularë rekomandohet të përdoret një operator me pjesë tregu 20%;
- Vlerësimi i kostove efiente të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metoden BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Rregullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD, i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC+;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstrohet se hyrësit e rinj kanë dizavantazh në raport me operatorët e tjerë.
- Vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli kostosh LRIC të pastër mund të përdorin metodën benchmark duke i'u referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.

71. Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë, dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC). Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe njëkohësisht ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit.

2.2 Propozimi i KE per rishikimin e kuadrit rregullator te komunikimeve elektronike

72. KE nëpërmjet dokumentit të datës 11.10.2018, DIRECTIVE (EU) 2018/1972 “*Directive of the European Parliament and of the Council establishing the European Electronic Communications Code*”, ka caktuar BEREC që të hartojë një set masash rregullatore dhe udhëzime në funksion të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike. Në lidhje me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, KE ka propozuar ndër të tjera që:

- Në rastet kur autoriteti rregullator kombëtar për operatorët me FNT për terminimin e thirrjeve vendos masën e kontrollit të tarifës dhe orientimit në kosto, rregullatori duhet të përcaktojë tarifa maksimale simetrike për terminimin bazuar në kostot e një operator eficient;
- KE do të përcaktojë një çmim tavan për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, i cili nuk do të jetë më i madh se 1.23 eurocent/minutë;
- Metodologjia e kostove duhet të bazohet në kostot korrente dhe në modelin Bottom-Up duke përdorur kostot LRIC të lidhura me trafikun për ofrimin e shërbimit të terminimit palëve të tjera;
- KE, në bashkepunim me BEREC, do të përcaktojë specifikime për modelin e kostove dhe metodologjia e kostove dhe çmimi tavan për terminimin do të rishikohen cdo 5 vjet nga Komisioni.

2.3 Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC

73. Për sa i përket nivelit të tarifave mesatare të aplikuara në vendet e BE dhe BEREC, AKEP ka grumbulluar informacion duke i'u referuar burimeve të mëposhtëme:
- Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifatat e terminimit në rrjetet celulare;
 - Të dhëna të publikuara nga BEREC dhe Cullen International në lidhje me metodën e rregullimit të MTR-ve.
74. AKEP në dokumentat e mëparshme për tarifatat benchmark të terminimit në rrjetet celulare ka përdorur të dhëna të publikuara nga KE dhe nga BEREC. Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifatat e terminimit në vendet e BE, përmbajnë tarifatat e aplikuara në 28 vendet anëtare të BE në vitin 2014, dhe KE nuk ka publikuar më të dhëna për këtë tregues në faqen e internetit për axhendën digitale. Të dhëna më të përditësuara dhe detajuara për tarifatat e terminimit në vendet e BE-së tashmë mund të gjenden në publikimet e BEREC dhe Cullen International, dhe AKEP në këtë dokument i referohet kryesisht këtyre burimeve për të dhënat në lidhje me tarifatat e terminimit të aplikuara në vendet e BE dhe BEREC dhe metodave të përdorura për rregullimin e tyre.


2.4 Tarifatat mesatare të terminimit celular (MTR) në vendet e BE/BEREC

75. BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC. Në listën e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet janë çdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC, i përket datës në 6 Dhjetor 2018, dokumenti *BoR (18) 218 "Termination rates at European level-July 2018" 6 December 2018*,⁸ i cili paraqet situatën e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 Korrik 2018. Dokumenti i BEREC përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit përmban informacion të detajuar edhe për tarifatat e terminimit sipas operatorëve në çdo vend dhe metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe 'glide path' të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.
76. Figura e mëposhtme paraqet tarifatat mesatare të terminimit MTR në secilin prej vendeve të BEREC të aplikuara më 1 Korrik 2016, si dhe tarifatat mesatare në nivel BE 28 dhe në të gjitha vendet e BEREC (37 vende). Në këtë publikim për herë të parë përfshihet dhe Shqipëria⁹ si vend që aderon në BEREC.

Figura 1: Tarifatat MTR sipas vendeve të BEREC (Korrik 2016)

⁸ https://berec.europa.eu/enq/document_register/subject_matter/berec/reports/8306-termination-rates-at-european-level-july-2018

⁹ Për Shqipërinë tarifa e terminimit më 1.07.2016 është raportuar në nivelin 1.48 lek/ minutë për të katër operatorët sipas vendimeve të AKEP, me shënimin se tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication është objekt i Vendimeve të Gjykatave të RSH.



Burimi: BEREC, BoR (16) 218, Dhjetor 2016

77. Nga të dhenat vihet re se tarifat MTR në vendet BEREC variojnë nga 0.4 eurocent në Maltë në 5.9 eurocent në Zvicër (vend që nuk bën rregullim ex-ante të MTR-ve). Tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC variojnë nga 1.04 eurocent/min, që është mesatarja e thjeshtë aritmetike në 28 vendet anëtare të BE (AVeEU28(S)) deri në 1.27 eurocent/min që është mesatarja e thjeshtë aritmetike e 37 vendeve të BEREC (Average S). Tarifa e terminimit në Shqipëri është pak më e lartë se mesatarja e thjeshtë në vendet e BE, por më e ulët se tre mesataret e tjera të përlogaritur nga BEREC.


78. Figura e mëposhtme përmban një përditësim të informacionit mbi tarifat benchmark të MTR në vendet e BE dhe BEREC deri në Korrik 2017 sipas dokumentit më të fundit të BEREC BoR (17) 227 “Termination rates at European level-July 2017” 7 December 2017¹⁰.

Figura 2: Tarifat MTR sipas vendeve të BEREC (Korrik 2017)

¹⁰ http://www.berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/7524-termination-rates-at-european-level-july-2017

MTR per country – July 2017 (eurocents per minute of service)

Figure 2 MTRs




Source: NRAs, BEREC

Burimi: BEREC, BoR (17) 227, Dhjetor 2017

79. Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, nga krahasimi me MTR të vitit 2016 vërehet se ka reduktim të MTR, konkretisht tarifa mesatare e ponderuar e vendeve të BE-së është reduktuar në 0.9079 eurocent për minutë, nga 1.0836 eurocent për minutë në vitin 2016. Gjithashtu, edhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet e analizuar ka pësuar rënie, duke arritur nivelin 0.9262 eurocent për minutë në vitin 2017, nga 1.1358 eurocent që ishte në vitin 2016.

80. BEREC në Dhjetor 2018 ka publikuar të dhënat më të fundit për MTR në deri më Korrik 2018, të cilat janë dhënë në figurën e mëposhtme.

Figura 3: Tarifat MTR sipas vendeve te BEREC (KORRIK 2018)



Burimi: BEREC, BoR (18) 218 Dhjetor 2018

81. Sipas të dhënave të këtij dokumenti të BEREC tarifat MTR mesatare e ponderuar në vendet e BE/BEREC rezultojnë 0.8541 eurocent për minutë, (1.088 lek)¹¹ nga 0.9079 eurocent (1.22 lek) për minutë në vitin 2017 dhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet në analizë (37 vendeve të BEREC) rezultojnë 0.8467 eurocent (1.078 lek) duke shënuar rënie me rreth 9% në krahasim me 0.9262 eurocent (1.245 lek) për minutë në vitin 2017.
82. Duke zgjedhur metodën benchmark për përcaktimin e tarifës së terminimit sipas mesatares së vendeve të BE/BEREC që përdorin modelin BULRIC i paster (Pure BU-LRIC), MTR në Shqipëri prej 1.11 lekë është shumë pranë mesatares së ponderuar të vendeve të BE/BEREC. Pas përfundimit të projektit të asistencës teknike për Modelin e Kostove që po zbaton aktualisht AKEP, tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare do të rishikohet sipas rezultateve të Modelit për t'ju përafër sa më shumë është e mundur të dhënave faktike të kostos për terminimin me shumicë të thirrjeve në rrjetet celulare.

2.5 Tarifa mesatare MTR e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër

83. Në vijim të vendim-marrjeve të AKEP në Mars 2014 e në vijim për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri bazuar në tarifat benchmark të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i paster (Pure BU-LRIC), në këtë seksion AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me aplikimin e këtij modeli dhe nga vendet anëtare të BEREC dhe vlerat përkatëse mesatare, që mund të përdoren si benchmark për rregullimin e MTR-ve në Shqipëri.
84. Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e tarifave të terminimit në 37 vendet që raportojnë BEREC, më 1.07.2016-1.07.2017. Informacioni është marrë nga 2 raportet e BEREC të publikuar në Dhjetor 2016 dhe Dhjetor 2017.

Tabela 1: MTR dhe aplikimi i LRIC I PASTËR BEREC 2016-2019

Nr.	Shteti	Modeli (1.07.2018)	Tarifa e terminimit (eurocent/min)		
			1.07.2016-31.12.2016	1.07.2017-31.12.2017	1.01.2018-30.06.2018
1	AT	Pure BU-LRIC	0.8049	0.8049	0.8049
2	BE	Pure BU-LRIC	1.1800	0.9900	0.9900

¹¹ Kursi i këmbimit sipas dokumentit të BEREC BoR (18) 2018, Dhjetor 2018: 1 Euro=127.35 Lek.

3	BG	Pure BU-LRIC	0.9715	0.7158	0.7158
4	CZ	Pure BU-LRIC	0.9985	0.9346	0.9688
5	DK	Pure BU-LRIC	0.7272	0.6359	0.6001
6	EL	Pure BU-LRIC	1.0810	0.9820	0.9580
7	ES	Pure BU-LRIC	1.0900	1.0900	0.7000
8	FR	Pure BU-LRIC	0.7600	0.7400	0.7400
9	HR	Pure BU-LRIC	0.8395	0.6326	0.6353
10	HU	Pure BU-LRIC	0.5457	0.5520	0.5391
11	IT	Pure BU-LRIC	0.9800	0.9800	0.9800
12	LU	Pure BU-LRIC	0.9700	0.8900	0.8900
13	MT	Pure BU-LRIC	0.4045	0.4045	0.4045
14	NO	Pure BU-LRIC	0.6976	0.6932	0.5653
15	PL	Pure BU-LRIC	0.9814	1.0178	1.0065
16	PT	Pure BU-LRIC	0.8100	0.7500	0.7500
17	SE	Pure BU-LRIC	0.8159	0.6634	0.5653
18	SI	Pure BU-LRIC	1.1400	1.1400	1.1400
19	SK	Pure BU-LRIC	1.2260	1.2260	1.2260
20	UK	Pure BU-LRIC	0.6393	0.5748	0.5650
21	IE*	Pure BU-LRIC	2.60/0.82	0.8200	0.7900
22	NL	Pure BU-LRIC	1.8610	0.5810	0.5810
23	DE	Pure BU-LRIC	1.6600	1.1000	1.0700
24	AL**	Benchmark BU-LRIC	1.0699	1.3352	1.1621
25	CY	Benchmark BU-LRIC	1.0112	0.9900	0.9900
26	EE	Benchmark BU-LRIC	0.9200	0.9200	0.8300
27	IS	Benchmark BU-LRIC	1.0032	1.0690	0.7856

28	LT	Benchmark BU-LRIC	0.9400	0.9400	0.9400
29	LV	Benchmark BU-LRIC	1.0500	1.0500	0.8868
30	RO	Benchmark BU-LRIC	0.9600	0.9600	0.8400
31	FI	other (FDC/FAC)	1.2500	1.2500	1.2500
32	CH	Not regulated	5.9232	3.3361	2.8557
33	MK	TD LRIC	1.4588	1.0220	1.0245
34	TR	BU LRAIC+	0.8064	0.6687	0.5058
35	LI	Benchmarking	3.5581	3.5971	2.4698
36	RS	Benchmarking	2.2357	1.6838	1.2101
37	ME	TD LRIC	1.1800	1.0600	0.8500
Mesatare		Eurocent	0.8838	0.8283	0.7907
Pure BU-LRIC		LEK	1.22	1.11	1.01

*Në Irlandë (IE) aplikimi i vlerës 0.82 eurocent sipas modelit Pure BULRIC ka filluar të aplikohet nga Shtatori 2016.

**Për MTR të Shqipërisë në 2 dokumentat e cituar të BEREC janë dhënë sqarimet e duhura.

85. Numri i vendeve që përdorin modelin e kostove “Pure LRIC” në dokumentin e fundit të BEREC rezulton 23 nga 24 që ishte në vitin 2017. Nga dokumentet e BEREC për vitet 2017 dhe 2018, vërehet se Rumania deri në vitin 2017 ka përdorur metodën PURE LRIC dhe gjatë vitit 2018 rezulton të ketë përdorur metodën Benchmarking.

86. Tarifa mesatare e ketyre 23 vendeve për vitin 2018 është 0.7907 eurocent/minutë apo 1.01 lek/minutë (kursi i kembimit i përdorur 1 Euro=125.37 lek si edhe në raportin e BEREC). Sipas dokumentit më të BEREC për MTR në Korrik 2017, nga 37 vende 24 prej tyre kanë aplikuar modelin Pure LRIC dhe mesatarja e MTR të këtyre vendeve rezulton 1.11 lek/minutë.


87. Siç mund të vihet re edhe nga tabela, 7 vende (përfshirë Shqipërinë) rregullojnë tarifën e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifa benchmark nga vendet që kanë aplikuar modelin ‘Pure-BU-LRIC’. Tarifën e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatës në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BU-LRIC në vendet e tjera Evropiane/BE.

88. Në Shqipëri, AKEP ka përcaktuar vlerën 1.48 lek/minutë në vitin 2014 duke përdorur tarifën mesatare prej 1.0550 eurocent të 13 vendeve që kishin aplikuar modelin Pure BULRIC deri në fund të vitit 2013. Rregullimi më i fundit i bazuar në metoden ‘benchmark pure BULRIC’ është kryer në Islande, e cila ka përlogaritur vlerën benchmark prej 0.8813 eurocent/min në Gusht

2016 dhe kjo vlerë do aplikohet duke filluar nga Janari 2017. Vlera benchmark e përlogaritur nga Islanda është shumë afërt me mesataren e llogaritur nga AKEP në tabelën e mësipërme në eurocent, ndërsa është e njëjtë me vlerën e shprehur në Lek me dy shifra pas presjes dhjetore (1.22 lek sipas Kursit të Këmbimit në Korrik 2016).

89. Tarifat e terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri kanë ardhur duke u reduktuar në mënyrë të përshkallëzuar si rezultat i ndërhyrjes së AKEP, nga viti në vit, duke konvergjuar drejt një simetrie të plotë mes tre operatorëve. Në figurën e mëposhtme paraqitet grafikisht ecuria e tarifave të terminimit për operatorët celularë dhe mesatarja e tyre, nga viti 2010 e në vazhdim:

Figura 4: Ecuria e tarifave të MTR për Shqipërinë 2010 -2018



Burimi: AKEP

90. Nga grafiku vërehet që tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale ka ardhur në ulje, duke pasur fillimisht një asimetri midis dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj në këtë treg) kundrejt operatorëve ekzistues Vodafone Albania dhe Telekom Albania (AMC), për të shkuar në simetri të plotë pas daljes së Plus nga tregu dhe vendimmarrjes së AKEP në Tetor 2018.

2.5 Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

91. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare benchmark të diskutuara se seksionet e meparshme. Kursi i këmbimit i përdorur për periudha të ndryshme i referohet kursit të këmbimit të publikuar nga BEREC në dokumentin përkatës.

Tabela 2: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (benchmark korrik 2016-janar 2019)

	Korrik 2016		Korrik 2018		Janar 2019	
	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK
Average BEREC (Pure LRIC)	0.8838	1.22	0.7907	1.01	0.7547	0.94 ¹²

¹² Kursi këmbimit 1 eur=124.48 ALL

Average EU28(S)	1.0435	1.44	0.8342	1.06	0.7794	0.97
Average EU28 (Ë)	1.0836	1.5	0.8541	1.09	0.7837	0.98
Average BEREC 37(S)	1.1358	1.57	0.9402	1.2	0.8847	1.10
Average BEREC 37(Ë)	1.2743	1.76	0.8467	1.08	0.7956	0.99
Albania (AVG 3 MNO)	1.0699	1.48	1.16215	1.48	0.9801	1.22
Ndryshimi BEREC (Pure LRIC)/Albania	-17%	-17%	32%	32%		

Burimi: Dokumentat e BEREC dhe llogaritje të AKEP.

Nga përditësimi i tarifave benchmark të MTR në Korrik 2018 rezulton se:

92. Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 Korrik 2018 ishte 1.06 lek/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.09 lek/minutë. Këto vlera ishin 26-28% më të ulëta se niveli i MTR në Shqipëri deri në nëntor 2018 prej 1.48 lek/minute;
93. Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 Korrik 2018 ishte 1.20 lek/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.08 lek/minutë. Këto vlera janë respektivisht 19% dhe 40% më të ulëta se niveli prej 1.48 lek/minutë në Shqipëri deri në nëntor 2018;
94. Nga raporti i BEREC për Korrik 2018 nga 37 vende të BEREC, 23 vende kanë aplikuar modelin BU-LRIC të pastër, dhe 7 vende (përfshirë Shqipërinë) kanë aplikuar benchmark mbi tarifën e aplikuar në vendet me këtë model kostoje;
95. Tarifa mesatare e terminimit e 23 vendeve që kanë aplikuar modelin BU LRIC të pastër deri në Korrik 2018 ishte 0.7907 eurocent/minutë, apo 1.01 lek/minute krahasuar me 1.11 lek/minutë që ishte deri në fund të vitit 2017;
96. Tarifat mesatare në vendet e BE dhe BEREC në Korrik 2018 janë reduktuar me 5-20% në krahasim me Korrik 2017 (krahasimi në vlerat në eurocent) dhe këto tarifa mesatare (të shprehura në lek) në Korrik 2018 janë 31-40% më të ulëta se tarifa 1.48 lek/minutë që ishte deri në nëntor 2018 edhe për shkak të nënçmimit të euros ndaj monedhës vendase.

Tarifat e MTR kombëtare të miratuar nga AKEP në Tetor 2018

97. Duke përafëruar tarifën e terminimit celular me BE/BEREC në Tetor të vitit 2018, AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-te me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR u përcaktua në nivelin e 1.22 lek/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lek/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e koston Pure LRIC

2.6 Asimetria/Simetria e MTR në vendet BE/BEREC

98. Rekomandimi i vitit 2009 të KE për tarifën e terminimit rekomandoi përdorimin e metodës Pure BULRIC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare dhe fikse, përfshirë aplikimin e tarifave simetrike. Seksioni i mëparshëm evidentoi se përdorimi i modelit Pure BULRIC dhe

benchmarkut sipas këtij modeli është rritur ndjeshëm, dhe tashme ato përdoren në 30 vende nga 37 vende të BEREC. Raportet e BEREC 2016-2017-2018 paraqesin gjithashtu informacion për nivelin e MTR-ve për secilin operator rrjeti celular dhe MVNO në vendet përkatëse, ku mund të evidentohet aplikimi ose jo i asimetrisë dhe niveli i saj. Nga ky informacion rezulton se nga 37 vende të BEREC në vitin 2018 vetëm në 2 vende (Zvicër dhe Turqi) aplikohet ende asimetri në tarifatat e terminimit në rrjetet celulare, pasi deri në Korrik 2017 edhe Qipro¹³ ka aplikuar asimetri, por në vijim ka aplikuar simetri. Tabela e mëposhtme paraqet informacionin e publikuar nga BEREC si dhe nivelin e asimetrisë së perlllogaritur nga AKEP për këto dy vende.

Tabela 3: Vendet me tarifa terminimi asimetrike Janar 2019

Shteti	Operatorët	Average effective prices (€cent)	Pajtimtarët	Numri total i pajtimtarëve	Market Share %	Niveli i Asimetrisë	
						Ne perqindje	Ne eurocent
CH	Säisscom	2.4637	5.000.000	8.798.646 *	56,83%	N/A	N/A
	Sunrise	3.0796	2.034.000		23,12%	25%	0.62
	Salt	3.0796	1.764.646		20,06%	25%	0.62
TR	Turkcell	0.3969	31.742.904	75.134.272*	42,25%	N/A	N/A
	Vodafone	0.4096	23.163.987		30,83%	3%	0.015
	Avea	0.4700	20.227.383		26,92%	18%	0.088

Burimi: BEREC dhe llogaritje të AKEP (*pjesët e tregut nga raporti BoR (19) 91).

99. Nga tabela vihet re se niveli i asimetrisë në këto dy vende varion nga 3% në Turqi në 25% në Zvicër, ndërsa niveli absolut i diferencës në tarifa varion nga 0.015 eurocent në Turqi në 0.62 eurocent në Zvicër.

100. Në Zvicër (CH) aplikohet asimetri prej 25% midis dy operatoreve më të vegjel dhe operatorit lider me rreth 57% pjesë tregu në pajtimtarë. Megjithatë, në Zvicër tarifatat MTR nuk janë objekt rregullimi ex-ante, ato rregullohen vetëm ex-post në rast të mos-marrveshjeve midis operatorëve. Niveli i tarifave MTR të Zvicres është disa herë më i lartë se në vendet e tjera europiane.

101. Në Turqi, aplikohet asimetri midis dy operatorëve më të vegjel dhe operatorit lider në nivel 3% dhe 18%. Kjo asimetri ka vite që aplikohet bazuar në vendimet e rregullatorit në vitin 2013¹⁴. Niveli i asimetrisë në vlerë absolute është shumë i ulët, 0.015 dhe 0.088 eurocent, për


¹³ Rregullatori i Qipros OCECPR's me Vendimin M2/2014 datë 25 Shtator, 2015 vendosi të aplikojë asimetri në favor të Primatel deri në Janar 2018, operator i cili ka filluar të ofrojë shërbimet mobile në vitin 2014. Tarifatat e MTR për operatorët e tjerë MTN dhe CYTA kanë qenë simetrike që nga 1 Janari 2013.

¹⁴ The MTR values effective from the date 01.07.2013 are close to the values calculated in cost model for the mobile operator of highest market share. For the other two mobile operators a constant asymmetric regulation ratio is

shkak se niveli i tarifave të terminimit të tre operatorëve është dukshëm më i ulët se niveli mesatar në vendet që aplikojnë Pure BULRIC.

102. Për sa i përket historikut më të gjatë të asimetrisë në vende të tjera, figura e mëposhtëme paraqet asimetrinë e aplikuar në MTR në vendet evropiane më 1 Janar në periudhën 2009-2018, nga ku mund të vihet re se përqindja e asimetrisë e aplikuar në 8 vende ka qenë edhe më e lartë se 50% (rekomandimi i ERG) madje në katër vende edhe 100% deri afërsisht 300%.

Figura 5: Asimetria e MTR në vendet evropiane 2009 - 2018



Burimi: Cullen International (2018)

103. Të dhënat e mësipërme tregojnë për një variacion të madh të asimetrisë së aplikuar në 2009-2018 dhe diskutimi për asimetrinë e MTR dhe lidhjen me pjesët e tregut apo faktorë të tjerë që ndikojnë në racionalitetin e vendosjes së asimetrisë/simetrisë së MTR rezulton se është specifik për cdo vend dhe varet nga një sërë faktorësh të cituar edhe nga ERG (sot BEREC) në dokumentin *ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates*, ERG (07) 83 final 080312.

104. Në rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2009 thuhet, **që pas vitit 2012, Autoritetet Rregullatore Kombëtare duhet të vendosin tarifa simetrike për terminimin e**

applied with respect to the operator having highest market share. Moreover, ICTA does not regulate MTRs via glidepath, in general MTRs are revised when it is needed.

thirrjeve për ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse dhe ato mobile, duke u bazuar në modelet e kostove të një operatori eficient. Kosto këto të cilat duhet të llogariten duke përdorur metodën *bottom-up* 'PURE' LRIC.

3. Panoramë e përgjithshme e tregut të shërbimeve celulare

3.1 Ofruesit e shërbimeve celulare në Shqipëri

105. Bazuar në Ligjin 9918 "Për komunikimet elektronike në RSH", sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbimeve celulare janë të regjistruar së pari në Regjistrin e Autorizimeve të Përgjithshme për këto shërbime, dhe në rast të nevojës së përdorimit burimeve të fundme të rralla si frekuenca dhe numeracion për të ofruar këto shërbime, pajisen me autorizim individual për këto burime të fundme, sipas procedurave ligjore dhe nën-ligjore.

106. Në sektorin e rrjeteve dhe shërbimeve celulare aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre si sipërmarrës ofrues të shërbimeve/rrjeteve celulare:

- Telekom Albania sh.a (më parë Albanian Mobile Communications sh.a);
- Vodafone Albania sh.a;
- Albtelecom sh.a;

Telekom Albania

107. Operatori Albanian Mobile Communications (AMC) është licencuar si operator publik kombëtar i telefonisë celulare në vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shtetërore deri në Shtator të vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85 për qind të aksioneve¹⁵, pjesë e cila u ble nga Cosmote Group¹⁶, operatori celular në Greqi, e cila është vetë pjesë e grupit OTE, operatorit incumbent në Greqi. Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës zotëroi rreth 12.6% të aksioneve të Telekom Albania Sh.a, deri në vitin 2008, kur u krye dhe shitja e kësaj pjese Cosmote Group. Afersisht 2.4% të aksioneve zotëroheshin nga aksionerë të vegjël (punonjës të AMC në kohën e privatizimit) të cilat më pas janë blerë nga Cosmote Group. Deutsche Telekom është aksionari më i madh i OTE. Në Korrik 2015, Albanian Mobile Communications ndryshoi emrin në Telekom Albania.

108. *Me shkresën nr. prot 508/2 të datës 13.2.2019 Telekom Albania ka njoftuar AKEP mbi transferimin e kontrollit të 99.757 % të aksioneve të zotëruara nga Cosmote Mobile Telecommunications S.A te shoqëria Albania Telecom Invest AD.*

Vodafone Albania

¹⁵ Kontrata e shitjes së aksioneve të Telekom Albania, është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 8660, date 18.09.2000.

¹⁶ Me shkresën nr. prot 508/2 të datës 13.2.2019 Telekom Albania ka njoftuar AKEP mbi transferimin e kontrollit të 99.757 % të aksioneve të zotëruara nga Cosmote Mobile Telecommunications S.A te shoqëria Albania Telecom Invest AD.

109. Operatori Vodafone Albania është licencuar si operatori i dytë kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri më 9 Qershor 2001. Aksioneret e Vodafone Albania janë Vodafone Europe B.V¹⁷. dhe Vodafone Panafon International Holding B.V, te cilët zotërojnë secili 50 përqind te aksioneve. Në 3 Gusht 2001 Vodafone Albania filloi ofrimin e shërbimeve të saj GSM në Shqipëri.

Albtelecom

110. Operatori Albtelecom është licencuar si operatori i tretë kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri me 1 Mars 2004. Licensa i është dhënë Albtelecom si pjesë e paketës së privatizimit të kësaj kompanie, proces i cili përfundoi në vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e shërbimeve celulare në Mars 2008 nën emrin Eagle Mobile sh.a ka funksionuar si kompani me vete me 100% pronësi të Albtelecom sh.a deri me 31.01.2013, duke u përthithur më pas nga Albtelecom sh.a.¹⁸ Pas bashkimit të dy kompanive shërbimet celulare ofrohen nga Albtelecom sh.a. Albtelecom sh.a ka si aksioner kryesor Cetel¹⁹ Telekom Iletisim Sanayi Ve Ticaret me 76% të aksioneve.

111. *Struktura e tregut ishte me 4 sipërmarrës deri më datë 31 dhjetor 2017.* Operatori Plus Communication (më parë Mobile 4 Al) ishte operatori i katërt celular, të cilit i'u akordua autorizimi individual nga AKEP me date 26.06.2009. Autorizimi individual iu dha konsorciumit të përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) në bazë të Ligjit nr.10118, date 23.04.2009 “Për dhënien e së drejtës së përdorimit, për 15 vjet, në brezin e frekuencave E-GSM dhe GSM 1800, bashkimit të ofertuesve, përfaqësuar nga Postë Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a., sipas procedurës “Tender i hapur ndërkombëtar”, i datës 20.02.2009”. Plus Communication filloi ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në fund të muajit Nëntor 2010.

112. *Nga data 1 janar 2018 sipërmarrësi **Plus Communication** nuk ka ofruar shërbime të telefonisë celulare dhe brezi i frekuencave të tij i është shpërndarë dy sipërmarrësve Vodafone dhe Telekom Albania sipas marrëveshjeve mes tyre dhe miratimeve të Autoritetit të Konkurrencës dhe AKEP.*

113. Me shkresën nr. 38 Prot, datë 11.1.2018, drejtuar AKEP (nr. 99 Prot i AKEP, datë 12.1.2018) dhe në vijim të procedurave në zbatim të vendimeve të KD nr. 21 dhe 22 të datës 01.12.2017, Plus Communication sh.a. ka kërkuar mbylljen e ofrimit të shërbimeve dhe rrjeteve dhe ç’regjistrimin nga regjistri i sipërmarrësve të rrjeteve /shërbimeve të komunikimeve elektronike.

¹⁷ Sipas informacionit të marrë në qkr.gov.al në datën 26/02/2019

¹⁸ Përthithja e Eagle Mobile sh.a nga Albtelecom sh.a. sipas legjislacionit në fuqi është miratuar paraprakisht nga Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP me VKD nr. .2270, datë 13.02.2013, ka miratuar kalimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të caktuara me pare Eagle Mobile sh.a. tek sipërmarrësi Albtelecom sh.a.

¹⁹ Sipas informacionit të marrë në www.qkr.gov.al në datën 26/02/2019

3.2 Analiza e zhvillimeve të shërbimeve celulare

114. Tabela e mëposhtme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2013-2017 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

Tabela 4: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2014-2018²⁰

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
– Sipas kartave SIM	4,928,784	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	-25.45%
– Përdorues aktivë	3,406,772	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	-25.12%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
– Totali	1,576,877	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	-20.57%
– Përdorues aktivë	907,975	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	-10.88%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,301,024,035	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	-9.07%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	596,861,301	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	-12.74%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	464,550,758	420,253,147	300,227,063	168,753,020	165,037,402	-2.20%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,826,346,190	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	-13.40%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	6,269,940	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	30.83%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët, përpunimi AKEP

115. Nga të dhënat e tabelës vihet re se në ndryshim nga viti 2017, treguesit e paraqitur në tabelën sa më sipër kanë shënuar rënie të theksuar, përjashtim bën vetëm treguesi i volumit të të dhënave (Data GB) i cili gjatë vitit 2018 është rritur me rreth 31 % krahasur me vitin 2018. Numri i përdoruesve aktivë të broadbandit për gjatë vitit 2018 ka shënuar rënie, por ky numër është më i lartë se ai i viteve 2016, apo 2015, në kontrast me rënien e numrit të përdoruesve aktiv të shërbimeve broadband, sic u theksua edhe sa më sipër, treguesi i volumit të të dhënave ka shënuar rritje me rreth 31%. Rënien më të madhe e kanë shënuar treguesit e përdorimit të kartave SIM dhe përdoruesit aktivë mobile, me më shumë se 25% respektivisht. Rënien e numrit të pajtimtarëve për këto dy tregues e kanë Vodafone Albania dhe Telekom Albania, përkatësisht me rreth 26% dhe 19% për përdoruesit aktivë dhe 24% dhe 20% për pajtimtarët me kartë SIM.

116. Fenomen që vërehet edhe nga vitet e kaluara është rritja e vazhdueshme e përdorimit të të dhënave Data, rritje e cila ka ndikuar në uljen e numrit të SMS dhe minutave të komunikimit Voice, si rezultat i përdorimit në masë të aplikacioneve (Ëhatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj). Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe për shkak të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga rrjetet 4G dhe 4G+ të cilët mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Struktura e përdoruesve të shërbimeve mobile

117. AKEP në publikimet e viteve të fundit ka raportuar numrin e përdoruesve celularë sipas dy mënyrave.


²⁰ Saktësuar pas shkresës së ardhura nga sipërmarrësi Vodafone Albania referencë LEA/016/EK të datës 22.02.2018

- Numri i përdoruesve sipas kartave ‘SIM’, i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive²¹ në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit;
- Numri i përdoruesve aktivë, i referohet përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit;

118. Në referenca të tjera në këtë dokument, AKEP i referohet kryesisht numrit të përdoruesve celularë sipas “përdoruesve aktive”, por ndërkohë në disa raste jepen edhe tregues bazuar në numrin e përdoruesve celularë sipas kartave ‘SIM’.

119. Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM (përfshirë kartat e dedikuara për të dhëna) në fund të vitit 2018 ishte rreth 4.1 milion që përbën rritje me rreth 25% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017. Ndërkohë numri i përdoruesve aktivë (përdorim në 3 muajt e fundit të vitit) të telefonisë celulare në vitin 2018 arriti në rreth 2.7 milionë që përbën një rritje me rreth 25% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Figura 6: Numri i përdoruesve celularë aktivë ,karta SIM dhe broadband 2014-2018



Burimi: Përlllogaritje të stafit të AKEP bazuar në të dhënat periodike të raportuara nga operatorët

120. Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve dhe tremujorëve të vitit 2017-2018 të paraqitura në figurën e mësipërme vërehet ndër të tjera se ndërsa numri i përdoruesve të shërbimeve celulare ka shënuar rritje deri në tremujorin e katërt të vitit 2017, duke u ndjekur nga një rënie e theksuar gjatë gjithë tremujorëve të vitit 2018, të njëjtin trend rënës ka ndjekur edhe numri i përdoruesve aktivë të këtyre shërbimeve rënie e cila arrin deri në 25% në vitin 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

121. Nga të dhënat e mësipërme, vërehet se treguesit për përdoruesit aktivë të shërbimeve celulare broadband kanë qenë në trend rritës për periudhën 2014 deri në tremujorin e tretë të vitit 2017, për tu ndjekur nga një rënie e lehtë gjatë tremujorit të fundit të këtij viti, ndryshimi

²¹Secili operator ka politikën e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejë komunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

i këtyre treguesve në terma vjetorë për periudhën 2017 – 2018 ka qenë rreth 11% rënie për përdoruesit aktivë me akses broadband celular dhe rreth 11% rënie për përdoruesit aktivë me akses broadband celular dhe telefoni celular.

122. Lidhur me rënien e pjesëve të tregut për këto dy tregues u është kërkuar informacion sqarues sipërmarrësve që kanë pasur rënie, mbi bazën e të cilës sipërmarrësit kanë sqaruar se kjo rënie ka ardhur si rezultat i disa faktorëve:

- i. ndryshimit të politikës së zbatuar nga sipërmarrësit në lidhje me jetëgjatësinë e kartave SIM për numrat me parapagesë duke shkurtuar periudhën gjatë të cilës një numër mund të qëndrojë aktiv në rrjet pa kryer rimbushje;
- ii. ndryshimi i politikave të kompanive për sa i përket fushatave promovionale për ofrimin e numrave falas, duke dekurajuar përdoruesit që të përdorin karta SIM për një kohë të shkurtër;
- iii. reduktimi i numrit të kartave nga ana e përdoruesve që mbanin dy ose më shumë SIM.

123. Ndryshimet e mësipërme kanë bërë që treguesit statistikorë të raportuar të paraqesin më me vërtetësi volumin e numrave që realisht përdorin rrjetin për komunikimet elektronike mobile. Proporcioni i përdoruesve aktivë ndaj kartave SIM aktive në 2018 ishte rreth 66% në krahasim me 64% në vitin 2017. Ky proporcion varjon nga 69% për Albtelecom, 61% për Vodafone Albania dhe 70% për Telekom Albania. Në fund të vitit 2018 numri përdoruesve me parapagim përbënte 90% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë, duke pësuar rënie me rreth 1% nga viti 2017.

Tabela 5: *Struktura e përdoruesve celularë kontratë/parapagim (2017-2018)*

		Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	Total
	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim
Perdorues Aktivë	2017	10%/90%	5%/95%	15%/85%	6%/94%	9%/91%
	2018	12%/88%	7%/93%	18%/82%	N/A	10%/90%

Burimi: Përlllogaritje të stafit të AKEP bazuar në të dhënat periodike të raportuara nga operatorët

124. Ndryshimi i strukturës së përdoruesve celularë vlerësohet të ketë ardhur nga politikat tarifore të operatorëve celularë, si edhe uljes së konsiderueshme që ka pësuar numri i përdoruesve aktiv me parapagim (paragrafi më sipër). Prezenca e ofertave tarifore shumë atraktive për përdoruesit me parapagim si dhe eliminimi i grupeve të mbyllura për përdoruesit me kontratë kanë ndikuar në reduktimin e peshës së përdoruesve me parapagim/kontratë.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

125. Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2010 deri në 2018, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë broadband për 2014-2018.

Tabela 6: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2010-2018

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	Ndryshimi 2018/2017
Thirrje dalëse	152	156	172	182	166	155	158	2%
Thirrje të marra	168	167	168	171	169	156	161	3%
MOU	319	324	341	353	335	311	319	3%
SMS Dalese	35	39	43	39	39	33	31	-6%
Trafik Data (GB)	N/A	0.22	0.48	0.96	1.49	2.06	2.6	26%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP. Përpunimi AKEP


126. Gjatë vitit 2018, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 158 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 31 mesazhe SMS në muaj dhe ka konsumuar rreth 2.6 GB në Internet broadband. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM. Treguesit e përdorimit mestar të thirrjeve janë me tendencë rritjeje shumë të vogla përgjatë vitit 2018 me 2-3% për thirrjet dhe rreth 26% për trafikun e të dhënave, ndërsa SMS kanë një tendencë rënie me 6%.

Të ardhurat totale nga komunikimet elektronike mobile

127. Të ardhurat totale të shërbimeve mobile për vitin 2018 ishin rreth 26 miliardë e 848 milionë lekë, që përbën një rënie me rreth 10% nga viti 2017 vit në të cilin të ardhurat ishin rreth 29 miliardë e 740 milionë lekë, duhet theksuar se të ardhurat e të tre sipërmarrësve aktualë janë pothuajse në të njëjtin nivel sa ato të vitit 2017 për këta sipërmarrës, rënia e të ardhurave të vitit 2018 është përafërsisht sa të ardhurat e Plus Communication për vitin 2017 (sipërmarrës i larguar nga tregu me 31 Dhjetor 2017). Të ardhurat totale nga komunikimet elektronike mobile për vitet 2015 – 2016 janë përkatësisht rreth 33,070 milionë lekë dhe rreth 33,867 milionë. Siç vërhet, të ardhurat kanë shënuar rritje të lehtë gjatë vitit 2016, duke u shoqëruar me një rënie me rreth 12% gjatë vitit 2017. Ndër faktorët kryesorë që ka ndikuar në rënien e të ardhurave gjatë vitit 2017 - 2018 është rënia e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare.

Në vijim paraqiten pjesët e tregut të operatoreve celulare për treguesit kryesorë në periudhën 2011-2018.

Figura 7: Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale nga komunikimet elektronike mobile




Burimi: Të dhëna të depozituara nga operatorët. Perpunimi AKEP

Të ardhurat sipas shërbimeve me shumicë dhe pakicë

128. Të ardhurat totale nga shërbimet me pakicë në rrjetet celulare në vitin 2017 arritën në 17.2 miliard lek që përbën një rritje të vogël me 0.4%. Telekom Albania, Altelecom dhe Plus Communication, kanë shënuar rritje me 11%, 9% dhe 16% respektivisht, ndërsa Vodafone Albania ka shënuar rënie të të ardhurave me pakicë me 8%.

129. Rënia më e madhe e të ardhurave të operatorëve celularë ka ndodhur në të ardhurat e shërbimeve me shumicë, ku të katër operatorët kanë shënuar rënie të ndjeshme. T'kurrja e ndjeshme e të ardhurave me shumicë ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së madhe të trafikut hyrës ndërkombëtar (rreth 44%) dhe rrjedhimisht të të ardhurave nga terminimi i këtyre thirrjeve (rreth 3.4 miliard lek), duke ndikuar negativisht edhe në nivelet dhe normat e fitimit të operatorëve celularë, për shkak të peshës së lartë të këtyre të ardhurave në të ardhurat totale dhe fitimet e kompanive celulare.

Figura 8: Të ardhurat nga Shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjeteve celulare 2010-2018




Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP. Përpunimi DTMRR.

Siç vërehet në grafikun sa më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë kanë pësuar rënie të theksuar gjatë viteve 2017 dhe 2018, duke arritur nivelin më të ulët që nga viti 2011, ndërkohë gjatë vitit 2018, në krahasim me vitet 2015-2017, ka pasur një ritje të lehtë të të ardhurave nga shërbimet e ofruara me pakicë.

Investimet

130. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2010-2017.

Figura 9: Ecuria e Investimeve të sipërmarrësve në rrjete celulare (2010-2018)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP. Përpunimi DTMRR.

131. Gjatë vitit 2018 vërehet një rritje e investimeve në krahasim me vitin 2017, rritje e cila është ndikuar nga rritja e investimeve të Telekom Albania (rreth 800 milionë lekë) dhe Vodafone (rreth 320 milionë lekë), ndërkohë që Albtelcom i ka pasur investimet në të njëtin nivel si viti 2017 rreth 80 milionë Lek në total për secilin vit. Ecuria e investimeve në rrjete celulare tregon se në dy 2016-2017 ka pasur një rënie të ndjeshme të investimeve, e ndikuar edhe nga dizinvestimet e Plus (shitja e aseteve). Duke hequr efektin e Plus rezultojnë se investimet e tre operatorëve në infrastrukturë rrjeti celular u reduktuan me rreth 2.6 miliard lek në 2016 dhe u rritën me 892 milion lek në 2017.

Fitimet neto të operatorëve mobile

Figura 10: Fitimet neto të operatorëve mobile 2011 - 2018

Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP. Përpunimi DTMRR.

132. Nga të dhënat e depozituara nga operatorët për vitin 2018, vërhet se vetëm Vodafone Albania ka shënuar fitim neto pozitiv në rreth 700 milionë lek, nga rreth 1 miliardë humbje që kishte gjatë vitit 2017, ndërkohë të dy operatorët e tjerë edhe gjatë vitit 2018 kanë rezultuar me humbje, ku humbjen më të madhe e shënon Telekom Albania rreth 3,69 milionë lekë, nga 5,401 milionë lekë që ishte gjatë vitit 2017, ndërsa Altelecom e ka reduktuar humbjen në rreth 330 milionë lekë gjatë vitit 2018 nga rreth 1,139 milionë lekë në vitin 2017. Fitimet në norma të ulëta dhe negative, ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë.

Treguesit e ARPU dhe ARPM

133. Treguesit e ARPU (Average Revenue Per User / E ardhura Mesatare Për Përdorues) dhe ARPM (Average revenue Per Minute / e Ardhura Mesatare Për Minutë) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këtë arsye përdoren edhe si tregues agregate të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përfshira në pagesat fikse, për përdorues me parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.

134. ARPM matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i çmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti dhe tregon sa lekë shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj.

Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2018 janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2018

Vitet	ARPM (Leke/Minutë)	ARPU (Leke/përdorues)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi vjetor (%)
2010	6.49	8,594	N/A	N/A
2011	5.35	8,319	-18%	-3%
2012	3.92	7,132	-27%	-14%
2013	3.13	5,863	-20%	-18%
2014	2.63	5,447	-16%	-7%
2015	2.36	5,125	-10%	-6%
2016	2.53	4,750	7%	-8%
2017	2.60	5,091	3%	7%
2018	2.89	6,482	11%	27%

Shënim: Vlerat janë pa TVSH

135. Nga tabela e mësipërme vërehet se vlera e ARPU ka tendencë ulje nga viti 2010 deri në vitin 2016. Trendi ka ndryshuar dy vitet e fundit kur ka filuar rritjen në 2017(7 %) dhe e ka përfocuar më shumë në vitin 2018(ritja 27%) një përdorues celular ka paguar mesatarisht rreth 3.47 lekë/minutë (me TVSH) dhe në bazë vjetore një përdorues aktiv ka paguar rreth 7,778 lekë (me TVSH). Gjithësesi për shkak të rënies së numrit të përdoruesve aktive si pasojë e rishikimit të procedurave përkatëse nga operatorët AKEP e konsideron me rezervë këtë tregues.

136. Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulët në rajon. ARPU në vitin 2017 në Shqipëri ishte 38²² euro/vit, që është 23% më e ulët se Rumania me nivelin më të ulët në BE²³ me 46.8 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2016 ishte rreth 163 euro apo rreth 4.4herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2016, gjithashtu rreth 4.7 herë më e madhe edhe se ARPU e Shqipërisë në vitin 2016. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin rreth 1.84 eurocent në 2016 dhe rreth 1.94 eurocent në 2017.

Pjesët e tregut

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2011 – 2018²⁴ së bashku me indeksin HHI²⁵ të përqendrimit janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2011-2018

		Telekom Albania	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2011	37%	35%	21%	8%	3,052
	2012	33%	36%	25%	5%	3,085
	2013	39%	43%	13%	6%	3,525
	2014	40%	40%	14%	7%	3,399
	2015	34%	42%	16%	8%	3,222
	2016	32%	49%	14%	4%	3,691
	2017	32%	49%	14%	5%	3,676
	2018	34%	50%	15%	-	3,954
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2011	34%	48%	13%	6%	3,620
	2012	40%	42%	12%	6%	3,549
	2013	38%	45%	12%	6%	3,600
	2014	34%	46%	13%	8%	3,460
	2015	33%	47%	14%	6%	3,499

²² Me kurs të mesatarizuar për vitin 2017 (1 Euro = 134 Lekë).

²³ Average Revenue per User (ARPU) in the Retail Mobile Market 2015 (Digital-Agenda-Data.EU)

²⁴ Në lidhje me pjesët e tregut, mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

²⁵ HHI (Herfindahl–Hirschman Index), i matur si shuma e katroreve të pjesëve të tregut të gjithë lojtareve të tregut. Tregjet me tregues përqendrimi nën vlerën 1,500 i konsiderohen si tregje konkurrues, tregjet me tregues përqendrimi HHI midis 1,500 – 2,500 konsiderohen si tregje me përqendrim të moderuar, ndërsa tregjet me tregues 2,500 ose më shumë vlerësohen si tregje me përqendrim të lartë (konkurrueshmëri e ulët).

	2016	31%	51%	13%	5%	3,724
	2017	34%	48%	13%	6%	3,620
	2018	37%	47%	16%	-	3,842
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)						
	2011	19%	81%	N/A	N/A	6,871
	2012	37%	63%	N/A	N/A	5,335
	2013	25%	52%	23%	N/A	3,831
	2014	25%	61%	15%	N/A	4,501
	2015	29%	55%	17%	N/A	4,082
	2016	27%	55%	14%	4%	3,944
	2017	30%	51%	14%	5%	3,708
	2018	37%	47%	16%	-	3,842
Thirrje dalëse						
	2011	37%	51%	10%	2%	4,074
	2012	39%	50%	8%	3%	4,094
	2013	39%	51%	7%	3%	4,180
	2014	34%	50%	11%	5%	3,797
	2015	32%	49%	13%	6%	3,642
	2016	34%	52%	11%	4%	3,940
	2017	34%	48%	11%	7%	3,646
	2018	35%	52%	13%	-	4,093
SMS dalëse						
	2011	27%	64%	8%	1%	4,890
	2012	20%	73%	6%	1%	5,766
	2013	21%	73%	5%	1%	5,796
	2014	19%	66%	5%	10%	4,898
	2015	18%	66%	8%	8%	4,787
	2016	21%	67%	9%	3%	4,988
	2017	25%	60%	10%	5%	4,325
	2018	27%	61%	12%	-	4,602
Trafiku të dhëna (Gbyte)						
	2011	23%	43%	26%	8%	3,099
	2012	27%	54%	14%	5%	3,857
	2013	21%	57%	17%	4%	4,063
	2014	16%	49%	30%	4%	3,632
	2015	18%	51%	29%	3%	3,727
	2016	21%	55%	22%	2%	3,937
	2017	24%	55%	18%	2%	3,970
	2018	26%	55%	19%	-	4,086
Të ardhura totale nga komunikimet						
	2011	34%	52%	12%	2%	3,987
	2012	29%	56%	10%	4%	4,120
	2013	33%	50%	11%	6%	3,744
	2014	34%	48%	12%	6%	3,665
	2015	34%	47%	12%	7%	3,582

	2016	31%	49%	12%	9%	3,522
	2017	30%	49%	12%	8%	3,549
	2018	32%	54%	14%	-	4,136
Të ardhura retail	2011	36%	49%	13%	2%	3,882
	2012	33%	50%	12%	5%	3,751
	2013	32%	52%	11%	6%	3,815
	2014	30%	53%	11%	5%	3,926
	2015	28%	54%	12%	5%	3,894
	2016	28%	56%	12%	5%	4,052
	2017	31%	51%	13%	5%	3,746
	2018	32%	54%	14%	-	4,136

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP. Përpunimi AKEP

137. Indeksi i HHI është në nivele mbi 3,200 për të gjithë treguesit e marrë në analizë, gjë e cila sipas përcaktimeve të këtij treguesi, tregon se ndodhemi në një treg me përqendrim shumë të lartë. Mbi bazën e indeksit HHI për treguesit e marrë në analizë, gjatë vitit 2016 ka pasur rritje të përqendrimit të tregut pasi është rritur indeksi i përqendrimit për pjesën më të madhe të treguesve të marrë në analizë, me përjashtim të përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare, përdoruesve aktivë broadband dhe treguesit të të ardhurave totale, të cilët gjithashtu janë mbi normat 3,500 pikë.

138. Indeksi i HHI për treguesit e shërbimeve celulare dhe përdoruesve aktivë të këtyre shërbimeve ka pësuar rënie gjatë vitit 2017 në krahasim me vitin 2016, përkatësisht për përdoruesit e shërbimeve celulare rënia ka qenë 15 pikë, ndërsa për përdoruesit aktivë të këtyre shërbimeve 104 pikë, ndërsa gjatë vitit 2018 indeksi HHI për të dy këta tregues është përkeqësuar duke u rritur përkatësisht me 278 dhe 222 pikë. Gjithashtu edhe treguesit e përdoruesve aktivë broadband dhe thirrjeve dalëse gjatë vitit 2018 kanë pasur rritje përkatësisht 134 dhe 475 pikë. Rritje të indeksit HHI e ka pasur edhe treguesi i SMS-ve dalëse, me 277 pikë, megjithatë indeksi HHI për këtë tregues për vitin 2018 mbetet në nivelet më të larta në krahasim me treguesit e tjerë përkatësisht 4,602 pikë për shkak të pjesës shumë të madhe të tregut të Vodafone për këtë shërbim. Edhe indeksi HHI për trafikun e të dhënave (Gbyte) është rritur me 116 pikë.

139. Në ndryshim nga vitet e mëparshme, gjatë vitit 2018 të gjithë treguesit e marrë në analizë kanë shënuar vlera më të madha të HHI, e thënë ndryshe rritje e përqendrimit të tregut të komunikimeve elektronike mobile. Ndikim në përkeqësimin e këtyre treguesve, ka edhe dalja nga tregu e sipërmarrësit Plus Communication, duke bërë që në këtë treg tashmë të operojnë vetëm tre operatorë, nga katër deri në vitin 2017.

Tarifat për shërbimet e aksesit broadband celular

140. Shërbimi i aksesit broadband në Internet në rrjetet celulare mund të përfitohet nëpërmjet paketave të përbashkëta me shërbimet standarde telefonike ose nëpërmjet paketave të veçanta për të dhëna. Programet tarifore të katër operatorëve celularë tregojnë se shumica e paketave

janë të integruara: telefoni/SMS dhe akses në Internet 3G/4G. Këto paketa janë të shumëllojshme dhe mund të blihen nga përdoruesit me parapagim për konsum ditor, javor apo mujor. Tarifat e këtyre paketave variojnë sipas afatit të vlefshmërisë dhe njësive të komunikimit dhe/ose aksesit në Internet të përfshira në pagesën fikse. Gjatë vitit 2018, Këshilli Drjetues i AKEP me anë të Vendimit Nr. 32, datë 24. 04. 2018 vendosi që kohëzgjatja e vlefshmërisë së paketave tarifore celulare standard bundle me parapagim të ndryshojë dhe nga 28 ditë të jetë mujore (30 ditë).

141. Nga ofertat/paketat tarifore të disponueshme nga operatorët celularë vihet re se përdoruesit me parapagim (që përbëjnë mbi 90% të përdoruesve të shërbimeve celulare në Shqipëri) gjatë vitit 2018 kanë pasur mundësinë e zgjedhjes për të përfituar aksesin në Internet celular së bashku me shërbime telefonike/apo si shërbime më vete duke filluar nga 60 lekë/ditë dhe 300/400 lekë/muaj, dhe me kapacitete doëload të mjaftueshme për akses broadband funksional në Internet. Pavarësisht vonësive në fillimin e ofrimit të shërbimeve 3G/4G në Shqipëri (për shkak të vonësës në dhënien e të drejtave për brezat e frekuencave të nevojshme për rrjetet 3G/4G të pavarura nga MNO-të në Shqipëri), në vetëm disa vite përdorimi i këtyre shërbimeve ka njohur rritje të ndjeshme në përdorues dhe konsum të dhënash dhe tarifat janë shumë konkurruese dhe të përballueshme.

Pesha e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare

142. Tabelat e mëposhtëme paraqesin peshën e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celularë në vitet 2014-2018, peshën e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në të ardhurat totale nga terminimi dhe peshën e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare në totalin e të ardhurave të operatorëve celularë (retail plus wholesale) në vitet 2014-2017.

Tabela 9: Pesha e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celularë 2014-2018

	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus	Total
2014					
2015					
2016					
2017					
2018					

Tabela 10: Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave nga terminimi 2014-2018

	Telekom	Vodafone	Albtelecom	Plus	Total
--	---------	----------	------------	------	-------

	Albania	Albania			
2014					
2015					
2016					
2017					
2018					

143. Nga tabelat e mësipërme per tre operoret aktualisht aktive ne treg vihet re se pesha e të ardhurave nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare për vitin 2018 në totalin e të ardhurave nga thirrjeve e terminura zë rreth xx% të tregut për Vodafone, rreth xx% për Telekom Albania dhe rreth xx% për Albtelcom. Nga krahasimi me vitet e mëparshme pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare ka pësuar rënie të ndjeshme, ku rënien më të madhe e kanë pasur Telekom Albania dhe Albtelcom.

144. Në tabelat e mëposhtëme AKEP ka pasqyruar të ardhurat mesatare për 1 minutë nga terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare si dhe të ardhurat mesatare për 1 minutë nga terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dhënat janë në lek/minutë pa TVSH.

Tabela 11: MTR mesatar ndërkombëtar 2014-2018

	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelcom	Plus	Total
2014					
2015					
2016					
2017					
2018					

Tabela 12: Të ardhura mesatare për minute nga terminimi kombëtar dhe ndërkombëtar 2014-2018

	Telekom Albania	Vodafone Albania	Albtelcom	Plus	Total
2014					
2015					

2016					
2017					
2018					

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP.

145. Nga të dhënat e tabelës vihet re se MTR mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) ka ardhur në rënie, e ndikuar kryesisht nga rënia e volumit të minutave të komunikimit për thirrjet ndërkombëtare.

Tarifat standarte për njësi komunikimi (pay as you go)

146. Në analizat e tregut, AKEP ka evidentuar si problematikë diferencën e lartë të tarifave për shërbimet e konsumuara për njësi (lekë/minutë, SMS) me tarifat e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse si pjesë e ofertave. Këto tarifa aplikohen nëse përdoruesi me parapagim nuk blen paketa/oferta ose pasi ka konsumuar njësitë përkatëse të përfshira në çmimin e paketës/ofertës, si dhe për përdoruesit me kontratë pas konsumit të njërive të përfshira në pagesën fikse mujore dhe/ose të paketave/opsioneve shtesë që mund të blejnë kjo kategori përdoruesish. Këto tarifa rezultojnë të jenë shumë herë më të larta se tarifat mesatare që aktualisht paguajnë përdoruesit celularë. Siç është theksuar në seksionin e ARPM, çmimi që një përdorues celular ka paguar mesatarisht për një minutë thirrje telefonike nga rrjete celulare në vitin 2017 ishte 3.12 lekë/minutë me TVSH, ndërsa tarifat standarde të thirrjeve jashtë paketave janë deri 13 herë më të larta se kjo vlerë mesatare (tarifa mesatare standarte që aplikohet varion nga 29 - 39 lekë/minutë). Në mënyrë të ngjashme edhe tarifimi për aksesin broadband jashtë paketave tregon për nivel shumë të lartë të tyre dhe diferenca të mëdha me aksesin broadband në paketa (parapagim/paspagim).
147. Megjithatë duhet theksuar se pesha e madhe e përdoruesve me parapagim (rreth 92%) përdorin shërbime me karta rimbushëse dhe tendencat e përdorimit të paketave me parapagim dhe paspagim që përfshijnë sasi mëse të mjaftueshme thirrjesh dhe SMS, dhe masa të tjera nga vetë operatorët celularë e reduktojnë ndjeshëm mundësinë e aplikimit të këtyre tarifave të larta standarde. P.sh, në vitin 2016 / 2017 vetëm 0.7% / 0.65% e thirrjeve dhe 2.5% / 2.46% e SMS-ve janë tarifuar me tarifat standard, cka tregon jo vetëm për një përqindje shumë të ulët të tarifimit standart por edhe për një tendencë gjithmonë në rënie. Njëkohësisht, operatorët celularë për të shmangur fatura mjaft të larta për aksesin broadband, shpesh aplikojnë politikat tarifore të ashtuquajtura FUP (Fair Usage policy), ku ofrohet internet “pa limit”: Pas konsumit të një sasi të caktuar GB apo MB, përdoruesi vazhdon të ketë internet pa limit, por me shpejtësi të reduktuar deri në 128/256 kbps. Gjithsesi, AKEP është duke e trajtuar këtë çështje edhe në kuadër të Shërbimit Universal.


Ndërhyrjet e AKEP në transparencën dhe rregullim e kohëzgjatjes së ofertave

148. Gjatë vitit 2018, AKEP-i ka ndërhyrë në tregun më pakicë të tarifave të komunikimeve elektronike. Deri në këtë kohë tre sipërmarrësit kryesorë, në mënyrë të dyshuar për koordinim aplikonin periudhën 28 ditore për paketat standarte nga 30 ditë që ishte më parë, duke rënduar kështu padrejtësisht buxhetin e konsumatorëve.
149. AKEP, me Vendimin Nr. 32, datë 24.04.2018, *“Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë”*, detyroi sipërmarrësit mobile që duke filluar nga data 1.06.2018 të rikthejnë në treg paketat standarde me afat përdorimi 30 ditor nga 28 ditë që ishte. Ndërkohë që Vodafone Albania dhe Telekom Albania e kanë kryer këtë ndryshim në datën e përcaktuar në Vendim, Albtelecom ka bërë ndryshimin me datë 10.04.2018, pra përpara datës së vendimmarrjes së AKEP. Rregullimi i kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 28 në 30 ditë, synon mbrojtjen e konsumatorit nga tarifimi në mënyrë të padrejtë duke e copëzuar vitin në rreth 13 periudha faturimi nga rreth 12 që është normalja.
150. Në funksion të mbrojtjes dhe rritjes së përfitimeve të konsumatorëve fundorë, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr. 37, datë 18.5.2018, miratoi disa ndryshime në rregulloren Nr. 27 Datë 21.9.2012, e ndryshuar *“Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*, ndryshime të cilat kanë si synim rritjen e treguesve të informimit të konsumatorëve, në mënyrë që të garantohen interesat e konsumatorëve fundorë.

3.3 Masat rregullatore on-net/off-net

151. Masa mosdiskriminimit on-net vs of net është ndërmarrë në vitin 2014 kushtet e tarifave të larta të terminimit të thirrjeve nga një rrjetë dejt një tjetër rrjetë celular që nxiste efektin club të favorizimit të thirrjeve brenda rrjetit duke avantazhuar operatorët me pjesë të madhe tregu dhe penalizonte për thirjet jashtë rrjetit (operatorët me pjesë më të vogla tregu).
152. Qasja e AKEP drejt uljes së vazhdueshme të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke e përditësuar me të dhënat më të fundit të benchmarkut të tarifave të terminimit të BE/BEREC pritet të sjellë përfitime për konsumatorët dhe të ulë ndjeshëm incentivat për efektin club brenda rrjeteve celulare.

Figura 11: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit (2003-2018)




Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP

153. Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse në vitin 2017 u reduktua në 52%, krahasuar me vitin 2016 ku ky tregues shënonte rreth 60% nga 69% në 2015 (84% në 2014), ndërsa pesha e thirrjeve off-net u rrit me rreth 15% në krahasim me vitin 2016 duke arritur në 37% krahasuar me 18% në 2015 (8% në 2014). Në ndryshim nga trendi rënës i peshës së thirrjeve On-net deri në vitin 2017, gjatë vitit 2018 pesha e thirrjeve on-net ndaj totalit të thirrjeve dalëse arriti nivelin rreth 56%, dhe pesha e thirrjeve off-net u reduktua në rreth 41%. Gjatë viteve 2016 e në vijim ka pasur reduktim të ndjeshëm të thirrjeve ndërkombëtare, gjë e cila ka çuar në reduktim edhe të peshës së këtyre thirrjeve duke arritur në rreth 1% gjatë vitit 2018 nga rreth 11% në vitin 2015.
154. Rënia e madhe e trafikut të thirrjeve dalëse ndërkombëtare në vitin 2016 – 2018 ka ardhur pas rritjeve të ndjeshme të këtyre thirrjeve në vitet 2014-2015. Këto luhatje shpjegohen me ndryshimet ofertat/paketat e operatorëve celularë për thirrjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe për shkak të ndryshimeve në tarifatat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare në vendet e BE-se të cilat përbëjnë pjesë të kostove të thirrjeve dalëse ndërkombëtare për operatorët shqiptarë. Reduktimi i minutave/ofertave për këto thirrje nga operatorët celularë shqiptarë në vitin 2016 ka ardhur për shkak të rritjes së tarifave të terminimit në një sërë vendesh të BE-së për thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë vendeve anëtare të BE. Gjithashtu, një faktor mjaft i rëndësishëm është edhe rritja e përdorimit të të dhënave data (internetit), nëpërmjet të cilit konsumatorët thirrjet me jashtë territorit i kryejnë edhe nëpërmjet aplikacioneve Viber, Skype, Eëhatsapp, Mesanger, etj.
155. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e strukturës së thirrjeve të përdoruesve celularë sipas destinacionit të thirrjeve në baze mujore ne periudhën Janar 2014-Dhjetor 2018. Nga të dhënat vihet re ndryshimet e mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në Janar 2014 në 45% në

Nëntor 2017. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është reduktuar nga 90% në Janar 2014 në 52% në Nëntor 2017. Pas muajit Nëntor 2017, vërehet një tendencë e kundërt, ku pesha e thirrjeve off-net ka pësuar rënie duke arritur në rreth 41% në Janar të vitit 2018, ndërsa pesha e thirrjeve on-net është rritur në rreth 57%.

Figura 12: Struktura e thirrjeve celulare (Janar 2014-Dhjetor 2018)



Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP.

156. Për sa i përket treguesit të strukturës sa më sipër, vlen të theksohet se numri i minutave totale të komunikimit ka pësuar rënie me rreth 18% nga viti 2014 në vitin 2018, ku rënie më të madhe në peshë e kanë pasur thirrjet ndërkombëtare, rënie në të cilën ka ndikuar edhe rritja e përdorimit të shërbimit të internetit mobile dhe zhvillimit të thirrjeve (audio dhe video) dhe dërgimit të mesazheve nëpërmjet aplikacioneve OTT (Ëhatsapp, Viber, Mesanger, Skype, etj).

157. Vendimet në fuqi për masat rregullatore *on net vs off net* përcaktojnë të njëjtat detyrime për të tre sipërmarrësit pasi masa ishte vendosur në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve (në të cilin janë me fuqi të ndjeshme në treg) ndërkohë që analia e plotë u zhvillua në dokumentin e analizës së tregje me shumicë të akses-origjinimit (përfshirë shërbimet me pakicë të operatorëve të rrjeteve celulare).

158. Me vendimin Nr. 9, datë 24.04.2020 – “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi: (i) “Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kriterëve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas


përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008” dhe Rregullorja 9/2009 dhe (ii) të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësisimit të testit të tre kritereve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores.

159. Për këtë arsye AKEP vlerëson se kjo masë e ka dhënë efektin e saj në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe si e tillë të vazhdojë të qëndrojë deri në një analizë tjetër nga ana e AKEP për këtë masë.

4. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare

160. Terminimi është një nga shërbimet e interkoneksionit të analizuar edhe në raundet e mëparshme të analizave të mbajtura në vitet 2006, 2007, 2009-2010, 2014 dhe 2017-2018, dhe si i tillë edhe në këtë analizë mbart me vete aspekte teorike dhe arsyetime të trajtuara edhe më parë në dokumentet e analizave të sipërcituara. Por në këtë dokument analize ky shërbim do të ketë vëmendje të veçantë dhe arsyetim të zgjeruar në aspektet e nevojshme të tij, dhe për raste të përshkrimeve të përgjithshme mund të referohet në dokumentet e mëparshme të analizave që kanë trajtuar këtë shërbim.

Figura 13: Ecuria e tarifave të MTR 2010 -2018



Burimi: AKEP

161. Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular është një shërbim interkoneksioni i përcaktuar edhe në ofertën referencë të operatorëve celularë, si dhe në Marrëveshjet e Interkoneksionit (MI) të lidhura ndërmjet operatorëve celularë, i cili është përkufizuar si më poshtë:

‘Shërbimi nëpërmjet të cilit operatori celular (ofruesi i terminimit në rrjetin e tij), në emër të Operatorit përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të operatorit celular (ofruesi i terminimit në rrjetin e tij), sipas planit të numeracionit’.

162. Ndërkohë me implementimin e portabilitetit të numrit celular, përcaktimi i mësipërm që identifikon si abonent/pajtimtar të një rrjeti celular pajtimtarët që zotërojnë numër celular që i përket serive numerike të alokuara nga AKEP operatorit përkatës celular, nuk është më i vlefshëm. Për këtë arsye, AKEP me vendimet e datës 20.04.2011, ka bërë disa ndryshime në ofertat referencë të interkoneksionit për përkufizimin e termave të terminimit dhe abonent/pajtimtar si më poshte:

“Shërbimi i Terminimit në rrjetin e operatorit celular X”

Shërbimi nëpërmjet të cilit operatori celular X, ne emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonentëve/pajtimtarëve të operatorit celular X.

“Abonent/pajtimtar i rrjetit operatori celular X”: Abonentet/pajtimtarët që:

Kanë numër celular që i përket serive numerike 06Y 9 xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, numër i cili nuk është portuar në rrjetin e një operatori tjetër, ose

Kanë numër që nuk i përket serive numerike 06Y xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, por që është portuar në rrjetin e operatorit celular X.

163. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është një shërbim me shumicë, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t’u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular.
164. Terminimi i thirrjeve në rrjetet e operatorëve celulare në Shqipëri është kryer dhe kryhet nëpërmjet interkoneksionit direkt midis operatorëve, ose nëpërmjet interkoneksionit indirekt, duke bërë tranzitim nëpërmjet rrjeteve të tjera të cilat mundësojnë shërbimin e tranzitimit.

4.1 Përcaktimi i tregut përkatës për terminimin e thirrjeve celulare

165. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të levizshme, është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian të vitit 2007 dhe vitit 2014, dhe për këto arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse ky treg është treg përkatës i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante. Përkufizimi i këtij tregu si treg i justifikueshëm për nderhyrje ex-ante është tashmë një praktikë rregullatore e konsoliduar dhe e aplikuar në të gjithë vendet anetare dhe kandidatet të BE, si edhe me gjere.
166. Në të gjitha raundet e analizave të tregut celular për terminimin e thirrjeve, AKEP ka përcaktuar tregje përkatëse të vecanta për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet celular të operatoreve aktive në treg: Telekom Albania, Vodafone Albania, Albtelecom (viti 2010 e në vijim), dhe Plus Communication (viti 2012 e në vijim).
167. Duke iu referuar dhe rekomandimeve të KE, tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive të rrjeteve celulare: 2G/GSM, 3G-UMTS edhe 4G-LTE, dhe nuk ndikojnë në përkufizimin e tregut përkatës.
168. AKEP në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë parimin Pala Thirrëse Pagan (CPP-Calling Party Pays) në konkluzionet e arritura në analizën e 2014. Për këto arsye AKEP edhe gjatë analizës së tregut 2016-2018 nuk e konsideroi të nevojshme të bëjë një analizë të testit të tre kritereve apo të produkteve/shërbimeve të përfshira në këtë treg, duke konkluduar sa më poshtë:
- *Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në rrjet celular është një treg i veçantë për secilin operator rrjeti celular aktiv në treg;*
 - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive/teknologjive/standardeve të rrjeteve celulare: GSM, UMTS dhe LTE, pra përfshirë çdo lloj topologjie/teknologjie apo rrjeti celular të mundshëm;*

- *Terminimi i SMS-ve nuk është pjese e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular;*
- *Tregun i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare përfshin vetëm thirrjet e origjinuara në Republikën e Shqipërisë;*
- *Dimensioni gjeografik i shërbimit të terminimit në secilin nga rrjetet celulare është kombëtar, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.*

169. Bazuar në analizat e tregut deri në vitin 2018, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës si edhe termini i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare.

4.2 Rregullimi i MTR kombëtare

170. Siç është evidentuar në seksionin e Hyrjes, AKEP (më parë ERT) përgjate viteve 2006-2016 ka përdorur një sërë mënyrash të rregullimit të tarifave në rrjetet celulare:

- i. nëpërmjet procedurave të zgjidhjes së mos-marrëveshjeve duke përcaktuar çmime maksimale për tarifën e terminimit celular;
- ii. nëpërmjet statusit të FNT dhe rregullimit të nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, bazuar:
 - Në nivelet mesatare të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe/ose normës së ndryshimit të tyre;
 - Në rezultatet e modelit të kostove BULRAIC + të përgatitur në vitin 2010;
 - Në nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BURIC, viti 2014 e në vijim;
 - Në përdorimin e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) për të arritur në nivelin e synuar (benchmark ose kosto BULRAIC).

171. Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2014, në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër. AKEP në vitin 2014, në dokumentin dhe vendimet e Mars 2014 për llogaritë nivelin e tarifës mesatare në vendet që kishin aplikuar BULRIC të pastër dhe kreu rregullime me glide path të tarifave të terminimit për të arritur nivelin benchmark të llogaritur. Gjatë kësaj periudhe numri i vendeve që kanë aplikuar modelin e kostove BULRIC të pastër është rritur nga 13 në vitin 2013 në 22 në vitin 2016, dhe 24 vende deri në Korrik 2017 si dhe 5 vende të tjera, si edhe Shqipëria rregullojnë tarifën e terminimit celular bazuar në tarifën benchmark të vendeve që aplikojnë modelin e kostove BULRAIC të pastër.

172. AKEP nëpërmjet vendimeve të Analizës së tregut në Nëntor 2014 rishikoi grafikun e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) të përcaktuar në Mars 2014, duke përshpejtuar arritjen e nivelit benchmark prej 1.48 lek/minute për Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom.

173. Detyrimet e vendosura për FNT në 2014 dhe rishikimi i tyre në Mars 2015 janë përshkruar në këtë dokument të analizës së tregut 2016, përfshirë efektin pozitiv në tregun me pakicë në

lidhje me trafikun dhe tarifate e thirrjeve on-net/off-net, por edhe mos-dhënie efektsh në lidhje me pjesët e tregut.

174. AKEP vlerëson së këto efekte pozitive kanë ardhur si pasojë e zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifate on-net/off-net i shoqëruar me reduktime të ndjeshme të tarifave të terminimit të katër operatorëve celulare.

4.2.1. Metoda e rregullimit të MTR

Sipas nenit 57 te ligjit 9918, Metoda e rregullimit të tarifave:

1. *AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:*
 - a) *Përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;*
 - b) *Korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:*
 - i) *kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;*
 - ii) *raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;*
 - iii) *procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;*
 - c) *përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.*
 2. *Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:*
 - a) *praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;*
 - b) *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*
 - c) *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;*
 - d) *raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*
 - e) *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*
 3. *Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.*
 4. *Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.*
 5. *AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.*
175. AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre, pra sipas pikës 1/a të nenit 57. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP në mungesë të pasjes së një modeli kostosh që përputhet me karakteristikat e vendit, gjykon si alternativë më të mirë përdorimin e tarifave benchmark dhe praktikave më të mira në vendet e BE dhe rajonit (BEREC-që përfshin vendet e BE si dhe disa vende te rajonit). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2.

Benchmarku i përshtatshëm për MTR

176. Në lidhje me zgjedhjen e mësipërme, AKEP në vlerëson se disa nga zgjedhjet kryesore që duhen bërë janë:

1. Përdorimi si *benchmark* i nivelit mesatar të MTR në vendet e BE (AVG EU 28) apo niveli mesatar i tarifave në vendet e BEREC që kane aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC;
2. Si referencë për nivelin benchmark të jetë niveli i MTR i përdorur në analizën e vitit 2018, apo niveli benchmark i MTR në Korrik 2018 (përditësimi më i fundit në këtë dokument);
3. A duhet të përdoret ose jo *glide path* për të arritur në nivelin e synuar benchmark sipas zgjedhjeve në pikat 1 dhe 2 më sipër dhe a duhet të aplikohet tarifa simetrike apo asimetrike midis tre operatorëve celular dhe nëse po, si duhet të jetë skema/afatet e aplikimit të tyre.

Asimetria/Simetria e aplikimit të MTR të ri

Në lidhje me mënyrën dhe nivelin e rregullimit të tarifave gjatë procesit të këshillimit publik për analizën e vitit 2017-2018 u shtruan dy pyetje:

1. A duhet të aplikohen tarifa simetrike apo asimetrike midis operatorëve celularë?
2. Kur duhet të fillojë aplikimi i kësaj tarife dhe a është e nevojshme të aplikohet një *glide path* për të arritur në këtë nivel?

177. Një çështje e diskutuar në analizat dhe dokumentat e mëparshme të AKEP ka qënë aplikimi i tarifave asimetrike të terminimit midis operatorëve më të mëdhenj dhe të hershëm në treg në raport me operatorët më të vegjël dhe hyrës më të vonë në treg. Ecuria e tarifave të terminimit të dhënë në tabelen me poshte evidenton asimetrinë e aplikuar ndër vite për Albtelcom (EM) dhe për Plus në raport me Vodafone Albania dhe Telekom Albania.

Tabela 13: Asimetria e tarifave të terminimit të Albtelcom dhe Plus

	Albtelcom (EM)			Plus		
	%	Lek/minute	Muaj	%	Lek/minute	Muaj
Mars 2008	11%	1.75	6			
Shtator 2008	11%	1.37	12			
Shtator 2009	23%	2.42	14			
Nentor 2010	23%	2.42	4	80%	8.4	4
Mars 2011	23%	2.04	6	114%	10.05	6
Shtator 2011	17%	1.28	12	150%	11.33	12
Shtator 2012	7%	0.42	12	112%	6.82	12
Shtator 2013	0%	0	0	94%	4.28	7
Prill 2014	51%	1.34	8	145%	3.86	8
Dhjetor 2014	0%	0		341%	5.04	37
Kohezgjatje Total Asimetri		74 muaj			86 muaj	

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi DTMRR

178. Kohëzgjatja totale e asimetrisë së Albtelecom (EM) ka qënë 74 muaj dhe niveli i asimetrisë së EM ka qënë 7-23% për rreth 5 vjet dhe 51% në për muaj në periudhën Prill-Nëntor 2014. Në terma mesatare të ponderuar (asimetri dhe muajt e aplikuar), niveli i asimetrise i aplikuar per Albtelecom ka qene mesatarisht 20% ose 1.54 lek/minute në muaj. Ndërkohë asimetria e aplikuar për Plus zgjati 86 muaj (7 vjet e dy muaj) apo mesatarisht 216% ose 6.5 lek/minutë në muaj.
179. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut neto midis tre operatorëve celularë aktualë dhe pagesat neto midis tyre. Ne vijim te ndryshimeve ne strukturen e tregut celular si dhe te komenteve te depozituara per kete dokument, AKEP ka perditesuar te dhenat e grafikeve te publikuar ne keshillim publik me muajt Janar-Gusht 2018 si me poshte.

Figura 13: Ecuria e trafikut dhe të ardhurave neto midis tre operatorëve celularë 2014-18 (konfidenciale)

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP.

Tabela në vijim paraqet një përmbledhje të të ardhurave/pagesave neto midis tre MNO-ve ndër vite. (konfidenciale)

Tabela 14: Pagesat neto për terminimn e thirrjeve midis 3 MNO-ve 2014 - 2018 (ne lek)

Viti	Telekom	Vodafone	Albtelecom
2014			
2015			
2016			

2017

2018

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP

180. Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, Vodafone Albania është përftues neto lidhur me pagesat e terminimit të thirrjeve. Ndërkohë që Telekom Albania e ka ulur pjesën e pagesave neto negative gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017, Albtelecom ka shënuar përkeqësim të këtyre pagesave gjatë kësaj periudhe.
181. Në vijim të përfundimeve të analizës dhe të dhënave të mësipërme vihet re se:
- i. Vodafone ka qenë përftues neto në vlera të mëdha nga pagesat e interkoneksionit midis 3 MNO-ve;
 - ii. Telekom Albania në 2014-2017 ka pasur të ardhura neto totale negative në vlerë të vogël, por këto të ardhura neto negative janë në rritje në vitin 2017 në raport me Vodafone për shkak të rritjes së trafikut off net drejt këtij operatori për tu shoqëruar me një rënie graduale që nga muaji shkurt i vitit 2018;
 - iii. Albtelecom ka qenë operatori që ka pasur të ardhura neto negative gjatë gjithë kohës së aktivitetit të tij, pavarësisht dhe asimetrisë së aplikuar, e cila vlen të theksohet se ka qenë më e ulët dhe se ato të rekomanduara nga ERG;
 - iv. Me daljen e sipermarresit Plus Communications nga tregu ka ndryshime midis trafikut dhe të ardhurave/pagesave neto midis tre MNO-ve, por trendi vijon të jetë i njëjtë si në vitin 2017: Vodafone është përftues neto, ndërsa Telekom dhe Albtelecom janë pagues neto.
 - v. Pësia e madhe e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në të ardhurat e operatorëve bën që de-rregullimi i MTR ndërkombëtar të krijojë avantazhe më të mëdha për operatorët më të mëdhenj në treg. Në vendet e BE ky nuk është problem pasi pësia e këtyre të ardhurave nga MTR ndërkombëtar jashtë rregullimit është shumë e vogël:
 - a. Thirrjet me të mëdha hyrëse ndërkombëtare janë midis vete vendeve të BE që janë me MTR nën rregullim;
 - b. Normalisht vendet e zhvilluara (përfshirë ato të BE) janë vende që gjenerojnë shumë më tepër trafik dalës ndërkombëtar se hyrës ndërkombëtar nga vendet në zhvillim (si Shqipëri apo rajoni).
182. *AKEP në dokumentin final miratuar me VKD Nr. 70, datë 01/10/2018 pas këshillimit publik me vendimet për rregullimin e tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë, si dhe uljen e mëtejshem të tyre për ti barazuar me benchmarkun më të fundit të MTR të vendeve të BEREC që kanë aplikuar model kostoje LRIC i pastër. Kjo është në përputhje dhe me objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH” si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Europian dhe BEREC.*

4.3 Rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare

183. Skenarët e propozuara në dokumentin për këshillim publik për rregullimin e tarifave me shumicë të terminimit në rrjetet cekulare ishin:

- 1- Përditësimi sipas metodës së benchmarkut me të dhënat e korrik 2018 që do të sillte ulte e tarifave të terminimit nga 1.22 që është aktualisht në 1.08 lek/minute
- 2- Shtyrjen e vendimmarrjes për përcaktimin e tarifave mbi Modelin e Kostos BULRAIC sipas projektit të asistencës ndërkombëtare;
- 3- Rishikimin e MTR duke përfshirë dhe terminimin ndërkombëtar me tarifa propocionale sipas peshës në tregjet e shumicës të terminimit kombëtar dhe ndërkombëtar të operatorëve;
- 4- *Përditësimi sipas metodës së benchmarkut me të dhënat më të fundit të publikuara nga BEREC në qershor 2019 që i korespondojnë të dhënave të janar 2019 do të sillte ulje e tarifave të terminimit me 15.3 % ose në vlerë absolute nga 1.11 lek/minute planifikuara për hyrjen në fuqi në 1.12.2019 në 0.94 lekë/min sipas benchmarkut PURE-LRIC (më të fundit të disponueshëm).*

Tabela 15: MTR-Benchmarku BEREC (Pure LRIC)

	Korrik 2016		Korrik 2018		Janar 2019	
	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK	Eurocent	LEK
Average BEREC (Pure LRIC)	0.8838	1.22	0.7907	1.01	0.7547	0.94 ²⁶
Average EU28(S)	1.0435	1.44	0.8342	1.06	0.7794	0.97
Average EU28 (W)	1.0836	1.5	0.8541	1.09	0.7837	0.98
Average BEREC 37(S)	1.1358	1.57	0.9402	1.2	0.8847	1.10
Average BEREC 37(W)	1.2743	1.76	0.8467	1.08	0.7956	0.99
Albania (AVG 3 MNO)	1.0699	1.48	1.16215	1.48	0.9801	1.11

184. Sipas nenit 57 të Ligjit (Metoda e rregullimit të tarifave), “në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për: a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së; b) tarifën mesatare të vendeve të BE-së dhe c) tarifën e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

Përfundimet për terminimin e thirrjeve kombëtare:

185. Bazuar në analizën dhe përfundimet e mësipërme AKEP gjykon se në kushtet kur është në zbatim projekti asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një Modeli Kosto për Terminimin me shumicë të thirrjeve në rrjetete celulare të vijojë me mbajtjen në fuqi të masave rregullatore ndaj tre operatorëve të shpallur FNT në tregun përkatës të terminimit kombëtar dhe të vijojë me opsionin (2) mbajtjen e tarifës aktuale të terminimit 1.11 lek/min deri në përcaktimin e tarifave mbi Modelin e Kostos BULRAIC sipas projektit të asistencës ndërkombëtare.

²⁶ Kursi kembimit 1 eur=124.48 ALL

- a) Sipërmarrësi Albtelecom sh.a. përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular Albtelecom;
 - b) Sipërmarrësi Telekom Albania sh.a. përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular Telekom Albania;
 - c) Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania;
186. Duke vlerësuar qëndrimet e operatorëve të rrjeteve celulare, parashikueshmërinë dhe qendrueshmërinë e vendimeve të AKEP dhe procesin aktual të marrjes së asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një modeli kostosh BU-LRIC, AKEP do të analizojë dhe trajtojë rezultatet e përfundimit të projektit të asistencës teknike për Modelin e Kostove dhe do të vendosë për aplikimin e tyre në analizën e rradhës së tregjeve përkatëse.
187. Tarifa është përcaktuar sipas metodës së benchmark-ut, metodë e cila është në përputhje dhe me objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7 të ligjit “Për komunikimet elektronike në RSH”, si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC dhe do të vijojë me këtë metodologji deri në përfundimet e projektit të asistencës teknike për Modelin e Kostove që po zbaton AKEP me konsulentë ndërkombëtarë.
188. **Si konkluzion, AKEP ka vendosur që të vijojë me simetrinë e MTR midis tre operatorëve celularë, si dhe aplikimin e tarifës së terminimit të thirrjeve kombëtare celulare 1.11 lekë (pa TVSH), deri në një analizë dhe vendimmarrje tjetër të AKEP.**

Vlerat dhe afate e MTR finale sipas këtij dokumenti janë sipas tabelës së mëposhtëme:

Tabela 16: Tarifat maksimale për MTR (deri në një vendimmarrje tjetër të AKEP për këtë treg)

Operatori	Nga data vendimit aktual deri në një vendimmarrje tjetër
Vodafone Albania	1.11
Telekom Albania	1.11
Albtelecom	1.11

Shënim: Tarifat në lek/minutë pa TVSH

4.4 Rregullimi/de-rregullimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare

189. Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe fikse kanë qenë nën-rregullim nga AKEP në periudhën Shtator 2008-Shkurt 2012. Rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në periudhën e cituar është kryer nga AKEP duke i përcaktuar ato të barabarta me MTR për thirrjet kombëtare.
190. AKEP me Vendimet nr.1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi nxjerrjen nga rregullimi të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare për Telekom Albania (ish AMC), Vodafone Albania dhe Altelecom (ish Eagle Mobile) me efekte nga data 1.02.2012.
191. Në analizën e tregut të vitit 2012, AKEP me Vendimet nr.2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.07.2012 kreu de-rregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke hequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie aksesi, mos-diskriminim dhe transparencë, me efekt nga data 1.09.2012. Ky qëndrim është mbajtur nga AKEP edhe në analizën e tregut të vitit 2014 si dhe në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik në Dhjetor 2016.

4.4.1. Praktika e Komisionit Evropian për përcaktimin e tregut përkatës

192. Në vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (EEA), autoritetet rregullatore aplikojnë praktika të ndryshme në lidhje me trajtimin e thirrjeve jashtë kësaj zone (non EEA).
- Disa nga vendet i përfshijnë thirrjet ndërkombëtare në të njëjtin treg përkatës me ato kombëtare dhe operatorët e terminimit të këtyre thirrjeve aplikojnë tarifë shtesë për këto thirrje;
 - Disa vende i kanë përjashtuar terminimin e thirrjeve ndërkombëtare nga tregu përkatës i thirrjeve kombëtare për operatorët e terminimit të thirrjeve;
 - Disa, e përfshijnë terminimin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare në të njëjtin treg, në dy mënyra:
 - e përjashtojnë aplikimin e tarifës shtesë nga operatorët terminues për terminimin e thirrjeve të origjinuara nga jashtë EEA; ose
 - ose duke aplikuar një politikë kushtëzuese “reciprociteti”²⁷ për thirrjet e origjinuara jashtë zonës EEA (Franca, Gjermani, Holanda).

Tabela 17: Mënyra e aplikuar për rregullimin e MTR nga vendet e BEREC 2018

Trafik Intra EU/EEA	Të gjithë trafikun	Trafik kombëtar
Austri	Qipro	Maqedoni
Belgjikë	Finland	Maltë
Bullgari	Gjermani	Zvicër
Kroaci	Irland	Turqi
Republika e Çekisë	Rumani	

²⁷ Mënyra e aplikimit të “reciprocitetit” varion sipas vendeve, psh: operatorët Francezë mund të caktojnë vetë normat e terminimit të thirrjeve deri në nivelin e tarifës kundërpalës nga vendi tjetër (jashtë EEA), ndërsa operatorëve Gjermanë u lejohe përjashtim nga kontrolli i tarifës sipas vendeve (country by country) pra të njëjtën tarif për të gjithë operatorët e vendit tjetër.

Danimark	Slovaki	
Estoni	Britania e Madhe	
Francë		
Greqi		
Hungari		
Itali		
Letoni		
Lituani		
Luksemburg		
Hollandë		
Norvegji		
Poloni		
Portugali		
Sloveni		
Spanjë		
Suedi		

Burimi: Cullen International. Përpunimi DTMRR

193. Siç vërhet nga tabela sa më sipër edhe vetë vendet e zonës EEA aplikojnë praktika të ndryshme për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve, ku 22 vende aplikojnë tarifë të rregulluar për terminimin e thirrjeve brenda BE-së, gjithashtu edhe katër vendet të tjera e diferencojnë terminimin e thirrjeve kombëtare, pra rregullojnë vetëm thirrjet kombëtare.

4.4.2 Rregullimi thirrjeve ndërkombëtare sipas OFcom

194. Rregullatori i Britanisë së Madhe OFcom në analizën e tregut celular për periudhën 2018-2021. Sipas raportit të OFcom në disa vende të Zonës Përbashkët Ekonomike (EEA), rregullatorët kombëtarë kanë aplikuar qasje të ndryshme të trajtimit të tarifave të terminimit të thirrjeve që vijnë nga jashtë zonës EEA:

- a. Disa rregullatorë i kanë përfshirë thirrjet jashtë zonës ekonomike në të njëjtin treg përkatës me terminimin e thirrjeve në zonën EEA dhe kanë zbatuar të njëjtën tarifë të terminimit të thirrjeve.
- b. Disa autoritete rregullatore i kanë përjashtuar thirrjet ndërkombëtare nga tregu përkatës i terminimit dhe për pasojë tarifat janë të derregulluara.
- c. Disa Rregullatorë megjithëse i kanë përfshirë thirrjet jashtë zonës EEA në të njëjtin treg përkatës me thirrjet brenda zonës kanë:
 - i) Kanë përjashtuar terminimin e thirrjeve me origjinë jashtë EEA nga rregullimi tarifës ose;
 - ii) Kanë aplikuar një formë të kushteve reciproke për thirrjet jashtë zonës EEA.

Mënyra e rregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare/ndërkombëtare:

Një MTR për të gjitha thirrjet	Finland, Ireland, Rumani, Britani e Madhe
--------------------------------	---

Thirrjet jashtë zonës EEA të përjashtuara nga tregu përkatës dhe nga rregullimi MTR	Danimarke, Estoni, Latuani, Luksemburg, Poloni
Thirrjet jashtë zonës EEA në të njëjtin treg përkatës por pa rregullim tarife	Austri, Belgjike, Kroaci, Rep Çeke, Greqi, Hungari, Itali, Norvegji, Portugali, Slloveni, Spanje, Sllovakia
Tarifa reciproke	France, Gjermani, Hollande

195. OFcom ka konsideruar tre opsione për trajtimin e MTR për thirrjet e origjinuara nga jashtë zonës EEA

- Opsioni 1: Rregullim pa diferencim (ruajtje e stato-quo) – ky opsion do të përmbahej qasjes aktuale dhe zbatohet e njëjta tarifë termnimit në Britaninë e Madhe pavarësisht origjinës së thirrjeve;
- Opsioni 2: Përjashtimin e kontrollit të tarifës së termnimit për thirrjet që vijnë nga jashtë zonës përbashkët ekonomike – ky opsion do të hiqte kontrollin e tarifës për thirrjet jashtë EEA duke i dhënë ofruesve të shërbimeve celulare liri në vendosjen e MTR për thirrjet jashtë EEA;
- Opsioni 3: Kushte reciprociteti për thirrjet e origjinuara nga jashtë EEA-ky opsion do të hiqte kontrollin e tarifës terminimit për thirrjet e origjinuara nga jashtë EEA por do të kërkonte që çdo negociatë të bëhej mbi bazën e reciprocitetit që nënkupton që tarifa e terminimit për një ofrues shërbimesh jashtë zonës EEA nuk mund të jetë më e lartë se ajo që i ofrohet një operatori të rrjeteve celulare brenda EEA.

196. OFcom ka konkluduar se duhet te aplikohet një tarifë e vetme e terminimit sipas modelit LRICpavarësisht origjinës së thirrjes (nuk ka diferencim në rregullim). Pavarësisht se në analizat e mëparshme OFcom kishte argumentuar se ka argumente pro dhe kundër për fleksibilitetin e tarifës së terminimit brenda dhe jashtë zonës përbashkët evropiane, OFcom argumenton se është në përmbushje të detyrimeve ligjore mbrojtja konsumatorë dhe mosaplikimi i tarifave të larta të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare dhe se diferencimi i këtyre tarifave do të sillte vështirësi në zbatimin në praktik.

Impakti i terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare

197. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut të terminuar në rrjetet celulare sipas origjinës, kombëtare dhe ndërkombëtare, për periudhën 2014-2018 për katër operatorët celularë.

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

198. Bazuar në të dhënat e paraqitura sa më sipër vërehet qartë një rënie e minutave të komunikimit të thirrjeve ndërkombëtare nga viti 2014 në vitin 2018, me përjashtim të sipërmarrësit Vodafone Albania i cili ka pasur rritje të thirrjeve ndërkombëtare të terminuara gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2017, megjithatë vlera e vitit 2018 është dukshëm më e ulët se ato të viteve 2014-2016.
199. Rënia e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare i atribuohet ndër të tjera edhe rritjes së përdorimit të internetit me anë të telefonave celularë, nëpërmjet të cilit konsumatorët komunikojnë duke përdorur aplikacionet, etj.
200. Për sa i përket terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare, në ndryshim nga ato ndërkombëtare vërehet se sasia e këtyre thirrjeve ka pësuar rritje të ndjeshme gjatë këtyre viteve, sidomos krahasuar me vitin 2014. Kjo rritje, ndër të tjera është edhe si rezultat i masës rregullatore të AKEP për e mosdiskriminimit të tarifave *On-net* me ato *Off-net*.
201. Figurat e mëposhtme paraqesin ecurinë e të ardhurave me shumicë të operatorëve celularë nga terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Pavarësisht reduktimit të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare, të ardhurat nga terminimi i këtyre thirrjeve kombëtare kanë një rritje të ndjeshme në vitet 2015 dhe 2016 për shkak të rritjes së madhe të trafikut off-net.

Figura 15: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve kombëtare 2014-2018

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

202. Nga të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, vërehet se të ardhurat nga terminimi i thirrjeve kombëtare ka pësuar rritje të ndjeshme,

. Gjatë vitit 2018 totali i të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare nga rrjetet mobile ka pësuar rënie të ndjeshme, e ndikuar kjo edhe nga dalja e sipërmarrësit Plus Communication nga tregu.

203. Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare mobile përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash me shumicë për operatorët për shkak të trafikut të lartë hyrës ndërkombëtare si edhe tarifës që operatorët aplikojnë për këto thirrje që arrin deri në 30 eurocent/minutë apo 40 lek/minutë që është shumë herë më e lartë (rreth 27 herë) se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare.

Figura 16: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare 2014-2018

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP

204. Gjatë vitit 2018, vërehet ulje e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtre për të tre operatorët, megjithatë të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare vazhdojnë të zenë peshën më të madhe të të ardhurave nga terminimi i thirrjeve me mbi 51%. Edhe viti 2017 ka pasur rënie në të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare, kjo ka ardhur edhe si rezultat i largimit të pajtimtarëve nga përdorimi i SMS-ve dhe thirrjeve zanore ndërkombëtare duke kaluar te zëvendësuesit OTT (ËhatsApp, Viber Messenger, Skype etj), duke vënë nën presion të ardhurat e sipërmarrësve nga thirrjet ndërkombëtare.

205. Nga te dhënat për tre operatorët aktualisht aktiv në treg vihet re se:

4.4.3 Argumente KUNDËR rregullimit të MTR ndërkombëtare

206. AKEP ka qenë transparent në argumentat e dhëna në rastet e rregullimit dhe derregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare duke analizuar avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej alternativave sa kohë edhe në vendet e BE dhe jashtë saj ka qasje të ndryshme për këtë problematikë.

207. AKEP ka konsultuar çdo dokument të analizës së tregjeve me palët e interesuara kryesisht operatorët e rrjeteve celulare dhe sipërmarrësit e autorizuar për terminimit/tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare duke i pasqyruar të plota komentet e tyre dhe duke bërë transparente vendimmarrjen e vet.

208. AKEP në dokumentin “*Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit-Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 2118, date 4.07.2012, e ka trajtuar në një seksion të veçantë terminimit të thirrjeve ndërkombëtare hyrëse. **AKEP, bazuar edhe në komentet e operatorëve si dhe në informacionin nga vendet e rajonit në raportin e Mars 2012 të Cullen International , në të cilin evidentohet që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të mos jetë pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse në një rrjet celular, pra që shërbimi ku operatori është me FNT të përfshijë vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare, dhe se dhënia e aksesit dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në një rrjet celular është objekt i negociatave komerciale midis palëve, ku në të gjitha vendet e rajonit**

tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare përcaktohen në marrëveshje konfidenciale dhe janë jashtë rregullimit. Në bazë të këtij përfundimi, AKEP në vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve celularë, ka hequr detyrimet e operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

209. Gjithashtu, në dokumentin e analizës së tregut të vitit 2014, miratuar me VKD nr.2522, datë 6.11.2014, AKEP ka sqaruar se në vijim të përfundimeve të Analizës së tregut 2012, tregu përkatës i terminimit përfshin vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare. Në Analizën e tregut celular, të miratuar me VKD nr. 2118, datë 4.07.2012, AKEP ka përfshirë një seksion të veçantë (Seksioni III.3.III) për diskutimin në lidhje me detyrimet për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke përfshirë dhe kronologjinë e de-rregullimit të këtij shërbimi. Në këtë dokument AKEP përcaktoi që terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet celular nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular, pra statusi me FNT dhe gjithë detyrimet e tjera për FNT për terminimin e thirrjeve janë të zbatueshme vetëm për terminimin e thirrjeve hyrëse kombëtare. AKEP arriti në këtë përfundim pas procesit të këshillimit publik të analizës së tregut, ku dhe Neofone ka qenë pjesëmarrës në proces me komente, dhe ndër argumentet pro de-rregullimit ishte dhe fakti se terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është input për tregjet me pakicë në vendet e huaja dhe jo në Shqipëri, pra që nuk kanë ndikim në tregun vendas. AKEP gjykojti ndër të tjera se alternativa e duhur për de-rregullimin ishte alternativa 'c' e pyetjes 5 të këshillimit publik: Detyrimet e operatorëve me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të de-rregullohen plotësisht: operatorët celularë të mos kenë detyrim të japin akses, pra dhënia e aksesit dhe tarifa të jenë komerciale kur kanë interes të dy palët.
210. Disa argumente pro që mbështesin vendimet dhe qëndrimet e AKEP për de-rregullimin e këtij tregu janë:
- Reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet celulare ka mundësi të mos transmetohet në reduktime të tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, por vetëm shkon si fitim i tepërt për tranzituesit apo operatorët origjinues;
 - Reduktimi i cilësisë së thirrjeve në rrjetet celulare apo edhe fikse për shkak të përdorimit në masë të madhe të VoIP me cilësi jo të lartë;
 - Efekte negative të konsiderueshme direkt në të ardhurat e operatorëve celularë dhe indirekt në buxhetin e shtetit, por edhe në tarifat me pakicë të shërbimeve celulare (*waterbed effect*);
 - Efekte negative në mundësinë e operatorëve për të investuar në rrjete dhe teknologji të avancuara si rezultat i rënies së të ardhurave (një pjesë e konsiderueshme e të cilave vjen nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare);
 - Aplikimi nga operatorët e vendeve të tjera apo i *carrierave* ndërkombëtare i tarifave të terminimit për thirrje ndërkombëtare më të larta se terminimi për thirrjet kombëtare dhe më të larta se terminimi në Shqipëri;
 - De-rregullimi i këtij shërbimi në shumë vende të BE-së për thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga jashtë EU/EEA në vitet e fundit.
211. Një faktor tjetër në favor të de-rregullimit të tarifës dhe të aksesit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare është trajtimi nga Komisioni Evropian (KE) i roamingut ndërkombëtar. KE bazuar në problemet e tarifave të larta të roamingut për thirrjet dhe të dhënat për përdoruesit, ka vendosur nën-rregullim tarifat e roamingut ndërkombëtar (me pakicë dhe me shumicë) në vendet e BE, duke imponuar tarifa maksimale (çmime tavan) për operatorët në vendet e BE, por vetëm në marrëdhëniet midis operatorëve të vendeve të BE: tarifat e roamingut që

operatorët e vendeve të BE i paguajnë njëri-tjetrit janë nën – rregullim, por tarifat që paguajnë operatorët jashtë vendeve të BE operatorëve të vendeve të BE për roaming ndërkombëtar nuk janë nën-rregullim. Pra, vetë KE ka bërë një ndarje midis vendeve të BE dhe jo të BE, pasi masat e marra kanë impakt për përdoruesit në vendet e BE.

212. AKEP në lidhje me çështjen e përcaktimit të tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka përcaktuar si treg më vete thirrjet e origjinuara në Republikën e Shqipërisë (thirrjet kombëtare), pra terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk përfshihet si pjesë e këtij tregu përkatës. Në analizat e tregut të telefonisë celulare 2016 – 2018, AKEP ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të kryhen ndryshime në përcaktimin e tregut përkatës, pasi kjo zgjidhje është analizuar më parë nga AKEP dhe pranuar tashmë nga tregu. Gjithashtu, edhe në vendet e BE tendenca e viteve të fundit tregon se shumë vende anëtare të BE kanë filluar të trajtojnë në mënyrë të ndryshme terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të origjinuara nga vendet anëtare të BE dhe EEA (European Economic Area) dhe thirrjet hyrëse ndërkombëtare të origjinuara nga vendet e tjera. Sipas informacionit të publikuar nga Cullen International deri në Dhjetor 2017, në 22 nga 32 vende evropiane, rregullimi i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk përfshin thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë zonës EU/EEA, dhe në disa vende aplikohet vetëm rregullimi i terminimit të thirrjeve kombëtare (Dokumentimi “*Analiza e Tregut të Telefonisë Celulare*”, VKD Nr.11, datë 22.02.2018).
213. Një argument tjetër mbështetës për arsyetimin e AKEP për përcaktimin si dy tregje të ndara për terminimin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare është edhe arsyetimi i mungesës së kompetencës ligjore për të ndikuar në politikat e rregullimit të vendeve jashtë Republikës së Shqipërisë . Shembull: Nëse AKEP i përcakton njësoj të dy tregjet e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nëpërmjet këtij përcaktimi detyron operatorët vendas të rregullojnë edhe tarifat e terminimit ndërkombëtar duke i ulur ato, kjo do të rezultonte vetëm në ulje të të ardhurave të terminimit ndërkombëtar për operatorët që operojnë brenda Republikës së Shqipërisë (si rrjedhim më pak të ardhura në buxhet dhe potencialisht “ëaterbed effect”), ndërkohë që operatorët të cilët operojnë jashtë territorit të RSH dhe që kryejnë trafik të thirrjeve me operatorët në RSH do të vazhdonin të operonin mbi bazën e kushteve rregullatore të aplikuara sipas vendit të origjinës, pra nuk do të ndryshonin tarifat. Pra palë të dëmtuar do të rezultonin operatorët vendas dhe si rezultat të ardhurat në buxhetin e shtetit (pakësim) dhe konsumatorët Shqiptar si përdorues fundor të këtyre shërbimeve.

4.4.4. Argumente PRO rregullimit të MTR për thirrjet ndërkombëtare

214. Në vijim, AKEP ka dhënë një përmbledhje të argumenteve (PRO) që mbështesin rregullimin edhe të tarifave të terminimit ndërkombëtar, si dhe më pas janë dhënë disa argumente (KUNDËR) që kundërshtojnë këtë qëndrim dhe rregullim, argumente të parashtruara kryesisht nga operatorët celularë.
1. Operatori është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, përfshirë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare;
 2. Detyrimet për mos-diskriminim dhe orientim në kosto;
 3. Në treg konkurrues dhe të liberalizuar tarifat e terminimit nuk kanë dallim nga origjina e thirrjeve, për shkak të presioneve që krijon arbitrazhi;
 4. Rregulla të thjeshtuara për terminimin e thirrjeve;
 5. Përfitime për konsumatorët vendas dhe të huaj.
215. Është e qartë se ka një risk që tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare mos jenë reciproke për shkak të qasjes së ndryshme që përdorin vendet e BE-së dhe ato të rajonit, por

praktikat më të mira sugjerojnë trendin rënës të tarifave të terminimit, Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë me BE-në.

216. Praktika ka treguar se diferencimet e larta mes tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare me ato kombëtare janë bërë shkak për ofruesit/tranzituesit për të maskuar origjinën e thirrjeve duke manipuluar ose hequr Identifikimin e Thirrjes (CLI). Shembull: Rasti i procedimit administrativ filluar me VKD Nr.44, datë 19.6.2018 për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a” ku u vendos panimi pjesshëm të kërkesës së “Albtelecom sh.a” “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a”; dhe Vodafone të marrë masat për sa parashikohet në këtë Vendim si dhe për minimizimin e mëtejshëm të trafikut të gjeneruar nga CLI brënda një afati prej 2 muajsh nga data e marrjes së këtij Vendimi.
217. Një parim tjetër në favor të rregullimit të tarifave të thirrjeve ndërkombëtare është thjeshtimi i tarifave dhe rregullimit të tregjeve të ndryshme gjeografike në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve ndërsa nuk imponon më shumë ngarkesë rregullatore sesa duhet. Diferencat e larta (1 euro cent vs 27-30 eurocent) për terminimin e një minutë thirrje në rrjetet celulare mes thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare kanë krijuar diferencime në trajtimin e marrëvdhënieve mes operatorëve të rrjeteve celulare dhe sipërmarrësve që ofrojnë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare. Ndërkohë që për një pjesë të konsiderueshme të sipërmarrësve të autorizuar nga AKEP ky shërbim nuk ofrohet (refuzim aksesit) nga operatorët e rrjeteve celulare me argumentin se tregu është i derregulluar nga AKEP.

Tarifat e terminimit e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare në Shqipëri

218. Nga sa më sipër konstatohet se MTR ndërkombëtar janë dukshëm më të larta se tarifat e MTR kombëtar. Operatorët aplikojnë tarifa të diferencuara për carrier ndërkombëtarë dhe tranzituesit vendas, kjo bazuar në marrëveshjet preferenciale që ata kanë me operatorë/carrier të caktuar;
- Tarifat e aplikuara nga Telekom Albania gjatë vitit 2018 për operatorët/carrier ndërkombëtarë që kanë marrëveshje direkte për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrejtin e TA, kanë qenë në kufijtë 0.xxxx Euro/minutë – 0.xxxx Euro/minutë;
 - Tarifa mesatare për terminimin në Albtelecom Mobile (tranzitues të huaj) ka ardhur në ulje që nga muaji Korrik 2018 (varjon nga 0.xxx – 0.xxx Euro/minutë), ndikuar nga marrëveshjet preferenciale me operatorët në Kosovë dhe Itali;
 - Vodafone Albania aplikon tarifa të diferencuara për operatorët carrier ndërkombëtarë, konkretisht për operatorët pjesë e grupit në Greqi dhe Itali. Tarifa mesatare e aplikuar për bartësit ndërkombëtarë/carrier është 0.xxx Euro/minutë;

Konkluzione mbi trafikun nga thirrjeve ndërkombëtare

219. AKEP e mbështet veprimtarinë e tij në promovimin e konkurrencës efektive në tregjet e komunikimeve elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit. Këto parime janë në përputhje me direktivat e BE në fushën e komunikimeve elektronike që përfshijnë promovimin e konkurrencës në sigurimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik:
- a. promovimin e interesave të të gjithë konsumatorëve;
 - b. inkurajimin e sigurimit të aksesit në rrjet dhe ndërveprimin të shërbimit në masën që konsiderohet e përshtatshme për qëllimin e sigurimit:
 - i) efikasitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme;
 - ii) investime eficiente dhe inovacion;**
 - iii) përfitimi maksimal për klientët e ofruesve të komunikimit.
220. **Bazuar në analizën sa më sipër për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare,**
- a. **në mbështetje të praktikës dhe qasjes së ndjekur nga BE dhe vendet e rajonit për rregullimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare;**
 - b. **duke konsideruar argumentat pro dhe kundër të parashtruara sa më sipër, si edhe komentetet dhe qëndrimet e palëve të interesuara dhe të përfshira në këtë proces,**

AKEP gjykon se duke marrë në konsideratë:

- a) faktorët ekonomik, si edhe impaktin e mundshëm të investimit të operatorëve;
- b) efektet të konsumatorët fundorë;
- c) në kushtet edhe të rënies së të ardhura totale 2 % të të ardhurave për operatorët celularë gjatë vitit 2019; dhe,
- d) në kushte të pasigurta të tregut për shkak të pandemisë nga Covid-19,

ka vendosur lënie në de-rregullim të tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare celulare, siç është aktualisht.

221. Por AKEP në analizat e rradhës për terminimin e thirrjeve celulare, mund të vlerësojë përfshirjen e tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nën rregullim, duke marrë parasysh: (i) terminimin i thirrjeve pavarësisht origjinës ka të njëjtën kosto; (ii) qasja e pritshme e BE për tarifë të njëjtë të terminimit të thirrjeve nga rrjetet celulare në të gjitha vendet e zonës ekonomike të përbashkët të Evropës, (iii) marrëveshjen rajonale Roaming mes 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe (iii) procesin e integritimit Evropian të Shqipërisë.

Aneks 1- Trafiku i terminuar sipas operatoreve (konfidenciale)

Aneks 2: Procesi i roaming rajonal (Western Balkan Roaming)

222. Gjatë vitit 2018 Shqipëria në kuadër të proceseve integruese në Bashkimin Evropian është bërë pjesë e iniciativës për uljen e tarifave të roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina). Ky proces synon uljen e tarifave të shërbimeve roaming sipas modelit RLAH (Roam Like At Home) i aplikuar tashmë në vendet e BE.
223. Gjithashtu, në mbledhjen e dy qeverive të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës të mbajtur në Pejë me datë 26 Nëntor 2018, ndërmjet dy ministrive përgjegjëse në fushën e komunikimeve elektronike të dy vendeve u nënshkrua marrëveshja “*Për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrejtet publike të komunikimeve të lëvizshme*”. Bazuar në këtë marrëveshje, palët bien dakord që çmimet maksimale për shërbimet roaming me shumicë dhe pakicë të ulen në nivelin e çmimeve në përputhje me modelin “*Roam Like At Home*” dhe në përputhje me rregulloren e BE-së Nr.531/12012, e ndryshuar. Palët kanë rënë dakord që regjimi i ri të fillojë gradualisht nga 15 Qershori 2019, sipas një plani dhe afateve të rëna dakord ndërmjet rregullatorëve.
224. Për tju paraprirë këtyre proceseve Kuvendi i Shqipërisë me ligjin Nr. 107/2018, datë 20.12.2018, vendosi që në ligjin datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa:
Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) shërbimet e *roaming-ut* mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.”.
225. Në lidhje me proceset e roaming të cituara sa më sipër, në muajt Maj dhe Qershor të vitit 2019 AKEP ka miratuar vendimet përkatëse me Kosovën dhe me vendet e tjera të iniciativës së Ballkanit perëndimor dhe procesi i reduktimit të tarifave të shërbimeve roaming në këto vende ka hyrë në fuqi përkatësisht me datë 15 Qershor 2019 me Kosovën dhe me datë 1 Korrik 2019 me vendet anëtare të iniciativës së Ballkanit Perëndimor. Fillimisht reduktimi i tarifave për shërbimet e roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor do të aplikohet sipas modelit RLAH+, dhe me datë 1 Korrik 2021 është parashikuar hyrja në fuqi e modelit RLAH i plotë.

Aneks 3- Komentet e këshillimit publik dhe qëndrimi i AKEP

AKEP me VKD Nr. VKD nr.10, datë 17.04.2019 miratoi për Këshillim Publik dokumentin “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”. Dokumenti u publikua ne faqen

e Internetit te AKEP dhe keshillimi publik u krye gjate periudhes 18.04.2019 – 20.06.2019.

Në përfundim të keshillimit publik në AKEP kanë depozituar komente palët e mëposhtëme të interesuara:

- Autotoriteti i Konkurrencës me vendimin Nr. 634, Datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për keshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”;
- Telekom Albania sh.a me shkresën Nr.3044, datë 13.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1112/1, datë 18.06.2019);
- Albtelecom sh.a me shkresën Nr.4560, datë 20.06.2019, (Referenca e AKEP nr. 1112/2, datë 20.06.2019);
- Vodafone Albania sh.a me shkresën Nr. CEO/006/KQ, datë 18.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1112/3, datë 21.06.2019);
- Neofone sh.p.k me shkresën Nr.346, datë 19.06.2019 (Referenca e AKEP nr. 1113/5, datë 20.06.2019).

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces keshillimi për komentet dhe sugjerimet e dhena për dokumentin e nxjerrë në keshillim publik.

Ky Aneks më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet:

1.1. Komentet sipas pyetjeve të dokumentit për keshillim publik

1. Cili është opinioni juaj për stadin aktual të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar sipas metodologjisë së benchmarkut të vendeve të BE-së?

Telekom Albania

Glide-pathi aktual i tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare, i njëjtte për të tre operatorët celulare, nuk ka ndikuar në mënyrë pozitive në sektorin e komunikimeve elektronike, duke qenë se reduktimi i tyre këto vitet e fundit ka qenë i konsiderueshem (reduktim prej 33% nga 1.48 leke/min në 1.22 leke/min dhe 33% deri në nivelin 1.11 lek/Min). Ky reduktim i përshkallëzuar ka pasur efekt negativ tek financat e operatorëve celulare të reflektuara në uljen e ndjeshme të të ardhurave të tyre gjatë këtyre dy-tre viteve të fundit dhe për rrjedhojë dhe në aftësinë e tyre për të kryer investime.

Siç është evidentuar dhe në dokumentin për keshillim publik²⁸, të ardhurat totale të shërbimeve celulare për vitin 2018 kanë rënë me 10% krahasuar me vitin 2017. Kjo rënie ka qenë me e ndjeshme në të ardhurat nga terminimi me shumicë i thirrjeve për të gjithë operatorët, duke ndikuar ndjeshëm në normat përkatëse të fitimit.

²⁸ Faqja 34 e dokumentit parag.120 “Të ardhurat totale nga komunikimet elektronike mobile”

Niveli i MTR-ve kombetare ne fuqi (1.22 lek/min aktualisht) nuk ka pasur efekte pozitive ne te ardhurat e operatoreve ne sektorin e telefonise celulare i karakterizuar nga kosto mjaft te larta per shkak te nivelit te larte te investimeve. Investimet e kryera nga ana e Telekom Albania kane qene te konsiderueshme duke perfshire ketu investimet e kryera ne rrjet, pajisja me autorizimet individuale ne brezat e frekuencave 1800 MHz dhe 2600 MHz, investimet ne teknologjine 4G, si dhe ato te pritshme ne te ardhmen ne lidhje me frekuencat e lira ne brezin 800 MHz. Gjate vitit 2018 ato kane qene ne rritje (rreth 800 milion leke) krahasuar me vitin 2017. Per kete arsye rregullimi dhe percaktimi i MTR-ve nga ana e AKEP duhet te mbaje parasysh kostot e investimeve te kryera nga operatoret ne menyre qe te garantohet norma e kthimit te tyre, sic percaktohet ne nenin 7, pika 3/dh²⁹, te Ligjit nr.9918 per “Komunikimet Elektronike”, i ndryshuar, si dhe ne Direktiven Kuader te BE-se 2002/21 e amenduar, neni 8 “Objektivat e politikave dhe parimet rregullatore”, pika 5/d: ku citohet se:

5. Autoritetet rregullatore, ne zbatim te objektivave te politikave te referuara ne paragrafet 2, 3 dhe 4, do te aplikojne parime rregullatore objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale, ku nder te tjera:

d. duke promovuar investime efikase dhe inovacione në infrastruktura të reja dhe të zgjeruara, përfshirë ketu garantimin qe çdo detyrim per akses te marre parasysh rrezikun e ndermarrjeve investuese dhe duke lejuar marreveshje te ndryshme bashkepunimi ndermjet investitoreve dhe paleve qe kerkojne akses te diversifikojne riskun e investimeve, duke ruajtur nderkohe konkurrencen ne treg dhe parimin e mos-diskriminimit.”

Siç eshte permendur ne komentet ne keshillimin publik nr.2 per “Rregullimin e tarifave te sipermarresve me FNT ne tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare” me vendim te AKEP nr.15, date 22.02.2018, niveli i MTR-ve sipas ketij glide-pathi mbeshtetur ne metodologjine e benchmarkut te vendeve te BE-se nuk reflekton koston reale te operatoreve dhe ka si reference krahasuese vende me te zhvilluara pjese e BEREC me nje nivel me te larte te zhvillimit ekonomik krahasuar me vendin tone. MTR-te kombetare sipas kesaj metodologjie duhet t’i referohen mesatares se MTR-ve te vendeve me nje zhvillim te ngjashem ekonomik sic jane vendet e rajonit, pasi i perafrohen me shume realitetit ekonomik dhe atij te sektorit te komunikimeve elektronike te Shqiperise.

TA gjykon qe menyra me e drejte dhe e sakte per percaktimin e MTR-ve kombetare e cila pasqyron me sakte kostot e sherbimeve qe manifestojne operatoret celulare eshte metodologjia sipas nje modeli kostosh. Edhe ne ligjin Nr.9918, date 19.5.2008, "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ne nenet 45, 49 dhe 57 parashikohet qartesisht kerkesa per zbatimin e parimit te orientimit te tarifave drejt koston dhe preferencen per nje model per perlllogaritjen e kostove perkatese krahasuar me metodat sipas tarifave benchmark.

²⁹ AKEP-i nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:
dh) për të nxitur investimet efiçente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;

Ne konkluzion për sa më sipër, Telekom Albania mbështet faktin që MTR-te aktuale janë simetrike dhe të njëjta për të gjithë operatorët celularë sipas glide-pathi ekzistues, por niveli aktual i tyre dhe i reduktimit të përshkallëzuar sipas metodologjive së benchmarkut të vendeve të BE-se nuk është adekuat dhe i duhur për të promovuar në mënyrë më të pershtatshme nivelin e investimeve në rrjet dhe teknologji nga ana e operatorëve për të pasur shërbime dhe produkte sa më cilësore për përdoruesit.

Albtelecom

Albtelecom ka parashtruar që më herët, se masat rregullatore në tregun e shumicës, për nivelin simetrik të MTR-ve, të përcaktuara nga AKEP me vendimet e Tetorit 2018, dhe po ashtu edhe më herët, nuk do të adresonin problemet e mëdha të tregut celular në Shqipëri. Dhe për më tepër, jo vetëm që nuk do të ndihmonin konkurrencën në treg, por përkundrazi, niveli i përshkallëzimit të MTR-ve në vlera të tilla dhe në simetri me njëri tjetrin dhe në situatën ku operatori i katërt sapo kishte dalë nga tregu, vetëm sa i shërbeu operatorit dominues të forconte pozitën dhe pjesën e tij të tregut. Ashtu si Albtelecom ka pretenduar, edhe vetë AKEP ka evidentuar tashmë, vecanërisht në paragrafin 178 të dokumentit të Analizës, se detyrimet e vendosura që në 2014 e në vijim nuk kanë dhënë efekte në lidhje me pjesën e tregut. Kështu, edhe në dritën e këtyre gjetjeve të evidentuara, edhe masat e marra nga AKEP në analizat më të fundit kanë dështuar të përmbushin objektivat e kuadrit rregullator për nxitjen e konkurrencës efektive.

Në shumë seksione të dokumentit të Analizës, AKEP ka evidentuar se në ndryshim nga viti 2017, treguesit e tregut kanë shënuar rënie të theksuar për vitin 2018. Theksojmë këtu se dalja nga tregu i operatorit PLUS, çka në vetvete demonstron për mungesën e konkurrencës efektive, krijoi pritshmëritë që masat rregullatore do të ishin më të qarta dhe më konkrete për të rregulluar konkurrencën në treg. Efektet pritëshin të ishin më pozitive vecanërisht për Albtelecom si operatori më i vogël i mbetur në treg. Por në fakt, ndodhi e kundërta, ku edhe pas daljes nga tregu të operatorit PLUS, ashtu siç Albtelecom kishte paralajmëruar duke kërkuar edhe marrjen e masave përkatëse për të parandaluar situatën e rritjes së përqendrimit, AKEP ka evidentuar se gjatë vitit 2018 të gjithë treguesit e marrë në Analizë kanë shënuar vlera më të mëdha HHI. Në këtë situatë, në mungesë të tarifave asimetrike me operatorët dominantë, është e evidente që Albtelecom vijon ta ketë të pamundur ushtrimin e presionit konkurrues ndaj operatorëve dominantë.

Bazuar në sa më sipër, Albtelecom vijon të jetë i mendimit se AKEP nuk ka përcaktuar vlerat e MTR-ve në nivelin e duhur për operatorin më të vogël në treg, dhe çdo lloj inisiative për rishikimin e tyre do të duhej të korrigjojë qasjen e deritanishme të vendimarrjes së AKEP, në konsistencë me vetë gjetjet e tij në këtë dokument dhe në dokumente të mëparshme të analizave të tregut, dhe vecanërisht në konsistencë me argumentimin dhe qëndrimin e AKEP gjatë kështimit publik të dokumentit të rregullimit të tarifave të Shkurtit 2018.

Vodafone Albania

VA është e mendimit se qasja e ndjekur nga AKEP në lidhje me reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtaresipas metodës së benchmarkut ka funksionuar mirë si një masë e ndërmjetme dhe së bashku me tarifën simetrike midis 3 (tre) operatorëve celularë kryesorë gjatë këtyre viteve të fundit, ka çuar në rritjen e konkurrencës dhe tarifën të reduktuar për konsumatorin.

Siç do të analizohet edhe më poshtë, është koha e duhur për të përpunuar një sistem llogaritjeje të kostos për të identifikuar koston aktuale për Shqipërinë dhe për të shmangur shtrembërimet potenciale të tregut në të ardhmen.

Qëndrimi i AKEP

AKEP vlerëson si konsistente qëndrimet e tre operatorëve të rrjeteve celulare lidhur me tarifat e terminimit në rrjetet celulare dhe procesi i këshillimit publik i ka shërbyer rregullatorit për të parë efektivitetin e reduktimit të përshkallëzuar të tarifave të terminimit në rrjetet celulare. Nga komentet ku rezulton se operatori më i vogël dhe hyrja e fundit në treg pretendon se tarifat simetrike të terminimit kanë forcuar pozitën dominuese në treg dhe nuk kanë dhënë efekte në zgjidhjen e problematikës së konkurrencës në treg që pati si pasojë daljen nga tregu të operatorit Plus Communication. Telekom Albania pretendon se tarifat aktuale janë shumë të ulta dhe kanë patur efekte negative në financat e industrisë ndërsa Vodafone shprehet se reduktimi i përshkallëzuar dhe tarifat simetrike të terminimit kanë dhënë efekte positive.

Duke qenë transparent me operatorët, AKEP ka bërë me dije se ka prokuruar në mënyrë të hapur marrjen e shërbimit për ekspertizë ndërkombëtare për një model kostosh të tarifave me shumicë të terminimit në rrjetet celulare (proces i nisur që në fillim të vitit 2019). Për këtë arsye AKEP do të presë rezultatet e modelit të kostos për rishikimin e ardhshëm të MTR ndërkohë që Altelecom shprehet se AKEP duhet të korigjojë vendimin për MTR me tarifa asimetrike për të adresuar problemet e konkurrencës në treg.

2. A duhet t'i rishikojë drejt uljes AKEP tarifat e terminimit sipas ndryshimeve në mesataren e 23 vendeve që zbatojnë Pure LRIC apo duhet të qëndrojë në tarifat e terminimit të miratuara me datë 1.12.2018?

Telekom Albania

Referuar te dhenave te paraqitura nga AKEP ne dokumentin e analizes se tregut si dhe nga dokumenti i BEREC BoR(18)2018 "Termination rates at European level" July 2018, Aneksi 8, niveli aktual i MTR-se kombetare 1.22 lek/min (0.9579 eurocent/min) eshte me i ulet se ai i aplikuar ne Maqedonine e Veriut me karakteristika shume te ngjashme me vendin tone per sa i perket nivelit te zhvillimit ekonomik. Ndersa niveli i MTR-se 1.11 lek/min (0.8716 eurocent/min) duke filluar nga 1.12.2019 eshte akoma me i ulet se tarifa e MTR-se ne Maqedoninë e Veriut apo dhe ne Greqi, nga te dhenat e disponueshme ne raportin e BEREC Korrik 2018 (pasi per disa vende te tjera te rajonit keto te dhena nuk jane te disponueshme per periudhat pas vitit 2018).

Jul-18	Model	Rate status	Period 1	Period 2	Period 3
			1.07.2018-31.12.2018	1.01.2019-30.06.2019	1.07.2019-31.12.2019
			Eurocent/min	Eurocent/min	Eurocent/min
Albania	Benchmark BU-LRIC	adopted	1.1621	0.9579	0.8716
North Macedonia	TD LRIC	adopted	0.0249	1.0249	1.0249
Serbia	Benchmarking	adopted	1.2101		
Montenegro	Other TD LRIC	adopted	0.8500		

Greece	Pure BU-LRIC	adopted	0.9580	0.9460	0.9460
Croatia	Pure BU-LRIC	adopted	0.6353		
Average MTR			0.73566	0.98545	0.98545

Siç është evidentuar në faqen 26 të dokumentit të analizës së tregut në paragrafin “2.5 Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)”, MTR aktuale 1.22 lek në Shqipëri është afërsisht e njëjta me tarifën mesatare të thjeshtë të 37 vendeve të BEREC (që përfshin dhe vendet e rajonit) të 1 Korrik 2018, prej 1.20 lek/min.

Referuar sa më sipër, duke marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhet tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri, i karakterizuar nga një rënie e ndjeshme e të ardhurave të operatoreve celularë, si dhe faktin që glide-pathi aktual i MTR-ve është përcaktuar nga AKEP me vendimet përkatëse nr.71, 72 dhe 73, datë 1.10.2018, për VDF, TA dhe Albtelecom, pra në mënyrë pak se një vit, TA gjykon që AKEP nuk duhet të rishikojë seriozisht MTR-të kombëtare dhe duhet të lere në fuqi glide-pathin aktual të tyre, siç është parashikuar në vendimet e sipërcituara.

Është për t'u theksuar se një rishikim i tillë i tarifave të terminimit kombëtar bie në kundërshtim dhe me kuadrin rregullator në fuqi, me konkretisht me nenet 31 pika 4 dhe 34 pika 1 të ligjit nr.9918, i ndryshuar, ku citohet se:

*“Neni 31/Pika 4. Përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, **por jo më pak se një herë në dy vjet**, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.”*

*“Neni 34/Pika 1. AKEP-i kryen, në intervale të rregullta, **por jo më pak se një herë në dy vjet**, analizën e tregjeve përkatëse, të identifikuar sipas parashikimeve të këtij ligji. Pas përcaktimit nëse një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në tregun përkatës, ose nëse ekziston faktikisht një konkurrencë efektive, atëherë detyrimet anulohen, mbahen, shtohen ose vendosen në përfundim të analizës së tregut.”*

Pra, ndodhemi në një situatë ku nuk janë respektuar afatet kohore të parashikuara nga ligji për zhvillimin e analizës së tregjeve, i cili e përcakton qartësisht periodicitetin kohor ‘jo më pak se një herë në dy vjet’. Në këto kushte, AKEP nuk mund të rishikojë seriozisht MTR-të aktuale brenda një periudhe më pak se një vit, që nga momenti i përcaktimit të glide-pathit ekzistues, në Tetor 2018.

Për më tepër, operatorët celularë kanë përgatitur planet përkatëse të biznesit në përputhje me këto MTR, të cilat nuk mund të ndryshojnë në mënyrë kaq të shpeshtë dhe të papritur, pasi kështu cenohet siguria juridike në të cilin ata operojnë dhe për rrjedhojë kjo shkakton impakt negativ në të ardhurat dhe aftësitë e tyre financiare për të garantuar investime efektive dhe rentabel.

Për këto arsye, TA shprehet kundër rishikimit drejt uljes nga AKEP të tarifave të terminimit sipas ndryshimeve në mesataren e 23 vendeve që zbatojnë Pure LRIC dhe duhet të qëndrojnë në tarifën e terminimit për thirrjet kombëtare, të miratuara me datë 1.10.2018.

Albtelecom

Ju lutem, referojuni qëndrimin të Albtelecom në seksionin B në komentet e përgjithshme të Albtelecom

Vodafone Albania

Duke marrë parasysh të dhënat e paraqitura në Dokumentin për Këshillim Publik, lidhur me tarifat e terminimit që janë vendosur duke përdorur metodën LRIC të Pastër (Pure-LRIC), mund të vërehet se ekziston një diferencë e rëndësishme në tarifat e vendosura. Më konkretisht, tarifa më e ulët është përcaktuar në rreth 0.50 Lekë (Malta), ndërsa ajo më e lartë në 1.56 Lekë (Sllovaki). Duke pasur parasysh këtë, do të ishte e arsyeshme të pritej që kostoja aktuale për Shqipërinë të ishte diku midis dy ekstremeve të mësipërme.

Meqenëse tarifa aktuale e terminimit e zbatuar në Shqipëri është 1.22 Lekë, tashmë ekziston mundësia që tarifa aktuale të jetë nën koston reale. Prandaj, pa paragjykuar rezultatet që do të dalin nga modeli i llogaritjes së koston për Shqipërinë, ekziston një rrezik edhe më i madh se një reduktim i mëtejshëm i tariave të terminimit mund t'i çojë ato nën kosto.

Duke pasur parasysh këtë, siç do të shpjegohet në mënyrë të detajuar edhe më poshtë, VA rekomandon fuqimisht që të shmanget ulja e mëtejshme e tarifave të terminimit, derisa të vendoset modeli i llogaritjes së kostove.

Qëndrimi i AKEP

AKEP konsideron argumentimin e operatorëve mbi parashikueshmërinë e masave rregullatore dhe përfshirjen e MTR aktuale dhe asaj të pritshme në planet e biznesit por vlerëson se ulja e tarifës së terminimit të thirrjeve nga një rrjet drejt një rrjeti tjetër celular është në funksion të nxitjes së konkurrencës pasi ky reduktim i tarifave me shumicë është në favor të konsumatorëve dhe dekurajon efektet club nga sipërmarrësit dominues në treg që në të kaluarën³⁰ kanë qenë strategji që kanë çuar në kufizimet e konkurrencës në tregjet celulare.

Gjatë hartimit të dokumentit për këshillim publik AKEP ka analizuar të dhënat më të fundit të disponueshme mbi benchmarkun e BEREC të 18 korrikut 2018 nga ku rezultoi se mesatarja e thjeshtë e MTR duke përdorur metodën LRIC të Pastër (Pure-LRIC), është 0.79 eurocent që me kursin e këmbimit 1 Eur=127.35 ALL rezulton të jetë rreth 1.01 lekë, pra më e ulët se MTR prej 1.22 lekë deri në fund të uajit Nentor dhe ajo në fuqi që nga 1 dhjetor 2019 në vlerën 1.11 lekë.

AKEP sqaron se nuk qëndron pretendimi i Telekom Albania se rishikimi i tarifave nga AKEP është në kundërshtim me ligjin sepse nuk është ezauruar afati dy vjeçar pasi AKEP nuk duhet të

³⁰ Vendimi Komisionit të Konkurrencës 356/2015 "Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes VODAFONE ALBANIA SHA, në tregun e telefonisë celulare me pakicë": i. Ndërmarrja Vodafone, e cila zotëron 100 % të tregut të shitjes me shumicë (terminimit, i cili është një input i domosdoshëm për të kryer thirrje në rrjetin Vodafone) si dhe pozitë dominuese në tregun e pakicës sipas Vendimit nr. 303/2014 të Komisionit të Konkurrencës. Pjesët e tregut të Vodafone Albania në tregun e pakicës (sipas të ardhurave) janë më të mëdha se pjesët e tregut të 3 (tre) konkurrentëve të saj të marrë së bashku.


ii. Vodafone Albania ka aplikuar (për periudhën nën hetim 2013-gjysma e parë e vitit 2014) çmime shumë të ulta për thirrjet brenda rrjetit (nën tarifën e terminimit), për të cilët ndërmarrjet konkurrense nuk mund ta konkurrojnë në mënyrë fitimprurëse, pasi do të duhet që të paguajnë inputin e domosdoshëm për të kryer një thirrje drejt rrjetit Vodafone, tarifën e terminimit.

presë detyrimisht dy vjet për analizën e rradhës pasi ligji përcakton se “analiza tregjeve dhe përcaktimi i sipërmarrësve, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, por jo më pak se një herë në dy vjet, në bazë të një rregulloreje, të hartuar në zbatim të këtij ligji dhe në përputhje me rekomandimet përkatëse të BE-së.”

BoR (19) 91

Variation of MTRs per country (from July 2018 to January 2019)

Figure 10 Variation in eurocents and %¹²



Source: NRAs, BEREC

¹² Calculation for Iceland is based on data from 1 January 2018 and 2019.

3. A duhet të vazhdojë AKEP të përdorë metodën e benchmarkut apo duhet të presë konkluzionet e Modelit të Kostove me ekspertizë ndërkombëtare për të ndërmarrë korrigjimet e nevojshme pas konkluzioneve të modelit në fillim të vitit 2020?

Autoriteti i Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës për sa më sipër vlerëson se AKEP për tarifatat e terminimit të thirrjeve kombëtare të vazhdojë të përdorë metodën benchmark për rregullimin e tarifave MTR, si benchmark të përdoret vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Evropiane që kanë aplikuar modelin e kostove LRIC të pastër.

Telekom Albania

Ne ligjin Nr.9918, date 19.5.2008 "Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ne nenet 45, 49 dhe 57 eshte parashikuar qartesisht kerkesa per zbatimin e parimit te orientimit te tarifave drejt koston dhe preferencen per nje model te sakte te kalkulimit te kostove perkatese krahasuar me metodat sipas tarifave benchmark.

Perdorimi i metodes se benchmark per caktimin e tarifave maksimale te terminimit per thirrjet kombetare shkakton shtremberime materiale ne llogaritjen e kostove reale te operatoreve, pasi llogaritjet nepermjet aplikimit te nje modeli kostonsh japin nje informacion me korrekt pas te rezultateve dhe reflektojne saktesisht koston e operatoreve celulare per ofrimin e sherbimit te terminimit.

Sic kemi theksuar dhe ne komentet ne lidhje me keshillimin Publik Nr.2 sipas VKD Nr.15, dt.22.02.2018 “Rregullimi i tarifave te sipermarresve me FNT ne tregjet me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare”, perdorimi i metodes benchmark per percaktimin e MTR-ve maksimale ka impakt persa i perket pozitave financiare te operatoreve dhe planet perkatese te

biznesit ne terma afatgjate, pasi nuk pasqyrojne ne menyre korrekte kostot dhe investimet e kryera te operatoreve dhe per rrjedhoje nuk marrin parasysh as normen e kthimit te ketyre investimeve

Gjithashtu, implementimi i nje metodologjie per perlllogaritjen e kostove per tarifat e terminimit parashikohet ne legjislacionin rregullator perkates te BE, duke iu referuar pikes 2 te Rekomandimit te Komisionit European, date 7 Maj 2009 per trajtimin rregullator te tarifave te terminimit ne rrjete celulare dhe fikse ne BE, ne te cilen citohet se:

“2. It is recommended that the evaluation of efficient costs is based on current cost and the use of a bottom-up modelling approach using long-run incremental costs (LRIC) as the relevant cost methodology.”

Duke qene se aktualisht AKEP, ne Tetor 2018, ka percaktuar tarifat e terminimit te thirrjeve kombetare bazuar ne dokumentin final miratuar me Vendimin Nr.70 date 01.10.2018 per “Rregullimi i tarifave te Sipermarrësve me FNT ne tregjet me shumicë te terminimit te thirrjeve ne rrjetet celulare” per te tre operatoret celulare VDF, TA dhe Albtelecom, Telekom Albania gjykon qe glide-pathi ekzistues sipas ketij vendimi duhet te jete ne fuqi per nje periudhe dy vjecare deri ne raundin e ardhshem te analizes se tregut, sic percaktohet dhe ne nenet 31 pika 4 dhe 34 pika 1 te Ligjit nr.9918. Duhet nenvizuar se kjo eshte nje ceshtje shume e rendesishme, pasi bazuar ne kete glide-path operatoret kane pergatitur dhe pershtatur planet e tyre te biznesit dhe te investimeve gjate ketij harku kohor dhe nje rishikim tjetër i MTR-ve kombetare do te gjeneronte pasiguri dhe veshtiresi ne aktivitetin e tyre duke impaktuar negativisht cilesine e sherbimeve dhe produkteve te ofruara per perdoruesit fundore.

Ne keto kushte, Telekom Albania eshte i mendimit qe AKEP te lere ne fuqi tarifat e aktuale te terminimit te thirrjeve kombetare sipas glide-pathit ekzistues te percaktuar ne vendimet perkatese Nr.70, 71, 72 dhe 73, date 1.10.2018, deri ne arrijten e konkluzioneve te Modelit të Kostove sipas ekspertizes nderkombetare dhe të ndërmarrë korrigjimet e nevojshme pas konkluzioneve të modelit në fillim të vitit 2020, duke qene keshtu edhe edhe ne respektim te afatit dy vjeçar per zhvillimin e analizes se tregjeve, te percaktuar nga ligji.

Albtelecom

Ju lutem, referojuni qëndrimit të Albtelecom në seksionin B në komentet e përgjithshme të Albtelecom

Vodafone Albania

Ashtu si VA ka deklaruar gjithmonë, mënyra më e përshtatshme për të përcaktuar tarifat e terminimit është përmes një analize të bazuar në kosto dhe zhvillimit të metodologjisë përkatëse. Rrjedhimisht, AKEP duhet të zhvillojë një model të bazuar në kosto sipas veçorive dhe karakteristikave specifike të tregut shqiptar. Deri atëhere, jemi të mendimit se tarifat e terminimit duhet të qëndrojnë në nivelet e miratuara më 01.12.2018.

Siç është përmendur edhe më sipër (ju lutemi referojuni përgjigjes sonë nën pyetjen 2), përdorimi i tarifës mesatare si pikë referimi, sidomos duke pasur parasysh se tarifa më e lartë e vendosur përmes LRIC të Pastër (Pure-LRIC) është sa trefishi i tarifës më të ulët (Slllovakia 1,56 vs Malta 0.50), ekziston rreziku që tarifa e vendosur të jetë ose konsiderueshëm mbi kosto ose nën kosto.

Në këtë drejtim, duhet të theksohet se një çmim mbi kosto ka avantazhin e të qenit në favor të investimeve (*një çështje e rëndësishme në kuadër të zhvillimeve teknologjike - 5G etj - që do të kërkojnë investime*), e njëkohësisht nuk mund të interpretohet si një barrë e konsiderueshme për zhvillimin e tregut, pasi tarifatat për konsumatorin në Shqipëri janë ndër më të ulëtat në Evropë.

Në të kundërt, nëse tarifa e vendosur është nën kosto, kjo do të ndikojë padysim në ekonominë e tregut dhe do të pengojë zhvillimin. AKEP duhet gjithmonë të marrë në konsideratë ndikimin e tarifave dhe të ruajë ekuilibrin midis çdo reduktimi në tarifatat e terminimit dhe investimeve strategjike që garantojnë infrastrukturë më të mirë, inovacion dhe kohëzgjatje të zhvillimit.

Në këtë pikë, dëshirojmë të theksojmë se nëse AKEP aplikon tarifatat të ulëta të terminimit pa kryer analizën e duhur, kjo do të pengonte aftësinë e operatorëve për të ndërmarrë investime infrastrukturore dhe inovacione në të ardhmen. Duhet të theksohet se VA sapo ka investuar për blerjen e frekuencave në brezin 800 MHz (*801 - 811 MHz çiftuar me 842 - 852 MHz*) ndërkohë që është duke konsideruar gjithashtu investime të mëtejshme në spektrin 700 MHz dhe/ose 3.6 GHz që do të vihet në dispozicion në të ardhmen e afërt.

Qëndrimi i AKEP

AKEP vlerëson komentet e operatorëve të rrjeteve lidhur me këtë çështje se duhen pritur konkluzionet e Modelit të Kostove me ekspertizë ndërkombëtare pasi gjykon se vendimtarja e Këshillit Drejtues për MTR duhet të jetë e bazuar mbi metodologjinë më të efektshme të mundshme siç është ajo e Modelit të Kostove BULRAIC për të cilën ka kërkuar asistencë teknike nga kompani të njohura ndërkombëtare.


Në të njëjtën kohë AKEP sqaron se edhe metoda benchmark e përdorur nga AKEP ka qenë efektive në drejtim të reduktimit të përshkallëzuar të tarifave të terminimit mes operatorëve të rrjeteve celulare dhe e mbështetur në parashikimet e ligji “Për komunikimet elektronike në parashikon RSH”. Më konkretisht neni 57 parashikon se “Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

- a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
- b) tarifatat mesatare të vendeve të BE-së;
- c) tarifatat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;
- ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
- d) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

Sipas pikës 3 të nenit 57 të Ligjit “metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara”.

Nga të dhënat e përditësuara në janar 2019 të BEREC për tarifatat e terminimit në rrjetet celulare rezulton se janë përdorur kryesisht modelet e kostos BU-LRIC(24 vende) ndërkohë që edhe benchmark po për BU-LRIC është përdorur nga 6 vende.

Figure 15 Cost accounting models used by NRAs



Source: NRAs, BEREC

For further details, see [Annex 6](#).

4. Masa rregullatorë e barazimit të minutave dhe SMS brenda me jashtë rrjetit (on net of net) duhet të vazhdojë të zbatohet ndaj të tre operatorëve apo vetëm ndaj Vodafone Albania që zotëron fuqi të ndjeshme në tregjet me shumicë të akses-origjinimit dhe tregun e pakicës?

Komentet e palëve te interesuara dhe qëndrimi AKEP mbi masat rregullatore të mosdiskrimnimit (qe tarifat e thirrjeve me pakice te mos kene dallim on-net/off-net, dhe kjo përfshin jo vetem tarifat e paketave standarte por edhe oferta/promocionet, si dhe sasite e minutave te perfshira ne pagesa fikse/oferta) janë shqyrtuar edhe ne dokumentin e analizës së tregjeve përkatëse të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare përfshirë dhe tregun e shërbimeve celulare me pakicë.

5. Cili është opinioni juaj për opsionet e paraqitura nga AKEP për tregun e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare:

1.1 Përfshirja e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare), shpalljen FNT te të tre operatorëve dhe rregullimin e tarifave në mënyrë proporcionale me balancat in-out nga terminimi thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare:

- a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path);
- b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.

1.2 Me përkufizim si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje ex-ante dhe FNT:

- a) me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path);
- b) me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.

1.3 Lënie në de-rregullim siç është aktualisht.

1.4 Një version është edhe sipas vendimmarrjes së KD të datës 1 tetor 2018 me shpallje FNT të të tre operatorëve dhe vendosjen e dy masave rregullatorë: detyrime për transparencë dhe mos-diskriminim.

Autoriteti i Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës për sa më lart është shprehur dhe me shkresën Nr. 156/1, datë 17.05.2018 drejtuar AKEP. AK vlerëson se, AKEP duhet të adresojë në mënyrën e duhur shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto. Për këtë çështje të përdoren praktikatat më të mira të vendeve të BE që rregullimi/de-rregullimi t'i shërbejë rritjes së konkurrencës dhe uljes së tarifave.

Telekom Albania

Që nga data 01.09.2012, tregu i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është plotësisht i derregulluar me anë të vendimit të AKEP nr.2118 datë 04.07.2012, duke përfshirë heqjen e të gjitha detyrimeve përkatëse për operatorët celularë (dhënia e aksesit, kapacitetet e interkoneksionit, etj) si dhe negociimin mbi baza komerciale të tarifa të terminimit për thirrjet ndërkombëtare.

Tregu i terminimit të thirrjeve hyrese ndërkombëtare paraqet disa aspekte komplekse për shkak të dimensionit të tij gjeografik, që i kalon kufijtë e territorit të Republikës së Shqipërisë, duke qenë se realizimi i thirrjeve kryhet duke u origjinuar nga vende të tjera dhe terminuar në rrjetet e operatorëve vendas. Marrëdhëniet midis operatorëve vendas dhe të huaj mund të jenë direkte ose indirekte (nepërmjet tranzitimit të thirrjeve). Për këtë arsye dhe trajtimi rregullator për këtë treg është kompleks, pasi për të kryer një thirrje hyrese ndërkombëtare një operator vendas duhet të lidhë një marrëveshje interkoneksioni me një operator të huaj në rastin e një interkonektimi direkt të rrjeteve ose nepërmjet disa operatorëve (tranzitues ndërkombëtarë të thirrjeve) të cilët janë jashtë një juridiksionit të rregullimit në një vend përkatës dhe secili nga këta operatorë merr një tarifë tranzitimi për shërbimin e ofruar. Në këtë optikë, AKEP nuk ka kompetencën dhe juridiksionin për të nderhyrë në marrëdhëniet e operatorëve vendas me një operator që aktivitetin e tij e ka jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ky treg përben një treg me vete nga ai i terminimit të thirrjeve kombëtare pasi terminimi ndërkombëtar i thirrjeve shërben si input për operatorët në vendet e tjera (pra, për tregjet me pakicë në këto vende) dhe realizimi i këtyre thirrjeve sigurohet nga një marrëdhënie direkte midis dy operatorëve të huaj apo midis një tranzituesi ndërkombëtar dhe një operatori vendas duke e tranzituar me pas drejt rrjeteve përkatëse.

Edhe vete BE ka një qasje diferencuese në trajtimin midis thirrjeve të realizuara brenda vendeve anëtare të BE-së dhe thirrjeve të origjinuara jashtë BE-së e të terminuara në vendet e BE-së, duke vendosur nën rregullim thirrjet e realizuara brenda BE-së sipas Rregullores së BE-së 2018/1971, datë 11 Dhjetor 2018, të Parlamentit dhe Këshillit të Europës, dhe duke lënë jashtë rregullimit thirrjet e origjinuara jashtë BE-së apo të origjinuara nga BE dhe të terminuara në vendet e tjera jo anëtare të BE-së.

Gjithashtu, terminimi i thirrjeve nderkombetare eshte tashme i derregulluar pothuaj ne te gjitha vendet e rajonit (Serbi, Maqedoni e Veriut, Turqi, Mal i Zi, Kosove)³¹, dhe kuadri rregullator i BE-se³² parashikon vetem tarifat te terminimit nderkombetar te lidhura me trafikun e roamingut.

Ne kete kendveshtrim, situata ekzistuese e derregullimit te terminimit nderkombetar ne vendin tone eshte ne linje me praktikat rregullatore te vendeve te tjera te rajonit dhe te BE-se.

Nga ana e funksionimit, tregu i terminimit nderkombetar perben nje treg me vete te ndryshem nga tregu i terminimit te thirrjeve kombetare duke qene se terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare sherben si input per operatoret ne vende te tjera (tregjet me pakice ne keto vende) per te ofruar thirrje drejt abonenteve te ketij rrjeti, i cili sigurohet nga nje marredhenie direkte midis dy operatoreve te huaj apo midis nje tranzituesi nderkombetar dhe nje operatori vendas, duke i tranzituar keto thirrje me pas drejt rrjeteve perkatese, çka eshte trajtuar gjeresisht dhe ne Vendimin Nr.2118 date 04.07.2012.

Percaktimi i tregut te terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare duhet shqyrtuar nga ana e zevendesueshmerise se kerkeses dhe te ofertes. Ne anen e kerkeses, nen skemen CPP (calling party pays), nje tarife e larte apo e ulet terminimi per thirrjet hyrese nderkombetare nuk ndikon tek rrjeti i thirrur i perdoruesit fundor, pra tek konsumatori shqiptar. Por ka nje ndikim tek perdoruesit e huaj, pasi jane ata qe preken direkt nga nje tarife e tille larte, e cila eshte pjese e kosos ne percaktimin e tarifave me pakice.

Ne rastin e terminimit nderkombetar jane operatoret e huaj ata qe blejne terminimin tek nje operator vendas, gje qe perben nje kosto per thirrjet e origjinuara nga perdoruesit jashte territorit te Shqiperise, dhe nuk ndikojne tek perdoruesit vendas qe marrin nje thirrje te origjinuar nga nje vend tjetër.

Nga ana e ofertes, ne tregun e terminimit te thirrjeve nderkombetare gjate ketyre viteve evidentohet nje nivel i larte konkurrence ne ofrimin e sherbimeve te terminimit nderkombetar dhe te tranzitimit, pasi numri i tranzituesve nderkombetare per te lidhur kontrata direkte me operatoret vendas per ofrimin e sherbimeve ne tarifa mbi baza komerciale, eshte i madh.

Edhe pse terminimi i thirrjeve nderkombetare hyrese eshte nje treg ne te cilin operatoret kane pozita monopoliste ne rrjetet e tyre perkates, ka disa aspekte te ndryshme nga terminimi i thirrjeve kombetare, per shkak te dimensionit gjeografik dhe te ndikimit ne tregun celular me pakice. Eshte nje treg qe prek marredheniet midis operatoreve te dy vendeve te ndryshme, vende qe i nenshtrohen regjimeve rregullatore te ndryshme, çka prek edhe natyren se si jane percaktuar keto tarifa ne vendet perkatese. Prandaj dhe propozimi per FNT te operatoreve ne kete treg nuk eshte i mundshem per shkak te dimensionit qe i kalon kufijte territoriale te Shqiperise dhe per rrjedhoje edhe vete kompetencat e AKEP per rregullimin e marredhenive te paleve ne nje treg qe perfshin

³¹ Monitoring regulatory and market development for electronic communications and information society services in Enlargement Countries Report 4 February 2014, page 97:

³² Traffic originating abroad has been explicitly excluded from the scope of regulated call termination markets (both fixed and mobile) in all monitored countries, with the exception of Iceland where same termination rates apply to national and international traffic, and Croatia where since July 1, 2013 mobile termination rates for international calls are regulated subject to a separate glide path and are set to reach symmetry with national MTRs by January 1, 2015.

dhe autoritete rregullatore te vendeve me operatoret e te cileve operatoret shqiptare kane nenshkruar marreveshje per terminim nderkombetar apo tranzitim te thirrjeve.

- Niveli i konkurrences dhe maturimi ne tregun e telefonise celulare, ulja e vazhdueshme e treguesve financiare te operatoreve celulare, shkalla e larte e investimeve ne rrjet dhe ne teknologji, ulja e tarifave ne tregun me pakice, ka sjelle ulje te konsiderueshme te te ardhurave dhe fitimeve gjate ketyre viteve te fundit.
- Perfshirja e terminimit nderkombetar ne tregun e terminimit kombetar apo dhe opsioni si nje treg me vete por me barazim te MTR-ve kombetare dhe atyre nderkombetare, do te conte me tej ne rezultate mjaft negative direkte per financat e operatoreve dhe per rrjedhoje do te cenonte ne menyre indirekte dhe negative edhe buxhetin e shtetit,
- Renia e te ardhurave ne sektorin e komunikimeve elektronike dhe e fitimeve te kompanive celulare per shkak te rregullimit te terminimit nderkombetar dhe vendosjes se detyrimeve rregullatore perkatese do te rriste me shume kostot shtese, dhe do te ulte kapacitetet e ketyre kompanive per te investuar dhe per te punesuar punonjes.
- Rregullimi i MTR-ve nderkombetare nuk ka asnje efekt tek pajtimtaret e kompanive celulare vendase sepse thirrjet hyrese nuk tarifohen.
- Per shkak se terminimi nderkombetar realizohet nepermjet maredhenieve direkte apo operatoreve tranzitues nderkombetare, reduktimi i MTR-ve nderkombetare nuk mund te garanton qe kjo do te transmetohej ne reduktime te tarifave te thirrjeve ne Shqiperi. Ky reduktim i MTR-ve nderkombetare mund te shkoje si fitim i tepert per tranzituesit apo edhe per operatoret origjinues.
- Gjate viteve te fundit, shume vende te BE kane derregulluar MTR-te nderkombetare per vendet jashte BE/EEA.
- Terminimi i thirrjeve nderkombetare eshte tashme i derregulluar pothuajse ne te gjitha vendet e rajonit (Serbi, Maqedoni e Veriut, Turqi, Mal i Zi, Kosove).
- Ne kushtet kur Bashkimi European ka ndermarre hapa per derregullimin e MTR-ve nderkombetare, nese AKEP do te ndermerrte nje veprim te tille, ne do te gjendeshim perballe nje situate ku MTR-te nderkombetare te operatoreve celulare ne Shqiperi do te ishin te rregulluara dhe te njejta me tarifat kombetare, ndersa per trafikun dales nderkombetar operatoret celulare do te perballeshin me MTR te derregulluara te vendeve te Bashkimit European dhe te rajonit, duke i deyruar operatoret vendas te rrisin tarifat e shitjes me pakice. Impakti financiar i ketij rregullimi tek kompanite celulare do te ishte humbja e te ardhurave nga MTR-te nderkombetare dhe rritja e kostove per shkak te derregullimit te MTR-ve ne vendet e tjera me pasoja ne tarifat dhe financat e pajtimtareve shqiptare. Nderthurja e tyre çon ne reduktimin e metejshem te fitimeve te kompanive celulare, ne reduktimin e metejshem te kontributit te tyre ne buxhetin e shtetit sic eshte permendur edhe me lart, dhe ne pamundesi per investime te reja dhe punesim te punonjesve.

Eshte evidente se cfare impakti negativ pati rregullimi i MTR-ve nderkombetare gjate periudhes 2008-2012 ne tregun e komunikimeve celulare, si ne te ardhurat e kompanive ashtu edhe ne kontributin ne buxhetin e shtetit apo edhe ne investimet e kryera nga ana e operatoreve.

Persa parashtruar me siper, Telekom Albania vlereson qe opsioni 3 eshte alternativa e duhur dhe kerkon qe terminimi i thirrjeve nderkombetare te vazhdoje te jete i derregulluar plotesisht ashtu sic eshte operuar gjate ketyre viteve te fundit.

Albtelecom

Albtelecom gjen të pambështetur dhe kontradiktor argumentin e AKEP, paragrafi 174, fq. 53 e dokumentit të Analizës se “...bazuar në përfundimet e mësipërme dhe arsyetimin e Analizës së vitit 2018, në impaktin e tyre në të ardhurat e sipërmarrësve dhe si rrjedhim edhe në konkurrencë, si edhe bazuar në praktikën e ndjekur nga vendet e BEREC, AKEP propozon 4 alternativa kryesore për adresimin e problematikës së MTR ndërkombëtare”.

Së pari, konkludimet dhe propozimet në këtë dokument nuk mund të mbështeten në Analizën e mëparshme (Analiza e vitit 2018) për më tepër kur Analiza që ka trajtuar çështjen e rregullimit të trafikut ndërkombëtar është shfuqizuar nga vetë AKEP. Gjithashtu, edhe në aspekt të përcaktimeve të kuadrit rregullator, AKEP nuk mund të konkludojë me propozime në një dokument të publikuar për këshillim publik duke u bazuar në trajtimin e një çështjeje të caktuar nga një Analizë e mëparshme, por duhet të mbështetet në fakte dhe argumente të paraqitura në të njëjtin dokument ku janë dhënë edhe konkludimet e propozimet përkatëse.

Së dyti, edhe praktikata e ndjekura në vendet e BEREC, në këtë rast nuk janë aspak relevante për krahasim me rastin e Shqipërisë dhe për t`u bazuar në propozimet që paraqet AKEP, pasi theksojmë se edhe këto vende kanë rregulluar trafikun ndërkombëtar brenda Bashkimit European si shtete anëtare duke lënë plotësisht jashtë rregullimit trafikun që origjinohet nga vende të tjera të ndryshme nga vendet anëtare të BE-së. Edhe ato pak vende të tjera të BE-së që kanë rregulluar trafikun ndërkombëtar aplikojnë politika që nuk kanë asnjë lloj lidhje me opsionet e paraqitura nga AKEP (theksojmë këtu se edhe në këto raste diskutimi është për rregullimin e mënyrës së trajtimit të trafikut ndërkombëtar dhe jo të tarifës ndërkombëtare).

Së treti, AKEP vetë evidenton se rregullimi i trafikut ndërkombëtar ndikon në mënyrë të konsiderueshme të ardhurat e sipërmarrësve, ndërkohë që efektet e mundshme pozitive do të rezultonin vetëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndaj Albtelecom gjykon se çdo lloj opsioni që rezulton me ndikimin e të ardhurave të Albtelecom do të ishte i papranueshëm nga ana jonë dhe i pambështetur në objektivat rregullatore të përcaktuara në nenin 7 të Ligjit.

Ndërkohë, paraqesim dhe njëherë si shqetësim inkonsistencën e dokumentit edhe në lidhje me alternativat e paraqitura nga AKEP për trafikun ndërkombëtar (1, 2, 3 ,4) në referencë të paragrafit 174, fq. 53 të dokumentit të cilat nuk janë të njëjta me opsionet e paraqitura në pyetjet për këshillim publik (pyetja 5), fq.73. Veçanërisht kontradiktor është opsioni nr. 3 në referencë të paragrafit 174 i cili paraqet si alternativë “përkufizimi si tregje përkatës me vete i justifikueshëm për ndërhyrje

ex-ante” ndërkohë që alternativa nr.3 sipas Pyetjes nr. 5 është “lënie në derregullim sic është aktualisht”.

Ashtu siç kemi argumentuar më lart, në rrethanat aktuale të tregut, Albtelcom nuk sheh të nevojshme ndryshimin e regjimit rregullator për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, ndaj Albtelcom kërkon që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të vijojë të jetë i derregulluar.

Përveç argumenteve që ofron vetë legjislacioni dhe kuadri rregullator i BE-së, argumentet e parashtruara nga AKEP kundër rregullimit të trafikut ndërkombëtar, janë dukshëm më të mbështetur qoftë në kuadrin ligjor dhe rregullator qoftë, edhe në interesat e biznesit të sipërmarrësve krahasimisht me argumentet e listuara pro rregullimit të cilat në pjesën më të madhe të tyre i gjejmë të pambështetura.

Në përfundim të komenteve dhe qëndrimit tonë, në bazë të gjithë sa kemi parashtruar më lart, si dhe të gjitha gjetjeve dhe vlerësimeve të vetë AKEP në dokumentin e Analizës, propozojmë masat rregullatore dhe vlerat për tarifën e terminimit kombëtar, si më poshtë:

- (i) Heqjen e detyrimit të mos-diskriminimit të thirrjeve dhe SMS on-net/off-net për Albtelcom Mobile, dhe mbajtjen e tij për operatorët me fuqi dominante në treg;
- (ii) Vendosjen e tarifave të terminimit kombëtar të paktën për një periudhë 2-vjecare me përshkallëzimet përkatëse (sipas Tabelës nr.1), deri në një vendimmarrje të re të AKEP në Analizën e radhës, si më poshtë:

Në periudhën e parë të përshkallëzimit;

- tarifa e terminimit e Albtelcom të jetë 2.66 lekë/minutë, propozuar dhe nga vetë AKEP në dokumentin e mëparshëm të Analizës së tregut celular, dhe si një e drejtë që vetëm Albtelcom nuk e përfitoi duke i reduktuar tarifën e terminimit pa përshkallëzim, direkt nga 4 lekë/minutë në 1.48 lekë/minutë, duke e barazuar me dy operatorët dominantë. Ndërkohë që këtyre operatorëve iu dha e drejta e përshkallëzimit nga 4.57 lekë/min në 2.66 lekë/min dhe në 1.48 lekë/min.
- Telekom Albania 1.48 lekë/minutë,
- Vodafone Albania 1.22 lekë/minutë,

Periudhat në vijim sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr.1: Propozimi i Albtelcom për MTR-të e Operatorëve celularë

Operatori/ Periudha	01.08.2019 - 31.07.2020	01.08.2020- 31.07.2021	01.08.2021- (deri ne nje vendim tjeter te AKEP)
Albtelcom Mobile	2.66	1.48	1.22
Telekom Albania	1.48	1.22	1.11
Vodafone Albania	1.22	1.11	1.01

Note: Tarifën në lekë/min, pa TVSH

Dëshirojmë të vëmë në dukje se, vlerat e propozuara për tarifën e terminimit në tabelën e mësipërme janë vlera “benchmark” të vendeve të BEREC, të referuara nga vetë AKEP dhe të aplikuar në periudhat përkatëse për operatorët e rrjeteve celulare.

(iii) Mosndryshimin e Regjimit aktual rregullator për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, pra lënien në De-rregullim.

Vodafone Albania

VA pajtohet plotësisht me efektet negative të rregullimit të tarifave ndërkombëtare të terminimit celular të deklaruar nga AKEP në Dokumentin për Këshillim Publik.

VA gjykon se thirrjet hyrëse me origjinë ndërkombëtare që terminohen në rrjetet celulare duhet të lihen në de-rregullim, për arsyet e mëposhtme:

- Përfshirja e thirrjeve ndërkombëtare në tregun kombëtar të terminimit është vërtetuar se dëmton në mënyrë indirekte financat e vendit për shkak të zvogëlimit të të ardhurave që vijnë nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare;
- Së dyti, terminimi i thirrjeve ndërkombëtare negociohet drejtpërdrejt nga dhe ndërmjet operatorëve lokalë dhe bartësve ndërkombëtarë. Në këto marrëveshje reciproke, operatorët e huaj dhe lokalë ofrojnë mundësinë e terminimit të thirrjeve të tyre përkatëse në rrjetet celulare/fikse në vendin e tyre përkatës në botë me një çmim të paracaktuar. Në rast të ndërhyrjes së AKEP, ky i fundit do të rregullonte vetëm tarifën e një pale (operatorit lokal), ndërsa tarifa e zbatuar nga operatori i huaj do të lihej e parregulluar. Ky rregullim i njëanshëm nga AKEP do të shkaktonte pabarazi midis operatorëve shqiptarë dhe bartësve ndërkombëtarë dhe rrjedhimisht do të dëmtonte interesat e të parëve krahasuar me të fundit. Kjo do të vihej re sidomos për koston e terminimit në vendet e BE, rrjetet e të cilave faturojnë një tarifë disa herë më të lartë për thirrjet e origjinuara jashtë BE;
- Përveç kësaj, siç përmend edhe AKEP në Dokumentin për Këshillim Publik, reduktimi i tarifave të terminimit me shumë mundësi nuk do të pasqyrohet në reduktim të tarifave për thirrjet drejt Shqipërisë, dhe shtim të volumit të këtij trafiku, por shkon si fitim i tepërt për tranzituesit apo operatorët origjinues; si dhe në aplikimin nga operatorët ndërkombëtarë ose bartësit ndërkombëtarë të tarifave të terminimit për thirrje ndërkombëtare që janë më të larta se ato të terminimit për thirrjet kombëtare. Si rrjedhojë e sa më lartë, të ardhurat e operatorëve shqiptarë, buxheti i shtetit, si dhe tarifën e shërbimeve celulare me pakicë do të ndikohen negativisht nga ky ndryshim.

Qëndrimi i AKEP

Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka analizuar në mënyrë të plotë argumentet pro dhe kundër për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas disa varianteve të diskutuara për këshillim publik si (i) klasifikimi si treg nën rregullim me masat e mosdiskriminimit dhe transparencës, (ii) rregullimin e tarifës së terminimit ndërkombëtar mbi bazën e reciprocitetit, (iii) rregullimi tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare për të konverguar me tarifën e terminimit të brendshëm në rrjetet celulare nëpërmjet një glide path afatshkurtër dhe (iv) lënia e tregut në derregullim sipas praktikave të shumicës së vendeve antare të BE/BEREC.

AKEP pas analizës së faktorëve që ndikojnë në këtë treg dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian dhe qëndrimit të Operatorëve të Rrjeteve Celulare për shkak të zonës gjeografike të rregullimit jashtë territorit të RSH dhe me efekte negative të ardhurat e operatorëve dhe buxhetit të shtetit dhe pa efekte reale të çmimit me pakicë të shërbimeve të operatorëve celularë të përdoruesit e këtyre shërbimeve.

Lidhur me çështjen e subvencionimit të tërthortë të tarifave të ulta në tregjet me pakicë me të ardhurat nga termnimi ndërkombëtar, **AKEP** sqaron se analiza e sjelljes së operatorëve në treg është tashmë objekt i analizave ex-post nga Autoriteti i Konkurrencës. Kjo pasi me vendimin Nr. 9, datë 24.04.2020 – “Mbi përfundimet e arritura pas këshillimit publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi: (i) *“Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kriterëve të sanksionuar në pikën 4 të nenit 3 të Rregullores, në përfundim të analizës së tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave procedurale të parashikuara nga ligji 9918/2008” dhe Rregullorja 9/2009 dhe (ii) të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimit të testit të tre kriterëve, konform pikës 4 të nenit 5 të Rregullores.*

1.2 Komente të përgjithshme

Autoriteti i Konkurrencës

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës është shprehur me vendimin Nr. 634, Datë 04.07.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për këshillim publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”

Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:

1. Të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, për përcaktimin e ndërmarrjes me FNT në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
2. Vendosjen e masave rregullatore përkatëse duke vendosur edhe masën rregullatore të mos-diskriminimit të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (onnet/off-net rule) për operatorin që ka pozitë dominuese dhe heqjen e masës rregullatore të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net për operatorët që nuk kanë FNT në tregun me pakicë.
3. Shmangien e subvencionimit nga të ardhurat e realizuara në tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga operatorët me FNT në tregun e shitjes me pakicë, për aplikimin e tarifave nën kosto.

Telekom Albania

Shoqeria Telekom Albania vlerëson vendimin e AKEP për këshillimin publik “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”.

1. Terminimi i thirrjeve kombetare ne rrjetet celulare

- Deshirojme te nenvizojme faktin qe AKEP nuk eshte ne perputhje me afatet kohore per zhvillimin e analizes se tregut sic parashikohet ne nenin 34 pika 1 te ligjit 9918 per Komunikimet Elektronike, i ndryshuar, i cili parashikon kryerjen e analizes jo me pak se nje here ne dy vjet. Nderkohe AKEP ka realizuar analizen e tregut me shumice te terminimit te thirrjeve kombetare nje vit me pare, duke dale me vendimin final nr.11 date 22.02.2018 per percaktimin e TA, VDF dhe Albtelecom me FNT ne kete treg, si dhe Vendimin nr.70 date 1.10.2018 per percaktimin e periudhes se reduktimit gradual te MTR-ve kombetare.
- Ne kete keshillim publik AKEP ka propozuar perditimin e MTR-ve kombetare sipas metodologjise benchmark te vendeve te BE-se qe aplikojne modelin LRIC te paster me vlerat e MTR-ve sipas benchmarkut ne raportin e BEREC Korrik 2018, e cila con ne nje reduktim te metejshem te MTR-ve perkatese.
- Ne situaten kur AKEP brenda me pak se nje viti (Tetor 2018) ka percaktuar periudhen ekzistuese te reduktimit te MTR-ve kombetare, operatoret celulare kane pergatitur planet perkatese te biznesit ne perputhje me keto MTR qe nuk mund te rishikohen papritur, pasi cenohet siguria juridike ne te cilin ata operojne dhe per rrjedhoje kjo shkakton impakt negativ ne te ardhurat dhe aftesite e tyre financiare per te garantuar investime efikase dhe rentabel. Ndaj TA gjykon qe duhet te mbeten ne fuqi tarifat e terminimit per thirrjet kombetare të miratuara me datë 1.10.2018, deri ne momentin e konkluzioneve te Modelit të Kostove dhe rishikimet e nevojshme te kryhen pas konkluzioneve te modelit, ne fillim te vitit 2020.

2. Terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare ne rrjetet celulare

- Terminimi i thirrjeve hyrese nderkombetare eshte nje treg qe i kalon kufijte e nje vendi, shkon jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe karakterizohet nga nje marredhenie direkte ose indirekte (nepermjet tranzitimit) midis nje operatori vendas dhe nje operatori te huaj, ndaj AKEP nuk ka juridiksionin per te nderhyre ne marredheniet me nje operator qe aktivitetin e tij e zhvillon jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
- Terminimi i thirrjeve nderkombetare eshte i derregulluar plotesisht ne te gjitha vendet e BE-se dhe ne shumicen e vendeve te rajonit. Ai ndryshon nga terminimi i thirrjeve kombetare per shkak se kalon dimensionin territorial te nje vendi, si dhe nuk ndikon ne tregun celular me pakice. Per kete arsye nuk duhet te jete pjese e tregut per terminimin e thirrjeve kombetare, pasi ne te kundert kjo do te conte ne impakt negative mbi financat e operatoreve dhe per rrjedhoje impakton negativisht ne menyre indirekte edhe buxhetin e shtetit. Ndaj dhe nje nderhyrje per rregullim te terminimit nderkombetar dhe vendosjes se detyrimeve perkatese rregullatore do te rrise me shume kostot shtese dhe do te cenoje me teper te ardhurat dhe fitimet e operatoreve dhe per rrjedhoje edhe kapacitetet e tyre per te investuar dhe punesuar punonjes, si dhe indirekt buxhetin e shtetit. Prandaj, eshte e rendesishme qe ky treg te vazhdoje te jete teresisht i derregulluar.

- Bazuar ne sa me siper, TA gjykon qe terminimi i thirrjeve nderkombetare hyrese duhet te mbetet i derregulluar plotesisht sic eshte aktualisht qe nga viti 2012.

Albtelecom

Lidhur me dokumentin për këshillim publik “*Analizë tregu të telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.*” dhe propozimet dhe pyetjet e shtruara në këtë dokument/analizë, Albtelecom ju paraqet komentet dhe qëndrimin e tij, si më poshtë vijon;

Paraprakisht, Albtelecom dëshiron të shprehë në mënyrë të përmbledhur qëndrimin e tij në lidhje me:

A. Heqjen e masës rregullore të barazimit të minutave dhe SMS brenda me jashtë rrjetit (on-net/off-net) për Albtelecom dhe vijimin e kësaj mase rregullore vetëm për operatorin/ët me FNT, pra dominant.

B. Rishikimin e tarifave të terminimit kombëtare sipas alternativave të propozuara nga AKEP

Publikimi për këshillim publik i këtij dokumenti për analizën e tregut, po kryhet kur kanë kaluar vetëm 6 muaj nga miratimi i dokumentit më të fundit të analizës për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ku AKEP miratoi gjithashtu Vendimet përkatëse për secilin operator FNT në këtë treg duke vendosur në mënyrë të padrejtë tarifa simetrike të terminimit për të tre operatorët në kundërshtim të plotë me propozimin e gjetjet e vetë organit rregullator gjatë procesit të këshillimit publik (VKD nr. 70 -73 dt.01.10.2018).

Përcaktimi i tarifave sipas vendimeve të Tetorit 2018, u krye në inkonsistencë të plotë me gjetjet e vetë AKEP. Kundër këtij vendimi, Albtelecom ka paraqitur kundërshtimet e tij dhe pretendimet e tij duke ndjekur rrugën gjyqësore të kundërshtimit të aktit administrativ pikërisht për shkak të inkonsistencës së treguar nga AKEP në konkludimin final të vendimarrjes kundrejt argumentave të shtruara e të përdorura nga vetë AKEP dhe me propozimet e tij gjatë fazës së këshillimit publik.

Çështja gjyqësore është fituar tashmë në shkallën e parë të gjykimit ku Gjykata ka shfuqizuar Vendimin nr. 73 dt. 01.10.2018 për tarifën e terminimit të Albtelecom. Në vendimin e saj Gjykata ka njohur dhe ka pranuar pretendimet e Albtelecom se AKEP nuk është treguar konsistent në qëndrimet e tij në aktet e tij administrative duke cënuar kështu të drejtat dhe interesat legjitim të Albtelecom, dhe ka konkluduar se vendimi nr 73 nuk është një vendimarrje proporcionale dhe koherente me analizën e tregut, me nevojën e tregut dhe përfundimisht duke konkluduar se kjo vendimarrje e AKEP është marrë në kundërshtim me vetë Ligjin dhe duhet të shfuqizohet si e paligjshme.

Në këto rrethana, Albtelecom do të mirëkuptonte pozicionin se analizimi sërish në një kohë kaq të shkurtër të tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, do të përbënte një mundësi për reflektim nga ana e AKEP, për të korrigjuar vendimarrjen më të fundit të tij në lidhje

me tarifatat e terminimit të operatorëve celularë, në frymën e propozimit të AKEP, në procesin e këshillimit publik të Shkurtit 2018 dhe vendimit të Gjykatës. , Por edhe në këtë proces analize, bazuar në vetë gjetjet e AKEP, rishikimi i tarifave të terminimit për thirrjet kombëtare duhet të kryhet në raport me pjesët e tregut të operatorit më të vogël Albtelcom, në asimetri me operatorët dominantë në treg dhe në reflektim edhe të arsytimit të Vendimit të Gjykatës kundër Vendimit të AKEP nr. 73 dt.01.10.2018.

Çdo lloj vendimi tjetër që nuk orienton proporcionalisht me pozitën tarifave të terminimit për operatorin më të vogël Albtelcom në raport me pjesët e tij të tregut dhe në asimetri me operatorët dominantë, e konsiderojmë të pabazuar dhe të pajustificuar në kuptim të përcaktimeve të Ligjit dhe kuadrit rregullator.

Kështu, sjellim në vëmendje se AKEP citon në dokumentin për këshillim publik se *“synimi kresor i rregullatorit është që të evidentojë dhe t`i përgjigjet pyetjes nëse në treg ekziston, pra ka ose jo konkurrenca/ë efektive”*. Por, ndërsa vetë AKEP evidenton përkeqësimin e të gjithë treguesve të tregut dhe rritjen e përqëndrimit të tregut në dëm të konkurrencës efektive, propozimet për mënyrën dhe vlerat e rishikimit të MTR-ve që vetë AKEP parashtron pas të gjitha ketyre evidentimeve dhe fakteve objektive të përkeqësimit të tregut, nuk janë në vlerat e duhura për të nxitur konkurrencën eficientë dhe për të frenuar rritjen e përqëndrimit në treg. Në fakt, krijohet perceptimi se propozimet e AKEP kanë për qëllim thjesht reduktimin e tarifave të terminimit, fenomen ky që ndikon negativisht treguesit e operatorëve dhe jo korigjimin e masave rregullatore të ndërmarra deri tan, për mënjanimin e deformimeve serioze në këto pjesë të tregut të shërbimeve celulare.

Ashtu siç vetë AKEP ka evidentuar në dokument, praktikatat europiane njohin raste të aplikimit të tarifave të terminimit të diferencuara për operatorë të ndryshëm, varësisht problematikës që ka cuar drejt një vendimi të tillë. Kështu që, Albtelcom sheh plotësisht të mundshme nga ana e AKEP rishikimin e MTR-ve për Albtelcom si operatori më i vogël në treg, në asimetri me operatorët dominantë, për të adresuar problematikatat e mëdha që nuk po arrijnë të adresohen siç duhet ndër vite në tregun celular. Kjo qasje është në përputhje të plotë me vetë qëndrimin e AKEP në këtë dokument dhe në dokumente të tjera të analizave të tregut ku ai shprehet se *“...diskutimi për asimetrinë e MTR dhe lidhjen me pjesët e tregut apo faktorë të tjerë që ndikojnë në racionalitetin e vendosjes së asimetrisë/simetrisë së MTR rezultojnë se është specifik për çdo vend dhe varet nga një sërë faktorësh të cituar edhe nga ERG (sot BEREK) në dokumentin ERG’s Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates, ERG (07) 83 final 080312.”*

Madje, vetë AKEP parashtron një sërë faktesh dhe rrethanash objektive si ato të renditura edhe më poshtë, se impakti i masave rregulluese, përfshirë nivelet e MTR nuk rezultojnë se kanë dhënë efekte në pjesët e tregut të operatorit më të madh në treg Vodafone, duke cuar në rritje të theksuar për të gjithë treguesit e HHI (veçanërisht kjo e theksuar gjatë vitit 2018).

Pra, në kuptimin e Albtelcom, megjithëse AKEP me Vendimet e Tetorit 2018, reduktoi tarifatat e terminimit në simetri për të tre operatorët celularë, treguesit e tregut tregojnë se kjo masë

rregullatore nuk ka qenë eficiente dhe nuk ka prodhuar asnjë efekt korigjues në uljen e dominancës për operatorin më të madh në treg Vodafone Albania.

Siç edhe vetë ka vlerësuar AKEP në dokumentin e Analizës:

- niveli i treguesve të ARPU dhe ARPM për Shqipërinë janë shumë të ulët se niveli mesatar në vëndet e BE-së dhe kësisoj ndër më të ultit në rajon. Konkretisht, ARPU në vitin 2017 në Shqipëri ishte 38 euro/vit, që është 23% më e ulët se ARPU e Rumanisë që ka nivelin më të ulët në BE me 46 euro. Niveli mesatar i ARPU në BE në 2016 ishte rreth 163 euro apo rreth 4 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2016. (dokumenti i Analizës, paragrafi 130).
- efektet negative si rezultat i mungesës së asimetrisë në vlerat e duhura apo në kohën e duhur për Albtelecom
- AKEP njih dhe pranon (*po në këtë dokument, në paragrafin 187, pika 7*), se impakti i masave rregulluese, përfshirë nivelet e MTR nuk rezulton se kanë dhënë efekte në pjesët e tregut të operatorit më të madh në treg Vodafone Albania duke cuar në rritje të theksuar për të gjithë treguesit e HHI (sidomos gjatë vitit 2018).

në gjykimin e Albtelecom, këto fakte dhe të tjera të evidentuara përgjatë vetë dokumentit të Analizës së AKEP, janë pikërisht racionaliteti specifik për rastin e Shqipërisë për përcaktimin e MTR-ve për trafikun kombëtar për operatorin më të vogël Albtelecom, në raport me pjesët e tij të tregut dhe në asimetri me operatorët dominantë në treg, në linjë gjithashtu edhe me propozimin e vetë AKEP në dokumentin për këshillim publik në Shkurt 2018. Kjo do të ishte masa rregullatore që do të shërbente , për t'i dhënë mundësinë Albtelecom-it për shtimin e presionit konkures ndaj operatorëve dominantë në treg dhe rritjen e konkurencës efektive

Albtelecom risjell gjithashtu në vëmendjen e AKEP se përgjatë argumentimit dhe konkludimit me propozimin e tij (të AKEP) në dokumentin për këshillim publik në Shkurt 2018, për nivelin e MTR dhe asimetrinë e tarifave të terminimit celular, AKEP e ka vlerësuar propozimin e tij si të bazuar në praktikat më të mira europiane dhe në Rekomandimet e BEREC (ERG).

Ndërkohë, lidhur me propozimin e AKEP për rishikimin e MTR-ve duke e lidhur me pjesët e tregut në terma trafiku, i cili përafrohet me qëndrimin e Albtelecom në lidhje me rishikimin e MTR-ve mbi bazën e pjesëve të tregut, Albtelecom thekson se do të mund ta konsiderojë si një gjetje/propozim pozitiv apo të pranueshëm, vetëm nëse referenca për përcaktimin e MTR-ve proporcionale sipas pjesëve të tregut, do të aplikohet vetëm për MTR-në e trafikut kombëtar.

Ndërsa në lidhje me përfshirjen e thirrjeve ndërkombëtare në përcaktimin e një MTR-je të përbashkët për trafikun kombëtar dhe atë ndërkombëtar, Albtelecom shpreh kundërshtimin e tij duke gjykuar si të pambështetur këtë propozim të AKEP si në aspekt të kuadrit rregullator ashtu edhe në terma të interesave të biznesit.

C. Opsionet e propozuara nga AKEP për tregun e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare

Në rrethanat aktuale të tregut, Altelecom nuk sheh të nevojshme ndryshimin e regjimit rregullator për thirrjet hyrëse ndërkombëtare. Kështu që Altelecom gjykon se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare duhet të vijojë të jetë i derregulluar.

Madje, theksojmë se ashtu siç vetë AKEP ka argumentuar në dokumentin e këshillimit publik, rregullimi i MTR-së për trafikun hyrës ndërkombëtar jo vetëm që ndikon negativisht të ardhurat e operatorëve (të cilat gjithsesi përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave në totalin e tyre nga terminimi për thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare), por gjithashtu ndikon negativisht edhe të ardhurat për buxhetin e shtetit.

Për ndonjë rast specifik, ekzistojnë instrumenta të mjaftueshëm ligjorë për të adresuar ndonjë problematikë të mundshme, që do të mund të ndodhte në treg. *(sic ishte rasti i çështjes së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare drejt numrave të portuar, e cila ndonëse tregu është i derregulluar, u gjet mundësia e një zgjidhjeje të përbashkët rregullatore për shqetësimin e operatorëve, e cila aktualisht është funksionale dhe në zbatim).*

Ndërkohë, lidhur me propozimin sipas alternativës 4 “...sipas vendimarrjes së KD të datës 1 tetor 2018... vendosjen e dy masave rregullatore: detyrime për transparencë dhe mos-diskriminim...”, Altelecom gjykon të pavend nga ana e AKEP risjelljen e diskutimit në industri të një propozimi të miratuar dhe më pas të shfuqizuar pa arsye të qarta nga vetë AKEP. Altelecom nuk arrin të kuptojë këndvështrimin e AKEP kur shtron sërish këtë alternativë përballë operatorëve, në rrethanat që tashmë u provua që një vendim i tillë nuk mundi të implementohej në industri apo për shkaqet që arsyetoi vetë AKEP në shfuqizimin e këtij vendimi. Prandaj, edhe ky propozim rishtas nga AKEP, tregon edhe njëherë për inkonsistencën e AKEP në qasjet e tij të rregullimit të tregut të komunikimeve elektronike.

D. Inkonsistenca në argumentet dhe konkludimet e AKEP mbi çështjet e trajtuara

Ndërkohë që inkonsistenca në qëndrimet e AKEP në akte të ndryshme administrative është edhe objekti kryesor i çështjes së ngritur nga Altelecom në padinë kundër aktit administrativ të AKEP – Vendimit nr.73 dt. 01.10.2018, i cili u konsiderua si i paligjshëm edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Altelecom vëren me shqetësim se edhe ky dokument është inkohorent në trajtimin e çështjeve të ndryshme, ku pavarësisht nga sa argumentohet apo evidentohet me tregues të tregut, konkludimi me propozimet e AKEP është në kundërshtim me sa është parashtruar me fakte dhe argumenta. Gjithashtu, evidentohen raste ku pavarësisht se fillon të argumentohet për një çështje, nuk konkludohet më tej në lidhje me gjetjet që vetë AKEP ka evidentuar duke lënë të pa plotë trajtimin e tyre.

Gjithashtu, Altelecom beson se rishikimi i analizës së tregut në këtë moment kryhet nën rrethanat e përkeqësimit të të gjithë treguesve të tregut, çka në kuptimi të nenit 37 të Ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përbën ndryshim të fakteve që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe analizën e tregjeve

ne Tetor 2018, nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, dhe si të tilla duhet të rishikohen përfundimet dhe vendimet përkatëse.

Por, ndryshe nga sa parashtrohet në këtë rishikim të analizës së tregut dhe pavarësisht parashtrimit të fakteve të përkeqësimit të të gjithë treguesve të tregut, sërish në inkonsistencë me vetë gjetjet e tij, propozimet që konkludon AKEP në këtë analizë, nuk gjejnë mbështetje në argumentet dhe gjetjet e referuara nga vetë ai. Përkundrazi, propozimet për rishikimet e tarifave të terminimit kufizohen përsëri vetëm thjesht në reduktimin e tarifave të terminimit në të njëjtin nivel për të tre operatorët celularë, dhe të cilat nuk përbëjnë asnjë ndryshim, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37 të Lijgit, të masave rregullatore të përcaktuara nga Vendimet e Tetorit 2018.

Për sa më sipër, Altelecom thekson se AKEP duhet të ruajë konsistencën në qëndrimin e tij në këtë dokument analize, duke rishikuar masat rregullatore në tregun e shumicës në raport me problemin e identifikuar, për përcaktimin e tarifave të MTR-ve asimetrike, për të adresuar kështu ndryshimin e fakteve që justifikuan vendimmarrjen e Tetorit 2018 për tarifatat aktuale në fuqi të MTR-ve. Në të kundërt, çdo lloj mase tjetër nuk do të ishte e justifikueshme apo e mjaftueshme për adresimin e problematikave të tregut celular dhe shtimin e presionit konkurrues ndaj operatorëve dominantë, për të mundësuar kështu në finale, përmirësimin e treguesve të tregut, uljen e përqëndrimit në treg, dhe rritjen e aftësisë konkurruese në përfitim të përdoruesit fundorë.

Neofone Shpk

I. Rrethanat Faktike

AKEP, me VKD nr. 10 dhe VKD nr. 11, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar (Ligji nr.99J8) ka miratuar për këshillim publik dokumentet "Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare "(VKD nr. 10) dhe "ANALIZË E TREGUT TE SHERBIMEVE CELULARE - tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit në rrjetet celulare Dokument për këshillim publik" (VKD nr. 11).

Këto akte administrative të AKEP përbëjnë interes jetik për subjektin Neofone sh.p.k. lidhur me ushtrimin e veprimtarisë si subjekt i regjistruar në AKEP në regjistrin e sipërmarrësve me numër 140 për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm , përfshirë shërbimet e mëposhtme:

- ***Tranzit Kombëtar***
- ***Tranzit Ndërkombëtar***
- ***Telefoni Publike***

pasi mbi bazën e përfundimeve dhe masave rregullatore të vendosura nga AKEP për tre operatorët celularë, Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom, të vlerësuar dhe me FNT në tregun përkatës të "Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare", përcaktohet mundësia e ushtrimit normal të veprimtarisë për të cilën Neofone është autorizuar të zhvillojë, në përputhje me kushtet ligjore sipas ligjit nr. 9918 dhe kuadrin rregullator në fuqi, si garant të sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike.

Ushtrimi nga sipërmarrësi Neofone (si dhe çdo sipërmarrës tjetër) i veprimtarisë së autorizuar nga AKEP për ofrimin e shërbimit të "Tranzitit Ndërkombëtar", për të terminuar thirrjet ndërkombëtare drejt abonenteve të rrjeteve celulare Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, realizohet mbi bazën e marrëveshjeve të aksesit dhe interkoneksionit (MI) të lidhura midis Neofone dhe secilit nga operatorët që ofrojnë njetet dhe shërbimet e telefonisë celulare. Element bazë dhe themelor për arritjen e MI është tarifa e terminimit për thirrjet ndërkombëtare që ofron secili nga këta operatorë për rrjetet respektive.

Për shkak të rregullave të vendosura nga AKEP sipas analizës së tregut celular paraardhëse, dhe praktikave të zbatuara nga operatorët celulare për përcaktimin e tarifave të thirrjeve ndërkombëtare në kushtet e liberalizimit të tregut përkatës të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe sipas kriterit të interesit komercial të operatorëve celulare Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, ka bërë që Neofone të jetë në një situatë pamundësie për ushtrimin e kësaj veprimtarie që prej vitit 2015 si dhe në mosmarrëveshje historike me të tre këta operatorë dhe AKEP-in si organi rregullator kompetent. Mosmarrëveshjet tashmë janë në proces shqyrtimi gjyqësor mbi bazën e padive të ngritura nga Neofone në adresë të operatorëve celularë dhe AKEP si dhe palë të tretë Autoritetin e Konkurrencës.

Në këto procese gjyqësore, Neofone shpk ka kundërshtuar vendosjen e kushteve të padrejta të tregëtimit për shërbimin e tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare nga sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a , Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom sh.a të cilat në kundërshtim me ligjin kanë aplikuar tarifa të njëanshme për terminimin e këtyre thirrjeve disa herë më të larta se kosto, të cilat nuk kanë qënë produkt negociatash dypalëshe dhe nuk kanë përmbushur detyrimin për interes komercial dypalësh.

Neofone ka arsyetuar se AKEP nuk është shprehur asnjëherë se tarifa vendoset në mënyrë të njëanshme nga Vodafone Albania sh.a , Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom Sh.a.. Ky arsyetim i Neofone mbështetet edhe në Vendimet e Gjykatës Europiane për aksesin edhe interkoneksionin edhe është në shkelje të Nenit 102 TFEU (adoptuar në Nenin 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës").

Interesi komercial nuk nënkupton mosparaqitjen e ofertës dhe as dhënien e një oferte me tarifë e cila të mos lejojë palën tjetër që të ushtrojë veprimtarinë. Interesi komercial i njohur dhe vendosur nga AKEP si kriter për arritjen e marrëveshjes, nënkupton që kjo tarifë përjashtimisht nga çfarë parashikon L/9918 që tarifat si ato të shumicës ashtu dhe ato të pakicës duhet të jenë të orientuara drejt koston, lejon një normë fitimi me interes komerciale por që në asnjë rast nuk mund të jetë bllokuese për palën tjetër. Nëse kjo ndodh, atëhere kjo do të çonte në një treg përkatës monopol dhe do të përbënte abuzim me pozitën dominuese në treg të këtyre sipërmarrësve.

Gjithashtu nga ana e Neofone shpk, është kërkuar gjithmonë me ankime dhe kërkesë padi në gjykatë që AKEP nuk mund të refuzojë ushtrimin e një kompetence ligjore të sanksionuar me ligj për fillimin e shqyrtimit të ankimit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis dy sipërmarrësve me justifikimin se tregu për të cilin sipërmarrësit Neofone shpk me Vodafone Albania sh.a , Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom Sh.a., është një treg plotësisht i parregulluar nga AKEP dhe se palët mund të arrijnë në marrëveshje mbi baza komerciale.

AKEP në këto procese është shprehur se e ka derregulluar tregun e thirrjeve ndërkombëtare edhe se e ka përjashtuar veten nga kompetenca ligjore për të trajtuar mosmarrëveshjet e Neofone me sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a , Telekom Albania sh.a dhe Albtelecom.

Neofone ka parashtruar se AKEP duhet të sigurojë ushtrimin e të drejtave dhe të detyrimeve ligjore lidhur me aksesin dhe interkoneksionin për të siguruar jo vetëm komunikimin e përdoruesve, por edhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve në të gjithë komunitetin, pa dallim shtrirje gjeografike.

Neni 47 i ligjit nr. 9918 e përmban qartazi dhe pa ekuivoqe rregullimin ligjor për këtë marrëdhënie. Në nenin 91 të ligjit nr. 9918 përcaktohet: *"Rrjeti i komunikimeve elektronike publike ndërtohet për të mbështetur shërbimet e komunikimeve elektronike publike dhe funksionin si rrjet mbarëkombëtar, pa dallim. për të gjithë përdoruesit, i hapur për të gjithë sipërmarrësit dhe i integruar në rrjetin ndërkombëtar, në përputhje me standardet ndërkombëtare"*.

AKEP dispononte kompetencën dhe tagrin ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çeshtjen për të cilën palët janë në mosmarrëveshje, i cili në çdo rast duhet t'i nënshtrohet procedurës së përcaktuar në nenin 120 të L/9918, por ndodhur para faktit që nuk kemi gjetur zgjidhje pranë AKEP, jemi drejtuar Autoritetit të Konkurrencës ndërmjet ankesës për zgjidhjen e diskriminimit që i është bërë Neofone shpk.

Nga sa thamë e sipër, duke qënë se qendrimi i mbajtur nga AKEP si organ kompetent për shqyrtimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes për mos ushtrimin e kësaj kompetence dhe detyrimi ligjor ka çuar, për rrjedhojë në lejimin e sjelljes antiligjore, abuzive dhe antikonkurrese të sipërmarrëseve, fakt i cili është i vërtetuar tashme. Nisur nga këto rrethana AKEP duhet të vendosi nën rregullim terminimin e thirrjeve ndërkombëtare me MTR të njëjtë si thirrjet kombëtare.

Neofone konstaton se dy aktet e reja VKD nr. 10 dhe VKD nr. 11 të publikuara për Këshillim Publik përveç disa ndryshimeve strukturore që janë ndarë në dy dokumente, përmbajnë të njëjtin arsyetim, *ratione materia* me Analizën e Tregut të Miratuar me VKD nr.78' dhe të shfuqizuar me VKD nr.89.

Në këndvështrimin e Neofone, Analiza e Tregut e kryer nga AKEP është një material shumë voluminoz nga pikpamja teorike e bazës ligjore por mungojnë statistikat, analizat individuale të detajuara për çdo shërbim, sipërmarrësit, proceset administrative dhe ligjore, bashkëpunimi i AKEP me Autoritetin e Konkurrencës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

AKEP në dokumentin e Analizës së Tregut nuk përmend asnjë proceset ligjore me subjektin Neofone edhe subjekte të tjera, e sidomos procesin ligjor i cili është në shqyrtim nga Gjykata e Apelit, proces në të cilin AKEP nuk solli asnjë fakt apo arsye se pse e shfuqizoi Analizën e mëparshme. Në këtë proces të Neofone kërkesë padia e Neofone nuk u pranua por Neofone fitoi të drejtën për dëmshpërblim sipas Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative pasi akti i rrëzuar nga AKEP ishte i ligjshëm.

E vetmja arsye shfuqizimi e përdorur nga AKEP në VKD nr.89 për Analizën Paraardhëse (VKD nr.78) ishte arsyetimi se AKEP do të kryente një Analizë të re në bashkëpunim me BE.

Në VKD nr.89 tek dispozitivi AKEP shprehet se (fq.4) *VENDOSI... nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse referuar sa më lart, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri të plote të legjislacionit të Bashkimit Evropian. 7. AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Evropian për të përfutuar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces.*

Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare

Neofone ka kërkuar që Analiza e tregut të shërbimeve celulare për tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile të kryhej pa diskriminuar nga origjina e si pasojë Neofone ka depozituar Ankime Administrative për Vendimet Nr. 11, 12, 13, 14 datë 22.02.2018 të KD të AKEP.

Në vazhdim të arsytimit tonë se AKEP ka nisur një procedurë diskriminuese për terminimin e trafikut ndërkombëtar në rrjetet mobile pasi ka publikuar për konsultim publik dy Analiza të ndryshme ku në të parën trajton trafikun kombëtar pa ofruar alternativa edhe duke përcaktuar qartazi detyrimet FNT për të tre operatorët mobile, ndërkohë në Analizën për terminimin e trafikut ndërkombëtar trajtimi është i ndryshëm duke ofruar alternativa për mënyrën e trajtimit të këtij trafiku. Trajtimi i trafikut me origjinë ndërkombëtare ndryshe nga ai me origjinë kombëtare përbën diskriminim të trafikut sipas origjinës, praktike kjo e trajtuar gjerësisht nga KE dhe BEREC si antikorrupsion edhe për më tepër ndarja e trafikut sipas origjinës është një lloj trajtimi i pa aplikuar në asnjë vend të zhvilluar europian.

Në lidhje me Argumentat Pro Rregullimit, Neofone është plotësisht dakort me AKEP pasi janë në frymë edhe gërmë të Direktivave të BE edhe Ligjit Nr. 9918.

Ndërsa për sa i përket Argumentave kundër të trajtuara nga AKEP, ato janë të pabazuara ligjërisht dhe gjithashtu të pavërtetuara si me poshtë :

Argumenta kundër

4. Reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet celulare ka mundësi të mos transmetohet në reduktime të tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, por vetëm shkon si fitim i tepërt për tranzituesit apo operatorët origjinues;

Komenti i Neofone: "Reduktimi i tarifës" është terminologji e pabazuar ligjërisht pasi Ligji Nr. 9918 përdor termin "orientim në kosto" i cili nënkupton krijimin e kushteve për konkurrencë midis operatorëve vendas. Tarifa e thirrjeve drejt Shqipërisë në një treg në konkurrencë vendoset nga bashkëveprimi i kërkesë-ofertes. AKEP ka për detyrë të garantojë tregje konkurrues edhe jo të reduktojë tarifën në vetvete. Arsyetimi me sipër është jashtë kërkesave të Ligjit Nr.9918 dhe i panevojshëm.

5. Reduktimi i cilësisë së thirrjeve në rrjetet celulare apo edhe fikse për shkak të përdorimit në masë të madhe të VoIP me cilësi jo të lartë;

Komenti i Neofone: Si pasojë e tarifave të larta edhe mungesës së ofertës për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare është shtuar sasia e trafikut e terminuar Non-CLI duke ulur ndjeshëm kualitetin e thirrjeve. Argumenti i AKEP është i pavërtetuar edhe tërësisht subjektiv pasi AKEP nuk ka kryer asnjë studim apo matje të paramterave të cilësisë së VoIP edhe të raporteve të trafikut që terminohet me teknologjinë VoIP kundrejt trafikut me qarqe El në rastin kur kemi de-rregullim apo rregullim të tregut të trafikut ndërkombëtar.

6. Efekte negative të konsidereueshme direkt në të ardhurat e operatorëve celulare dhe indirekt në buxhetin e shtetit, por edhe në tarifën me pakicë të shërbimeve celulare (ëaterbed effect);

Komenti i Neofone: Arsyetim pjesërisht i gabuar. Po ka ndikim në të ardhurat e operatorëve monopoliste celulare, por jo në buxhetin e shtetit. Por gjithashtu ka ndikim edhe në të ardhurat e operatorëve tranzitues. Në lidhje me të ardhurat në buxhetin e shtetit arsyetimi i AKEP është i gabuar pasi më poshtë po bëjmë një llogaritje të thjeshtë të të ardhurave në buxhetin e shtetit nga

trafiku ndërkombëtar, arsyetim të cilin e kemi depozituar edhe në ankimet administrative për Vendimet Nr. 11,12,13,14 datë 22.02.2018 të KD të AKEP.

Rasti i Parë - Terminimi Ndërkombëtar është i De-Rregulluar:

Supozojmë se tarifa e shitjes nga operatori mobil X është 40 Lek/min..

Operatori Mobil X e ka koston 1.48 Lek/min.

Shërbimi i i trafikut ndërkombëtar është eksport edhe si i tillë nuk aplikohet TVSH pasi marrësi i shërbimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas parimit CPP.

Operatori Mobil X i paguan shtetit Shqiptar 15 % të tatim fitimit për minutë të cilin është :

$$0.15 * (40 - 1.48) = 5.778 \text{ Lek}$$

Rasti i Dytë - Terminimi Ndërkombëtar është i Rregulluar:

Supozojmë se tarifa e shitjes nga operatori mobil X është 40 Lek/min drejt operatorëve ndërkombëtarë.

Ndërkohë operatori Mobil X i ofron shërbimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare operatorit tranzitues Y në kosto me vlerën 1,48 Lek/min.

Supozojmë se tarifa e shitjes nga operatori tranzitues Y drejt operatorëve të huaj është 40 Lek/min.

Meqënëse Shërbimi i trafikut Ndërkombëtar është eksport nuk aplikohet TVSH për segmentin ndërkombëtar.

Ndërkohë për segmentin kombëtar aplikohet TVSH.

Operatori Mobil X lëshon një faturë në drejtim të operatorit Tranzitues Y së bashku me vlerën e TVSH:

$$1.48 + 1.48 * 0.2 = 1.776$$

Operatori Tranzitues i krediton shtetit TVSH të rimbursueshme, ndërkohë që në rastin e parë kjo TVSH nuk kreditohet.

Ndërkohë operatori Tranzitues paguan Tatim mbi Fitimin

$$0.15 * (40 - 1.48) = 5.778 \text{ Lek}$$

Pra në rastin e dytë shteti shqiptar merr të njëjtën pagesë për minutë si në rastin e parë, edhe për më tepër i kreditohet shtetit edhe TVSH. Nëse AKEP i referohet faktit që si pasojë e prezencës së operatorëve konkurrente operatori Mobil X do të ulte tarifën me dëshirën e vet, atëherë do të ishte absurde që AKEP të promovojë tarifa abuzive edhe jo eficiente në drejtim të abonentëve të huaj pasi kjo do të shkelte rëndë parimin e proporcionalitetit.

Qëndrimi i AKEP

Bazuar në komentet e përgjithshme të paraqitura nga palët e interesuara, AKEP sqaron se në analizën e dokumentit përfundimtar “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të*

terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare” është mbështetur në legjislacionin primar dhe sekondar të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, ka marrë në konsideratë praktikën më të mirë të aplikuar nga vendet BEREC dhe BE, ka bashkëpunuar me palët e interesuara dhe më gjerë, si edhe praktikën dhe analizat e tregut të kryera nga AKEP në periudhat e kaluara.

Gjithashtu, AKEP sqaron se ashtu siç është trajtuar në analizën e mësipërmë, bazuar në praktikën ndërkombëtare dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, entet rregullatore të fushës së komunikimeve elektronike duhet të aplikojnë tarifave simetrike për operatorët e që ofrojnë shërbimet të telefonisë fikse dhe asaj celulare.

Masat rregullatore të AKEP, përfshirë dhe rregullimin e tarifave janë në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar të komunikimeve elektronike dhe postare dhe kuadrin rregullator të vendeve antare të Bashkimit Evropian dhe BEREC.

AKEP ka në qendër të vendimmarrjes së tij funksionimin e konkurrencës në tregjet e rregulluara ku evidentohen sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg dhe bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe eficensës së tregjeve e ka mbështetur vendimmarrjen e tij në përfitim të konsumatorëve të shërbimeve celulare.

Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka analizuar në mënyrë të plotë argumentet pro dhe kundër për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas disa varianteve të diskutuara për këshillim publik si (i) klasifikimi si treg nën rregullim me masat e mosdiskriminimit dhe transparencës, (ii) rregullimin e tarifës së terminimit ndërkombëtar mbi bazën e reciprocitetit, (iii) rregullimi tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare për të konverguar me tarifën e terminimit të brendshëm në rrjetet celulare nëpërmjet një glide path afatshkurtër dhe (iv) lënia e tregut në derregullim sipas praktikave të shumicës së vendeve antare të BE/BEREC.

AKEP pas analizës së faktorëve që ndikojnë në këtë treg dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian dhe qëndrimin të Operatorëve të Rrjeteve Celulare për shkak të zonës gjeografike të rregullimit jashtë territorit të RSH dhe me efekte negative të ardhurat e operatorëve dhe buxhetit të shtetit dhe pa efekte reale të çmimit me pakicë të shërbimeve të operatorëve celularë të përdoruesit e këtyre shërbimeve, vendos lënin në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
